

Kosova

“Kjo do të thotë se unë kam të drejta?”¹



Gratë trafikohen në Kosovë për prostitucion

Hyrje

“Një mik më njohu me një grua në ChiŪn|u, ajo më ofroi një punë jashtë shtetit dhe më tha se do të përgatiste një pasaportë për mua, falas. Unë e pyeta nëse puna ishte e lidhur me seksin dhe ajo më premtoi që nuk ishte.”¹

“Mua më rrahën dhe më detyruan të kem marrëdhënie seksuale...në qoftë se nuk dëshironim, ata veç na rrihnin dhe na kërcënonin.”²

“Edhe në kohë të ftohtë unë duhet të vishja rroba të holla... Unë detyrohesh nga bosit t’u shërbeja ushtarëve ndërkombëtarë dhe policëve. Unë nuk pata kurrë rast të largohesha dhe ta lija atë jetë të mjerë, sepse vëzhgohesha çdo çast nga një grua.”³

Trafikimi i grave për prostitucion me forcë është një shkelje e të drejtave të njeriut, jo më pak e rëndësishme se e drejta për integritet fizik dhe mendor. Ai shkel të drejtën e grave dhe vajzave për lirinë dhe sigurinë e personit, dhe mundet, madje, të shkelë edhe të drejtën e tyre për të jetuar. Ai i ekspozon gratë dhe vajzat ndaj një sërë shkeljesh të të drejtave njerëzore në duart e trafikantëve dhe të atyre që blejnë shërbimet e tyre. Ai gjithashtu i bën ato të pambrojtura nga shkeljet e qeverive, të cilat nuk arrijnë t’i mbrojnë të drejtat njerëzore të grave të trafikuar.⁴

¹ Grua e trafikuar 24-vjeçare nga Moldavia.

² Grua e trafikuar në Kosovë.

³ Vajzë shqiptare e trafikuar brenda vendit, vjeç 12.

⁴ Në këtë raport, termi “gra” përgjithësisht u referohet si grave dhe vajzave. Termi “vajza” përdoret vetëm për femra nën 18 vjeç.

Amnesty International e konsideron trafikimin e grave për qëllime prostitucioni me dhunë se është një shkelje e përhapur dhe sistematike e të drejtave njerëzore të gruas.⁵

Qysh prej vendosjes më korrik 1999 të një force paqeruajtëse ndërkombëtare (KFOR-i) dhe vendosjes së administratës civile të Misionit të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK-u), Kosova⁶ është bërë vendi më i madh i destinacionit për gra dhe vajza të trafikuar për prostitucion të detyruar. Gratë trafikohen në Kosovë kryesisht nga Moldavia, Bullgaria dhe Ukraina, shumica e tyre nëpërmjet Serbisë. Në të njëjtën kohë, një numër gjithnjë në rritje i grave dhe vajzave vendase janë duke u trafikuar brenda vendit dhe jashtë Kosovës.

Më pak se tri muaj pas vendosjes së forcave ndërkombëtare dhe policëve në Kosovë, trafikimi u identifikua si një problem nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE); dhe nga janari 2000, Këshilltari për Problemet Gjinore i UNMIK-u e pranoi, por ende nuk ka vepruar ndaj problemit.⁷ Pavarësisht nga masat e mëtejshme të marra prej UNMIK-u dhe të tjerët për të luftuar trafikimin, deri më korrik 2003 kishte mbi

⁵ Vajzë shqiptare e trafikuar brenda vendit, vjeç 12.

⁶ Qëllimi i këtij raporti nuk shtrihet tek problemi i përhapur i trafikimit të grave dhe vajzave, i burrave dhe fëmijëve me forma të tjera të shfrytëzimit në punë, duke përfshirë lypjen, industrinë e shërbimeve, punën bujqësore, shtëpiake dhe punë të tjera të detyruara e martesës.

⁷ Shqip, Kosova; emrat e vendeve jepen si në shqip, dhe në serbisht në këtë raport.

⁸ OSCE/ODIHR, *Plani i Propozuar i Veprimit 2000 për aktivitetet e luftimit të trafikimit të Qenieve Njerëzore*, Varshavë, nëntor 1999, fq. 20-24; “Trafikimi i grave është një problem real, por nuk është në krye të listës së prioriteteve të mia,” Roma Bhattacharjea, Këshilltar Gjinor i UNMIK-ut; “forcat e NATO-s nxitin bumën e prostitucionit të Kosovës”, *AFP*, 5 janar 2000.

200 bare, restorante, klube dhe kafene në Kosovë ku gratë e trafikuaras besohet se punonin në prostitucion të detyruar.⁸

Ndonëse një pjesë e grave janë rrëmbyer dhe detyruar, shumë e nisën rrugën e tyre prej vendeve të tyre të lindjes vullnetarisht, duke besuar se puna për të cilën janë ofruar zakonisht në Evropën Perëndimore- do t'i lejojë ato të çlirohen nga varfëria ose të shpëtojnë nga dhuna dhe abuzimet. Shpesh, sapo rruga e tyre fillon, nis edhe shkelja sistematike e të drejtave të tyre, me një strategji e cila i nënshtron ato ndaj varësisë së trafikuesit të tyre, dhe më vonë "pronarit" të tyre. Pasi udha e tyre vazhdon, puna shtohet aq shumë, sa që puna për të cilën ato janë ofruar nuk është ajo çka u premtua; atyre u merren dokumentet; ato mund të rrihen; ato – thuajse me siguri, po nisën të protestojnë- të përdhunohen.

Kur arrijnë në Kosovë, rrihen dhe përdhunohen nga klientët, nga "pronarët" dhe nga persona të tjerë. Shumë të tjera janë praktikisht të burgosura, të kyçura në një apartament ose dhomë, ose ndonjë qilar. Disa bëhen skllave duke punuar nëpër bare dhe kafene gjatë ditës dhe të kyçura në një dhomë duke u shërbyer 10 deri 15 klientëve gjatë një nate, nga njeriu që ato na e referojnë neve si "pronari" i tyre. Disa shohin se rrogat e tyre-arsyeja për të cilën ato ishin të gatshme të linin shtëpitë e tyre- nuk janë paguar kurrë, por janë mbajtur për të paguar "borxhet" e tyre, për të paguar gjërat arbitrare, ose për të paguar ushqimin dhe strehimin. Në qoftë se ato janë sëmure, atyre mund t'u ndalohet shërbimi shëndetësor. Ato nuk kanë status ligjor dhe u janë mohuar të drejtat e tyre themelore. Disa nga ato janë vajza të reja deri 12 vjeç.

Edhe në qoftë se ato shpëtojnë nga trafikuesit e tyre ose "shpëtohen" nga policia, disa gra vuajnë shkeljen e të drejtave njerëzore prej funksionarëve. Disa arrestohen dhe burgosen për prostitucion ose shkelje të ligjeve të emigracionit, pa iu lejuar të drejtat themelore të të paraburgosurve. Atyre që pranohen si viktima të trafikimit u mohohet e drejta e dëmshtëpërlimit dhe e zhdëmtimit, dhe pak marrin mbrojtjen e duhur, mbështetje dhe shërbime. Disa mendojnë se ato kanë pak ose nuk kanë mbrojtje nga trafikuesit e tyre në rast se dëshmojnë në gjyq. Gjatë procesit gratë përballen me diskriminim të bazuar në gjininë e tyre, origjinën etnike dhe/ose punësimin e tyre të nënkuptuar.

Kërkimi

Amnesty International ka bërë kërkime në shkeljen e të drejtave të njeriut të provuara nga gratë e trafikuaras në

⁸ "Lista e gjërave të ndaluara", korrik 2003, Njësia Policore kundër Trafikimit dhe Prostitucionit e UNMIK-ut (TPIU); "lista e gjërave të ndaluara" është shpjeguar më poshtë, shih fq. 10.

Kosovë qysh nga fillimi i vitit 2000. Janë kryer intervista me një brez të gjerë personeli ndërkombëtar dhe vendor të punësuar nga UNMIK-u, duke përfshirë policinë e UNMIK-ut dhe Shërbimin Policor të Kosovës (KPS); OSBE-në; Organizatën Ndërkombëtare për Emigracionin (IOM); oficerë dhe personel i Ministrive brenda Instituteve të Përkohshme të Vetëqeverisjes (PISG); anëtarë të organizatave ndërkombëtare dhe vendore joqeveritare (NGO), në veçanti Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve (CPWC)⁹ dhe Qendra për Mbrojtjen e Viktimave dhe për Parandalimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore në Kosovë (CPVPT)¹⁰ dhe një NGO që siguron strehëz për të miturit, e cila dëshiron të mbetet anonime, prokurorë ndërkombëtarë, anëtarë të gjyqësorit vendor në Kosovë dhe anëtarë të NGO-ve që punojnë në vendet burimore me gratë e trafikuaras.

Amnesty International gjithashtu bëri intervista me gra që e identifikuan veten se ishin trafikuar.¹¹ Me qëllim që të mbrojnë të drejtat e grave të trafikuaras, Amnesty International e ka ruajtur gjatë gjithë raportit konfidencialitetin e kërkuar nga këto gra ose nga organizatat që punojnë me gratë e trafikuaras, nuk është bërë asnjë citim i cili mund të ndihmojë në identifikimin e këtyre grave.

Natyra ilegale, e organizuar dhe klandestine e trafikimit, së bashku me heshtjen e e grave të trafikuaras nëpërmjet detyrimit, dhunës dhe frikësimit, e bën të pamundur të vlerësosh shtrirjen e plotë të industrisë së trafikimit në Kosovë.

Çfarë është trafikimi?

"Është diçka që ka të bëjë me makinat, nuk është ashtu? - një vajzë e trafikuar, e intervistuar nga një NGO në Kosovë"

Graviteti i krimit të trafikimit pasqyrohet në faktin që, në disa rrethana, ai mund të përbëjë një krim kundër njerëzimit ose një krim luftime. Trafikimi i njerëzve, veçanërisht i grave dhe fëmijëve, që arrin deri në skllavërim, është futur mes krimeve më të rënda të

⁹ CPWC-ja është NGO-ja vendase kryesore që punon me gratë e trafikuaras brenda vendit; shqip *Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve (QMGF)*.

¹⁰ CPVPT-ja është një NGO vendase që punon në partneritet me IOM-in; shqip, *Qendra për Mbrojtjen e Viktimës dhe Parandalimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore në Kosovë (MVPT)*.

¹¹ Amnesty International është e ndërgjegjshme për preokupimet që termi "gra të trafikuaras" i identifikon dhe i përcakton gratë nga dhuna e shkaktuar kundër tyre, dhe e përforcon perceptimin e grave si viktima. Sidoqoftë, organizata mendon se termi mund të nënkuptohet për të përmbledhur eksperiencën e të qenit i trafikuar, dallon eksperiencën e trafikimit nga ajo e punësuarve emigrantë dhe është e parapëlqyer ndaj termave që përdoren zakonisht, duke përfshirë "viktima" ose "viktima të trafikimit".



çështjeve ndërkombëtare në Statutin e Romës të Gjykatës Penale Ndërkombëtare (ICC).¹²

Për qëllimet e këtij raporti, Amnesty International përdor përkufizimin e trafikimit të përcaktuar në Nenin 3 të Protokollit të UN-it për Parandalimin, Ndalimin dhe Ndëshkimin e

Trafikimit të Njerëzve, veçanërisht të Grave dhe Fëmijëve, (Protokolli i Palermos), shtojcë e Konventës së UN-it kundër Krimit të Organizuar Ndërshtetëror.¹³ Neni 3 parashikon që:

*“(a) Trafikimi i personave do të nënkuptojë rekrutimin, transportimin, transferimin, strehimin ose pritjen e personave, me anë të kërcënimit ose të përdorimit të forcës ose formave të tjera të detyrimit, të rrëmbimit, mashtrimit, gënjeshtërisë, abuzimit me pushtetin ose me pozitën e pambrojtur, ose nëpërmjet dhënies ose marrjes së pagesave a përfitimeve për të arritur pëlqimin e personit që ka kontroll mbi një person tjetër me qëllim shfrytëzimi. Shfrytëzimi do të përfshijë, minimalisht, shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve ose forma të tjera të shfrytëzimit seksual, punë të detyruar ose shërbime, skllavëri ose praktika të ngjashme me skllavërinë, robërim ose heqje të organeve”.*¹⁴

(b) Pëlqimi i një viktime të trafikimit njerëzor me qëllim shfrytëzimi, të shtruar më parë në nënparagrafin (a) të këtij neni, do të konsiderohen të pavlefshme kur është përdorur ndonjë nga mjetet e përcaktuara më parë në nënparagrafin (a).

(c) Rekrutimi, transportimi, zhvendosja, strehimi ose pritja e një fëmije për qëllim shfrytëzimi do të konsiderohet “trafikim njerëzish”, edhe në qoftë se

¹² Ai përcaktohet në Statutin e Romës si një krim kundër njerëzimit kur shkaktohet si pjesë e sulmit të përgjithshëm ose sistematik kundër çdo popullsie civile, në lidhje me ose në marrëveshje me një shtet, ose politike organizative për të kryer sulmin (Neni 7 (1) (c) dhe (2) (c)); krimi përkatës i skllavërisë seksuale është përcaktuar si një krim lufte kur shkaktohet gjatë një konflikti të armatosur të brendshëm ose ndërkombëtar, (Neni 8 (2) (b) (xxii) dhe (c) (vi)) Statutit të Romës).

¹³ Protokoll i Trafikimit, i njohur gjithashtu edhe si Protokoll i Palermos, i cili hyri në fuqi më 26 dhjetor 2003, u nënshkrua nga Serbia dhe Mali i Zi më dhjetor 2000 dhe u raktifikua më korrik 2001; përkufizimi i vendosur në Nenin 3 është përkufizimi i zbatueshëm në Kosovë.

¹⁴ Grupi i Ligjit Ndërkombëtar të të Drejtave të Njeriut (IHRLG) vëren se termat “shfrytëzimi i prostitucionit të të tjerëve” dhe “shfrytëzim seksual” u lanë qëllimisht të papërcaktuar në Protokoll, dhe as nuk janë përcaktuar gjetkë në ligjin ndërkombëtar, *Guida e Komenteve të Protokollit të Plotë të Trafikimit të UN-it*, fq. 8-9, IHRLG, maj 2002.

kjo nuk përfshin ndonjë nga mjetet e parashtruara në nënparagrafin (a) të këtij neni.

(d) “Fëmijë” do të thotë çdo person nën moshën tetëmbëdhjetë vjeç.

Amnesty International po zbaton këtë përkufizim për gratë që janë trafikuar në Kosovë prej vendeve të huaja dhe për ato që trafikohen nga brenda¹⁵, duke përfshirë dhe nga Serbia, dhe pavarësisht nëse trafikantët e tyre janë pjesëmarrës në një grup të organizuar kriminal.

Ndonëse shumica e grave, duke futur edhe ato, dëshmitë e të cilave janë përfshirë në raport, mund t'i kenë nisur udhët e tyre si emigrantë të paligjshëm, përgjatë udhës së tyre ose pas mbërritjes së tyre në Kosovë, ato e kanë gjetur veten të detyruara në prostitucion shfrytëzues. Amnesty International i konsideron këto gra të trafikuar.

Një perspektivë e të drejtave të njeriut

Në këtë raport, Amnesty International thekson shkeljen e të drejtave të njeriut të cilave u ekspozohen gratë e trafikuar dhe kërkon respektimin dhe mbrojtjen e tyre, të drejtat e grave të trafikuar duhet të jenë në qendër të aksionit të të gjitha autoriteteve në përgjigjet e tyre ndaj trafikimit.

Detyrimi i shteteve për të parandaluar trafikimin – i njohur si një formë e dhunës diskriminuese me bazë gjinore¹⁶ – është përcaktuar në Nenin 6 të Konventës së UN-it për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Ndaj Grave (Konventa e Grave) dhe në Konventën e të Drejtave të Fëmijës (CRC).¹⁷

¹⁵ Amnesty International e përdor termin “të trafikuar nga jashtë” duke iu referuar grave që janë trafikuar në Kosovë nga vende të treta (duke përfshirë, në këtë rast, Serbinë), dhe “të trafikuar nga brenda” duke iu referuar shqiptarëve nga Kosova, romëve dhe grave serbe të Kosovës, të cilat janë trafikuar nga brenda Kosovës.

¹⁶ Neni 2 (b) i Deklaratës së UN-it për Eliminimin e Diskriminimit të Grave (DEVAW) përcakton: “Dhuna kundër grave duhet kuptuar se përfshihet, por se nuk kufizohet vetëm me, sa vijon: ... (b) Dhunë fizike, seksuale dhe psikologjike që ndodh brenda komunitetit të përgjithshëm, duke përfshirë përdhunimin, dhunën seksuale, ngacmimin seksual dhe kërcënimin në punë, në institucionet mësimore dhe gjetkë, trafikimin e grave dhe prostitucionin e detyruar. Shih gjithashtu *Platforma e Veprimit të Beijingut 1995*; Asambleja e Përgjithshme e UN-it, *Aksione të Mëtejshme dhe Iniciativa për të Zbatuar Platformën e Veprimit të Beijingut*, A/RES/s-23/3, 16 nëntor 2000, Seksioni 131 a-c. e cila e njeh trafikimin si një formë të dhunës me bazë gjinore. Shih gjithashtu, Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit Ndaj Grave (CEDAW), paragrafi 7, *Rekomandimi i Përgjithshëm 19*: “Dhuna me bazë gjinore, e cila dëmton ose zhduk nga gratë gëzimin e të drejtave të njeriut dhe liritë themelore, sipas së drejtës së përgjithshme ndërkombëtare ose sipas konventave të të drejtave të njeriut, është diskriminim sipas kuptimit të Neni 1 të Konventës”. *Rekomandimi i Përgjithshëm 19*, A/47/38, 29 janar 1992.

¹⁷ Neni 6 i Konventës së Grave i detyron shtetet palë “të marrin të gjitha masat e duhura, duke përfshirë legjislacionin, për të zhdukur të gjitha format e trafikut të grave dhe shfrytëzimin e prostitucionit të grave”. Konventa e Fëmijëve u kërkon shteteve që të marrin të gjitha



Ligji i zbatuar në Kosovë përfshin traktatet ndërkombëtare, të cilat kërkojnë që autoritetet të veprojnë me kujdesin e duhur për të parandaluar, hetuar dhe ndjekur të gjitha shkeljet e të drejtave të njeriut, duke përfshirë dhe trafikimin, dhe shkeljet e tjera të të drejtave të njeriut të cilave u nënshtrohen gratë dhe vajzat e trafikuar, duke përfshirë aktet e torturës, si dhe përdhunimin. Ato kërkojnë gjithashtu që autoritetet të sigurojnë zhdëmtimin dhe dëmshpërblimin e mjaftueshëm të atyre që kanë qenë objekt i këtyre krimeve. Këto traktate ndërkombëtare përfshijnë Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore dhe Protokollin, më poshtë (ECHR); Konventën Ndërkombëtare të të Drejtave Civile dhe Politike dhe Protokollin, më poshtë (ICCPR); Konventën Ndërkombëtare për të drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (ICESCR); Konventën për Zhdukjen e të Gjitha Formave të Dallimit Racial (Konventa Kundër Dallimit Racial); Konventën për Zhdukjen e të Gjitha Formave të Diskriminimit të Grave (Konventa e Grave); Konventën Kundër Torturës dhe Trajtimit të tjerë Çnjerëzorë ose Degradues (Konventa Kundër Torturës); dhe Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijës (Konventa e Fëmijëve).

Edhe më parë se të merrnin pjesë në procesin e trafikimit, mjaft gra dhe vajza kishin provuar tashmë shkeljen e të drejtave të tyre në vendet e tyre amtare, të garantuara nga ICCPR-ja, ICESCR-ja dhe nga Konventa e Grave. Mjaft grave dhe vajzave u është mohuar mundësia e arsimimit, mundësia e punësimit ose e asistencës sociale ose kanë pësuar diskriminim-për shkak të gjinisë së tyre-kur e fitonin mundësinë për këto të drejta. Mjaft prej tyre kanë qenë tashmë objekt i i shkeljeve të drejtave të tyre për paprekshmërinë fizike dhe mendore, nëpërmjet dhunës në familje dhe formave të tjera të abuzimit fizik dhe seksual nga duart e prindërve të tyre ose të partnerëve të tyre.

Në procesin e trafikimit gratë mund të rrëmbehen; ato do të privohen në mënyrë të paligjshme nga liria e tyre, duke dhunuar të drejtën e tyre për lirinë dhe sigurinë e personit të tyre, të mishëruar në Nenin 9 të ICCPR-së dhe në Nenin 5 të ECHR-së. E drejta e tyre për lëvizjen e lirë, e

masat e duhura kombëtare, dypalëshe dhe shumëpalëshe për të mbrojtur fëmijët nga trafikimi dhe për të parandaluar trafikimin e fëmijëve. Për shembull, Neni 35 i CRC-së parashikon: "Shtetet palë do të marrin të gjitha masat e duhura kombëtare, dypalëshe dhe shumëpalëshe për të parandaluar rrëmbimin, shitjen ose trafikimin e fëmijëve për çdo arsye apo formë". Shih gjithashtu *Protokolli Opcional për Konventën e Fëmijëve rreth Shitjes së Fëmijëve, Prostitucionit të Fëmijëve dhe Pornografisë së Fëmijëve*; dhe *Konventa e Organizatës Botërore të Punës (ILO) Nr. 182 për Format më të Rënda të Punës së Fëmijëve*, të cilat kërkojnë eliminimin e "të gjitha formave të skllavërisë ose të praktikave të ngjashme me skllavërinë, si: shitja dhe trafikimi i fëmijëve". Këto dy traktate të mëvonshme duhet ende të përfshihen brenda ligjit të zbatuar në Kosovë.

garantuar nga Neni 12 i ICCPR-së, janë shmangur ose mohuar. Të drejtat e tyre për intimitet dhe jetë familjare nga Neni 8 i ECHR-së dhe Neni 17 i ICCPR-së janë mohuar më tej.

Ato janë objekt i torturës, duke përfshirë përdhunimin¹⁸ dhe formave të tjera të trajtimit të egër, çnjerëzor dhe degradues, si: përdorimi i përsëritur i kërcënimeve psikologjike, rrahjet fizike dhe aktet degraduese seksuale. Këto akte shkelin të drejtat e grave dhe vajzave sipas Nenit 7 të ICCPR-së dhe Nenit 3 të ECHR-së, dhe Nenit 37 të Konventës së Fëmijëve, dhe mund të gjithashtu të shkelin të drejtën e tyre për të jetuar. Grave të trafikuar mund gjithashtu t'u mohohet mundësia për kujdes shëndetësor, e garantuar sipas Nenit 12 të ICESCR-së dhe Nenit 12 të Konventës së Grave.

Përveç abuzimeve të kryera nga trafikantët, gratë e trafikuar shpesh i shohin të drejtat e tyre të shkelura brenda sistemit të drejtësive penale. Si të paraburgosura, ato nuk informohen për të drejtat e tyre ose si t'i mundësojnë ato. Të drejtat e tyre për prezumimin e pafajësisë, për një avokat dhe për një përkthyes mohohen duke shkelur të drejtat e tyre sipas Nenit 9 dhe 14 të ICCPR-së, Nenit 5 dhe 6 të ECHR-së dhe Nenit 37 e 40 të Konventës së Fëmijëve.

Si viktimat të shkeljeve të të drejtave të njeriut, ato nuk marrin zakonisht informacion rreth së drejtës së tyre për dëmshpërblim, duke përfshirë kompensimin, ose si t'i mundësojnë ato nëpërmjet bordeve administrative apo gjykatave.¹⁹ Shumica e grave nuk do t'i shohë dot ata që janë përgjegjës për shkeljet e të drejtave të tyre të dalin para drejtësisë.

Disa gra të trafikuar nuk kanë qenë të mbrojtura nga kthimi forcërisht në vendin ku ato do të provonin shkelje të rënda të të drejtave të njeriut, në shkelje të Nenit 3 të ECHR-së dhe Konventës Kundër Torturës, Nenit 33 të Konventës që lidhet me Statusin e Refugjatëve, dhe të parimeve të së drejtës së përgjithshme ndërkombëtare.

Respekti për të drejtat e grave dhe vajzave në Kosovë, të cilat kanë qenë objekt i trafikimit, nuk kërkon vetëm që autoritetet të hetojnë shkeljet e theksuara më lart, por edhe të çojnë para drejtësisë ata që janë përgjegjës për këto shkelje, dhe t'u sigurojnë viktimave të këtyre shkeljeve zhdëmtim efektiv, duke përfshirë dëmshpërblimin. Kjo

¹⁸ Shteti është përgjegjës sipas së drejtës ndërkombëtare që të veprojnë me kujdesin e duhur për ta penguar dhe parandaluar përdhunimin; që të hetojë kallëzimet për përdhunim; të sjellë përpara drejtësisë në gjykime të ndershme ata individë që dyshohet se janë përgjegjës për këto shkelje; dhe të sigurojë mundësinë e një zhdëmtimi dhe dëmshpërblimi efektiv për ata që kanë pësuar akte përdhunimi, si dhe të sigurojë mbrojtjen e tyre. Gjyqet ndërkombëtare kanë konfirmuar se përdhunimi është një formë e torturës.

¹⁹ Shih Nenin 2 të ICCPR-së, Nenin 14 të Konventës Kundër Torturës.



kërkon gjithashtu që autoritetet në Kosovë-si dhe në vendet e tyre të origjinës dhe vendet e tjera në të cilat ato mund të rivendosen-të sigurojnë respekt për gjithë gamën e të drejtave të tyre, duke përfshirë të drejtat e tyre për dinjitet, siguri, intimitet, për standardet më të larta të mundshme të shëndetit, për një standard të përshtatshëm jetese, për një strehim të sigurt e të qetë, për punë, për arsim dhe për sigurim social.

Përveç standardeve ligjore të përcaktuara më lart, Amnesty International i referohet Zyrës së Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut e UN-it (UNHCHR), Parimeve të Rekomanduara dhe Udhëzimeve për të Drejtat e Njeriut dhe Trafikimin e Njerëzve (Parimet e Rekomanduara dhe Udhëzimet e UNHCHR). Mbrojtja e të drejtave të njeriut të personave të trafikuar shtrihet në zemër të Parimeve të Rekomanduara dhe Udhëzimeve të UNHCHR-së ,të cilat u drejtohen shteteve ,organizatave ndërqeveritare dhe organizatave joqeveritare;ato përbëhen nga 17 parime bazë- të bazuara në të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut -dhe nga 11 Udhëzime të detajuara,të cilat përcaktojnë masa praktike për zbatimin e tyre.²⁰

Kujdesi i duhur

Ku janë kryer abuzime nga kriminelë të organizuar ose individë privatë dhe ku shteti ka dështuar në ndërmarrjen e veprimeve efektive ose në çuarjen e atyre që janë përgjegjës përpara drejtësisë,atëherë autoritetet –në këtë rast,UNMIK-u-mund të mbahet përgjegjës për këto shkelje të të drejtave të njeriut.Lidhur me dhunën ndaj grave,Komiteti i UN-it për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave(CEDAW) vëren se shtetet duhet të ushtrojnë kujdesin e duhur për të parandaluar,hetuar dhe,në përputhje me legjislacionin kombëtar,të ndëshkojnë aktet e dhunës ndaj grave,qoftë kur ato akte janë kryer nga shteti,qoftë nga persona privatë.²¹ Zbatimi i këtyre standardeve në praktikë mund për pasojë të kërkojë nga shtetet,për shembull, të futin masa për të penalizuar trafikimin(sic ka bërë UNMIK-u në Kosovë), ta zbatojë me efektivitet këtë masë,të sigurojë ndihmë ligjore dhe rrugëzgjdhje për viktimat ,dhe të ndërmarrë veprime parandaluese për të zgjidhur shkaqet themelore të trafikimit.²²

Ligji i zbatuar në Kosovë

Përveç standardeve të të drejtave të njeriut të theksuara më lart,ligji i zbatuar në Kosovë përbëhet nga dispozita të

²⁰ Raporti i Zyrës së Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut në Këshillin Ekonomik dhe Social, Dok. i UN-it.: E/2002/68/Add. 1, 20 Maj 2002.

²¹ CEDAW, Neni 9, Rekomandimi i Përgjithshëm 19, Dhuna kundër gruas , (Sesioni i njëmbëdhjetë, 1992)

²² Shih Anne Gallagher, *Shqyrtim i Çështjes së Trafikimit,Dokumenti Bazë, Forumi Paqësor i Azisë i Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut*, 11-12 nëntor, 2002, fq. 11.

lëshuara nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të UN-it(SRSG) dhe nga ligji në fuqi në Kosovë më 22 mars 1989.²³ Deri më janar 2001 hetimet e rasteve të trafikimit ndiqeshin sipas Kodit Penal të ish-Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë(SFRY) dhe Kodeve Penale Serbe,duke përfshirë sipas Nenit 251 të Kodit Penal Serb për “ndërmjetësim në prostitucion” dhe sipas Nenit 18(8) të Ligjit të Kosovës për Qetësinë Publike dhe Rendin,i cili parashikon një shkelje më të vogël për aktin e ndërmjetësimit ose kur detyron një tjetër për prostitucion;gratë dënoheshin për prostitucion sipas të njëjtit ligj.

Më 12 janar 2001, SRSG-ja shpalli Rregulloren e UNMIK-ut 2001/4 , *Për Ndalimin e Trafikimit të Njerëzve në Kosovë*(shih Kapitullin 3, më poshtë).

Amnesty International vëren gjithashtu se Komisioni për të Drejtat e Njeriut i UN-it ka vendosur së fundi një mandat të ri për një Raportues Special mbi trafikimin.

Një tjetër mjet i rëndësishëm për të siguruar mbrojtjen e të drejtave të njeriut të gruas,veçanërisht në kontekstin e e konfliktit të armatosur dhe të gjendjes pas konfliktit, është Rezoluta 1325 për gruan,paqen dhe sigurinë,e adoptuar nga Këshilli i Sigurimit i UN-it më 31 tetor 2000.²⁵ Kjo rezolutë udhërrëfyese u bën thirrje një radhe aktorësh-Sekretarit të Përgjithshëm të UN-it,Këshillit të Sigurimit të UN-it,Shteteve Anëtare të UN-it,të gjitha palëve të konfliktit të armatosur dhe atyre të përfshira në negociimin dhe zbatimin e marrevëshjes së paqes-të sigurojnë një përfaqësim në rritje të gruas në të gjitha nivelet e vendimmarrjes lidhur me parandalimin,manaxhimin dhe zgjidhjen e konfliktit;për të përfshijnë më shumë gra në paqeruajtje dhe veprime të tjera në terren dhe të sigurojnë trajnim për personalin e terrenit mbi mbrojtjen e të drejtave të njeriut të gruas;të adoptojnë një perspektivë gjinore kur negociojnë dhe zbatojnë marrëveshjet e paqes;dhe të marrin masa të veçanta për të mbrojtur gratë dhe vajzat nga dhuna me bazë gjinore,veçanërisht nga përdhunimi dhe forma të tjera të abuzimit seksual.

Rezoluta 1325 i kërkoi gjithashtu Sekretarit të Përgjithshëm të kryejë një studim për gruan ,paqen dhe sigurinë.Konkluzionet e këtij studimi iu raportuan Këshillit të Sigurimit më tetor 2002 dhe u shtrinë mbi rekomandimet që përmbahen në rezolutën 1325.²⁶ Në të

²³Shih Rregullorja e UNMIK-ut 1999/24, *Mbi Ligjin e Zbatuar në Kosovë*, 12 dhjetor 1999, siç është amenduar nga Rregullorja e UNMIK-ut 2000/59, 27 tetor 2000. Rregullorja parashikon për katër burime të mundshme të ligjit të zbatuar në Kosovë: ligji në Kosovë siç ekzistonte më 22 mars 1989; Rregullorja e UNMIK-ut; ligji i zbatuar në Kosovë midis 22 mars 1989 dhe 12 dhjetor 1999 (data që Rregullorja 1999/24 hyri në fuqi) në qoftë se kjo është më e favorshme për një të pandehur penal ose mbush një boshllëk ku nuk kishte ligj qysh nga marsi 1989; dhe disa ,por jo te gjitha,standartet ndërkombëtare të ligjeve dhe të drejtave të njeriut.



njëjtën kohë, UNIFEM (Fondi i Zhvillimit i Kombeve të Bashkuara për Gruan) porositi një studim special për gruan, luftën dhe paqen, i cili përpunoi më tej masat e zbatimit të mëtejshëm të rezolutës 1325.²⁷ Më tetor 2004 Sekretari i Përgjithshëm i UN-it do të paraqitë raportin e parë për zbatimin e rezolutës 1325.

Kapitulli 1: Historia

Më korrik 1999, pas Rezolutës së Këshillit të Sigurimit 1244/99 të UN-it e 10 qershorit 1999, një forcë ndërkombëtare paqeruajtëse (KFOR) dhe një administratë civile e UN-it, e njohur si UNMIK-u, u vendos në Kosovë. Kjo përcolli largimin e autoriteteve serbe që kishin qeverisur krahinën qysh nga 1990, kur autoritetet nën presidentin Slobodan Milosheviç i shkëputën Kosovës autonominë që i ishte dhënë më 1974.²⁸

Nga 1990, pjesëtarët e popullsisë së shumicës etnike shqiptare iu nënshtruan një dhjetëvjeçari shkeljesh të drejtash njerëzore të kryera nga autoritetet e Republikës Federative të Jugosllavisë (FRY) dhe policia serbe.²⁹ Deri më 1998, në Kosovë u zhvillua një konflikt i brendshëm i armatosur ndërmjet forcave të FRY, policisë serbe e paraushtarakëve dhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (KLA) nga ana tjetër. Prej 24 marsit deri më 10 qershor 1999, me synimin e deklaruar që të parandalohet një katastrofë e të drejtave të njeriut, Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior (NATO) nisi një fushatë ajrore kundër FRY, me emrin e koduar Operacioni Forca Aleate.³⁰ Më qershor 1999, pas përfundimit të një marrëveshjeje me autoritetet e FRY, NATO-ja e pushoi fushatën e saj të bombardimeve dhe nga fundi i qershorit policia serbe, paraushtarakët dhe Ushtria Jugosllave u tërhoqën nga Kosova.³¹

²⁵ S/RES/1325 (2000).

²⁶ S/2002/1154.

²⁷ Progresi i Grave të Botës 2002, Vëllimi 1, Gratë, Lufta, Paqja.

²⁸ Më 2 korrik 1990 anëtarët e etnisë shqiptare të Asamblesë së Kosovës deklaruan pavarësinë e Kosovës.

²⁹ Shih Amnesty International, FRY (Kosovë): Një dekadë e paralajmërimeve të injoruara, Vëll. 1 & 2, AI Index: EUR 70/39/99 dhe EUR 70/40/99, prill 1999.

³⁰ Shih Amnesty International, NATO/FRY: "Dëmi Anësor" apo Vrasjet e paligjshme? Shkeljet e Ligjit të Luftës nga NATO-ja gjatë Operacionit Forca Aleate, AI Index: EUR 70/18/00, qershor 2000.

³¹ Marrëveshja Teknike Ushtarake midis Forcës së Sigurisë Ndërkombëtare („KFOR“) dhe Qeverive të Republikës Federative të Jugosllavisë dhe Republikës së Serbisë, NATO, 9 qershor 1999. Marrëveshja përcaktoi mandatin e pranisë ushtarake ndërkombëtare në Kosovë, rolet dhe përgjegjësitë e KFOR-it dhe të FRY-së, dhe policisë dhe militarëve serbë. Sipas UNSCR-së 1244/99, UNMIK-u u mandatua me detyrën që të sigurojë një administratë të përkohshme për

Kosovën dhe në Nenin 11(j) u ngarkua me detyrën e "Mbrotjtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut". Neni 9 siguron gjithashtu një mandat për praninë e sigurisë ndërkombëtare (KFOR).

Prania ndërkombëtare gjeneron tregtinë e seksit

Më gjysmën e dytë të 1999, u vendosën 40.000 trupa të KFOR-it dhe mbërritën qindra personel i UNMIK-ut, së bashku me punonjës nga më tepër se 250 NGO ndërkombëtare.

Brenda ca muajve nga mbërritja e KFOR-it, u raportuan bordello rreth bazave ushtarake të zëna nga paqeruajtësit ndërkombëtarë. Kosova u bë shpejt vendi më i madh destinacion për gra të trafikuar në prostitucion të detyruar. Një treg vendas në shkallë të vogël për prostitucion u shndërrua në një industri në shkallë të gjerë të bazuar mbi trafikimin, e drejtuar kryesisht nga rrjetet kriminale të organizuara.

Disa sektorë të ekonomisë u rritën me shpejtësi, nëpërmjet çmimeve të larta të paguara nga personeli ndërkombëtar për pronën e marrë me qira dhe për shërbimet, duke çuar në një rritje të të ardhurave të disponueshme në disa shtresa të popullsisë.

Nga fundi i 1999 Fondi i Zhvillimit i Kombeve të Bashkuara për Gruan (UNIFEM) kishte raportuar për një prostitucion të madh të organizuar në katër zona pranë përqëndrimeve më të mëdha të trupave të KFOR-it. Shumica e klientëve raportohet të jenë pjesëtarë të pranisë ushtarake ndërkombëtare, ndërsa disa ushtarë të KFOR-it flitet të jenë përfshirë gjithashtu në vetë procesin e trafikimit. U identifikuan tetëmbëdhjetë ndërtesa, duke futur edhe zonën e Gnjilane/Gjilanit, ku klientët raportohet se përfshinin dhe personelin ushtarak të US; në Prizren, ku përdoruesit supozohet se përfshinin ushtarët gjermanë të KFOR-it dhe ndërkombëtarë të tjerë; në Peja/Pec, ku banorët raportuan ushtarët italianë të KFOR-it si klientë; dhe në Mitrovicë, ku KFOR-i francez raportohet se u bë padron i bordellove të përkohshme.

Qysh atëherë ka pasur një përshkallëzim të paprecedent të trafikimit në Kosovë. Nga 18 ndërtesat e identifikuar nga fundi i 1999, deri më janar 2001, 75 ose afërsisht kaq banesa ishin renditur në të parën "listë të gjërave të ndaluara" të botuar nga personeli i UNMIK-ut. Kjo rendiste bare, klube dhe restorante ku gratë e trafikuar mendohet se punojnë dhe të cilat ishin shpallur "të ndaluara" për personelin e UNMIK-ut dhe KFOR-it (shih Kapitullin 6). Deri më 1 janar 2004, kishte 200 bare, restorante dhe kafene në "listën e gjërave të ndaluara".³²



KFOR-i dhe UNMIK-u ishin identifikuar publikisht nga fillimi i 2000 si një faktor në rritjen e trafikimit për prostitucion nga IOM-i.³¹ Më maj 2000, Pasquale Lupoli, shefi i Misionit të IOM-it në Kosovë, pohonte se trupat e KFOR-it dhe personeli i UN-it në Kosovë kishin ushqyer “mbirjen si kërpudhat të klubeve të natës”, në të cilat vajza të reja detyroheshin me forcë për prostituim nga bandat kriminale. “Prania e madhe ndërkombëtare në Kosovë në vetvete e bën këtë trafikim të mundur.”³³

Pavarësisht nga kjo, më shkurt 2001 IOM-i kishte paralajmëruar, “fakti që ju keni 45.000 të huaj në Kosovë mund të jetë një nga elementet në ekuacion, por ai nuk është aspak i gjithë ekuacioni.”³⁴ Industria e trafikimit u ndihmua gjithashtu nga afërsia e Kosovës me vendet

³² Wrachel Wareham, Konsulent për UNIFEM Prishtinë, *Nuk ka vend të sigurt: Një Vlerësim i Dhunës kundër Grave në Kosovë*, UNIFEM 2000, fq.94-5. Për dëshmi të prostitucionit në Kosovë para 1999, po aty, fq.93-4.

³³ Njësia Hetimore e Prostitucionit dhe Trafikimit e UNMIK-ut (TPIU) Raporti Vjetor, 2003

³⁴ Në atë kohë IOM-i ishte agjencia lider kundë trafikimit në Kosovë, pasi kishte vendosur atje një prani më janar 2000.

burimore dhe me rrugët e mirëstabilizuara të trafikimit nga Shqipëria në Komunitetin Evropian (EU), ashtu si edhe bashkëpunimi mes rrjeteve të organizuara kriminale serbe, shqiptare, shqiptare të Kosovës dhe maqedonase. Mungesa e policëve të mjaftueshëm dhe me eksperiencë dhe një sistem i dobët i drejtësisë penale gjithashtu e mundësuan industrinë e trafikimit.

Ndonëse zhvillimi i trafikimit mund t'i atribuohet pranisë së bashkësisë ndërkombëtare, industria e seksit është zhvilluar më vonë për t'i shërbyer një baze të gjerë klientësh. Gjatë tri viteve të fundit ajo i ka shërbyer gjithnjë e më shumë komunitetit lokal, që si IOM-i dhe CPWC-ja llogaritin që përbën tani rreth 80 për qind të klientelës.

Duke parë nivelet e ulta të prostitucionit dhe trafikimit të grave para korrikut 1999, të gjitha dëshmitë e vlefshme të bëjnë të mendosh se pa praninë e bashkësisë ndërkombëtare dhe një dyndje të konsumatorëve perëndimorë të gatshëm, Kosova do të kishte mbetur një moçal në industrinë ballknase të trafikimit.

Përgjegjësia dhe përgjegjshmëria në Kosovë

Pas dislokimit të UNMIK-ut, u vendos gjithashtu një qeveri tranzitore më 1999 nga popullsia etnike shqiptare. Pavarësisht nga themelimi i Insitucioneve të Përkohshme

të Vetëqeverisjes (PISG) më 2001, UNMIK-u vazhdon ata administrojë Kosovën sipas UNSCR-së 1244/99, pavarësisht nga transferimi i përshkallëzuar i disa fuqive tek PISG-ja). Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të UN-it (SRSG) ende mban fuqi ekzekutive, veçanërisht mbi gjyqësorin ndërkombëtar, zbatimin e ligjit, minoritetet dhe refugjatët, mbrojtjen dhe sigurinë në bashkëpunim me KFOR-in dhe marrëdhëniet me jashtë. Qysh nga 2002, Departamenti i Drejtësisë ka marrë rolin kryesor për trafikimin.³⁵

Një forcë policore ndërkombëtare – policia e UNMIK-ut ose CIVPOL (policia civile) – kryen funksionet e zbatimit të ligjit (KPS). Nga 31 mars 2004, në Kosovë kishte 3455 policë ndërkombëtarë. Njësia kundër Trafikimit dhe Prostitucionit e Policisë së UNMIK-ut (TPIU) u themelua më 2000, me synimin që të mblidhte dëshmi për të ndihmuar në ndjekjen e atyre që besohet se ishin përgjegjës për trafikimin. TPIU-ja është e përbërë si nga policë ndërkombëtarë, ashtu edhe nga anëtarë të KPS-së.

PISG-u u themelua nga Rregullorja e UNMIK-ut 2001/9 më maj 2001.³⁶ Asambleja e Kosoves u zgjodh më nëntor 2001 dhe Ibrahim Rugova u bë president më mars 2002. Ministrat e qeverisë me përgjegjësi qoftë për parandalimin e trafikimit dhe për mbrojtjen e ndihmën ndaj grave të trafikuar përfshijnë Ministrin e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministrin e Punës dhe Asistencës Sociale dhe Ministrin e Shëndetësisë, dhe Ministrin e Shërbimeve Publike.

Brenda Zyrës së Kryeministrit, Zyra për Mirëqeverisje, të Drejtat e Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Çështje Gjinore kanë përgjegjësi të veçanta për trafikimin dhe për koordinimin e rolit të PSIG-ut në Planin Kombëtar të Veprimit ndaj Trafikimit-siç kërkohet nga Task Forca e Paktit të Stabilitetit për Trafikimin e Qenieve Njerëzore (SPTF).³⁷

Mandati i KFOR-it vazhdon të jetë i pacënuar nga transferimi gradual i përgjegjësive nga UNMIK-u tek PISG-u. Në fillim mbi 50,000 ushtarë të fortë dhe të bindur nga më shumë se 30 vende, deri në mars 2004 ai përmbledh katër batalione shumëkombëshe që arrijnë në 17,000 trupa, por u përforcua më vonë nga rreth 3500 trupa ekstra në vijim të dhunës së përgjithshme ndëretnike atë muaj. Personeli i KFOR-it nuk jep llogari as tek UNMIK-u dhe as tek PISG-u.

³⁵ “Një grup hap fushatë kundër prostitucionit të detyruar në Kosovë”, *AFP*, 24 maj 2000.

³⁶ Zëdhënësi i IOM-it Jean Philippe Chauzy, në “Trafikimi i grave në rritje në Kosovë”: IOM, *AFP*, 8 shkurt 2000.

³⁷ Masat kundër trafikimit koordinoheshin më parë nga OSCE-ja, si organizata lider brenda “shtyllës” së Ndërtimit të Demokracisë dhe Insitucionit të UNMIK-ut.



³⁸ Rregullorja e UNMIK-ut 2000/47, Për statusin, privilegjet dhe imunitetet e KFOR-it dhe UNMIK-ut dhe personelit të tyre në Kosovë, 18 gusht 2000.

Si personeli i UNMIK-ut dhe i KFOR-it, dhe kontraktorët që punojnë për UNMIK-un dhe KFOR-in janë të mbrojtur nga ndjekja ligjore në Kosovë, nga imuniteti i garantuar sipas Urdhëresës së UNMIK-ut 2000/47. ³⁸ Civilët, duke përfshirë dhe policinë e UNMIK-ut, për këtë arsye mund të ndiqen ligjërisht vetëm në qoftë se sigurohet pezullimi i imunitetit nga Sekretari i Përgjithshëm i UN-it; imuniteti për personelin e KFOR-it mund të hiqet nga kreu i batalionit të kombit të tyre.

Kapitulli 2: Trafikimi i grave dhe vajzave në Kosovë

*“Më në fund unë arrita në një bar në Kosovë, [dhe u] kyçta brenda dhe u detyrova të prostituoj. Në bar unë nuk paguhesha kurrë, unë nuk mund të dilja jashtë vetë, pronari u bë gjithnjë e më shumë i dhunshëm sa më shumë kalonin javët; ai më rrihte dhe më përdhunonte mua dhe vajzat e tjera. Ne ishim “pronë” e tij, tha ajo. Duke na blerë ne, ai kishte blerë të drejtën të na rrihte, të na përdhunonte, të na linte pa bukë, të na detyronte të bënim seks me klientët.”*³⁹

*“Po të refuzoja [të bëja seks me klientët] unë kërcënohesha. Ai më vinte revolen në kokë dhe më thoshte: “në qoftë se ti nuk e bën këtë gjë minutën tjetër, ti do vdesësh.”*⁴⁰

Disa gra janë trafikuar në Kosovë nga jashtë, disa nga brenda vetë Kosovës. Nuk ka llogaritje të sakta të shifrave, por sigurisht disa qindra gra janë trafikuar nga shtëpitë e tyre dhe janë detyruar të punojnë si prostituta.⁴¹²⁵

Statistikat e përdorura në këtë raport lidhen vetëm me gratë e ndihmuara nga organizata që punojnë me gratë e trafikuar. Për këtë arsye, ato nuk pasqyrojnë shifrat totale të atyre që mund të jenë trafikuar për në dhe brenda Kosovës, sesa eksperiencën e individëve të cilët, nëpërmjet bastisjeve të policisë ose me metoda të tjera informimi, kanë marrë asistencë. Ndonëse TPIU-ja ka llogaritur se rreth 90 për qind e grave që punojnë në industrinë e seksit në Kosovë janë trafikuar, organizatat

³⁹ Grua moldave, prind i vetëm, 21 vjeç.

⁴⁰ Intervistë e një NGO-je, grua e trafikuar në Kosovë.

⁴¹ *Viktimat e Trafikimit në Ballkan, po aty.*, [fq. 46] duke cituar një këshilltar të UNMIK-U: “ka të paktën 1,000 në mos 2,000... Vendasit u thonë punonjësve të asistencës sociale dhe anëtarëve të organizatave ndërkombëtare se tani ka bare dhe bordello edhe në fshatrat e vogla. Vetëm në një qytet të vogël, një burim i OSCE dalloj pesë gra në një javë, që ka mundësi të jenë trafikuar.”

ndërkombëtare llogaritin se vetëm një e treta e grave të trafikuar kanë marrë ndonjëherë asistencë.⁴²²⁶

Gratë dhe vajzat e trafikuar në Kosovë

Afro 406 gra të huaja u ndihmuan nga IOM-i në Kosovë midis dhjetorit 2000 dhe majit 2003. Sipas IOM-it, në Kosovë pothuajse 48 për qind e grave që hynë në programin e tij të riatdhesimit- duke u dhënë mundësinë që të kthehen në vendet e tyre amtare- ishin me origjinë nga Moldavia. Nga pjesa e mbetur, 21 për qind vinte nga Rumania, 14 për qind nga Ukraina, 6 për qind nga Bullgaria, 3 për qind nga Shqipëria dhe pjesa tjetër nga Rusia dhe vetë Serbia.

Origjinat e grave të regjistruara nga TPIU-ja më 2003 tregojnë një profil të ndryshëm, dhe dëshmojnë se gratë dhe vajzat nga Shqipëria (ca nga të cilat janë asistuar nga IOM-i) dhe shqiptaret kosovare të trafikuar nga brenda, përbëjnë 36 për qind të grave të regjistruara nga TPIU-ja që punonin në bare dhe lokale të tjera që dyshoheshin për përfshirje në trafikim. Nga gratë prej vendeve të tjera, 27 për qind ishin nga Moldavia, 45 për qind nga Bullgaria, nëntë për qind nga Rumania dhe thuajse shtatë për qind nga Ukraina.⁴³²⁷

Gratë e trafikuar në Kosovë vijnë nga disa prej vendeve më të varfra të Evropës Lindore. Ato kanë vuajtur më shumë se një dhjetëvjeçar anarkie ekonomike, i rënduar nga diskriminimi gjinor, në vende që kanë kaluar një rritje dramatike të varfërisë dhe papunësisë.

*“Unë isha e dëshpëruar, dhe jo sepse kisha probleme me prindërit e mi, siç dëgjoj nga vajzat e tjera, por sepse në ishim shumë të varfër... Gjyshja ime kishte një pension shumë të vogël dhe nëna ime kishte vetëm asistencën shtetërore për tre vëllezërit e mi. Ne duhet të merrnim pagesën për ushqimet, që im atë supozohet të na e japë neve, por ai vetëm se na injoron dhe nuk na ndihmon aspak.... Unë nuk mund të rroja më gjatë me pensionin e gjyshes sime, prandaj thashë se do të ishte më mire të shkoja diku gjetkë, ku do mund të punoja shumë dhe do fitoja ca para për të ndihmuar familjen time dhe vëllezërit e mi.”*⁴⁴²⁸

Më shtator 2002, IOM-i botoi një analizë të profilit social të 168 grave dhe vajzave nga Moldavia, për të cilat ato kishin dhënë ndihmë, gjashtë për qind e të cilave ishin vajza nën moshën 18 vjeç.⁴⁵²⁹ IOM-i konstatoi se shumica e grave dhe vajzave (57 për qind) kishte marrë vetëm

⁴² Barbara Limanowska, *Trafikimi i Qenieve Njerëzore në Evropën Juglindore*, OSCE/ODIHR, UNICEF, UNHCHR, 2002 fq. 140; për bazën e këtyre llogaritjeve, shih fq. 142.

⁴³ TPIU, *Raporti Vjetor 2003*.

⁴⁴²⁸ Grua e trafikuar në Kosovë.

⁴⁵²⁹ IOM Kosovë, *Projekti i Kthimit dhe i Riintegrit, Raporti i Situatës-Shkurt 2000 deri shtator 2002*, 2002, fq. 13.



arsim fillor, 24 për qind kishte marrë arsim tetëvjeçar, 15 për qind ishte arsimuar deri në moshën 18 vjeç dhe katër për qind kishte ndjekur universitetin. Mbi 70 për qind e quanin veten si të varfra ose shumë të varfra, ato që ishin të punësuar fitonin më pak se 30 \$US (30 €) në muaj. Rreth 88 për qind e këtyre grave dhe vajzave i tha IOM-it se shkak i tyre kryesor që lanë Moldavinë ishte për të gjetur punë.

Afro 37 për qind e këtyre grave dhe vajzave ishin nënashpesh të ndara ose të divorcuara; disa ishin nëna të vetme ose vejusha; më pak se 10 për qind ishin nga sa thuhet të martuara ose bashkëjetonin në një marrëdhënie të qëndrueshme.

Mjaft gra të trafikuar kishin vuajtur tashmë dhunime të integritetit të tyre fizik dhe psikik në vendet e tyre amtare. Bazuar në intervistat me 105 gra të trafikuar, IOM-i konstatoi se afro 22 për qind ishin dhunuar fizikisht ose psikologjikisht brenda familjeve të tyre; një tjetër 15 për qindësh raportoi dhunë fizike dhe seksuale; gjashtë për qind raportoi abuzim fizik ose psikologjik nga burri ose partneri.⁴⁶³⁰

Bazuar në këto intervista, IOM-i konkludon se vendimi përfundimtar i mjaft grave për të braktisur shtëpinë u përsheptua nga një grindje më prindërit e tyre ose partnerin, ose një episod i dhunës shtëpiake, si në rastin e mëposhtëm :

“Pas abuzimeve të përsëritura nga i shoqi, që arritën kulmin me kërcënime për ta qëlluar me thikë dhe për ta vlarë atë, një grua rumune me tri fëmijë e braktisi të shoqin dhe, përkohësisht, i mbajti fëmijët tek shtëpia e prindërve të saj. Kushërira e burrit të saj, që e dinte gjendjen e saj, i tha se njihje dikë që organizonte udhëtime për në Gjermani. Duke shpresuar se do të mund të gjente një punë në Gjermani, me ndihmën e një tezeje që jetonte atje, ajo pranoi të shkonte. Gjatë rrugës ajo konstatoi se ishte shitur dhe se ishte trafikuar në Kosovë.”

Në rastet kur gratë nuk mund të gëzojnë të drejtat e tyre sociale dhe ekonomike dhe kur natyra e tyre delikate rëndohet nga abuzimet dhe keqtrajtimi brenda familjeve të tyre, mjaft gra nga vende si: Bullgaria, Moldavia, Rumania dhe Ukraina mund ta shohin mundësinë për të punuar jashtë vendit si një zgjedhje pozitive, që u ofron atyre një mundësi tjetër dhe shansin për të fituar atë që ato presin të jetë mjaft herë më shumë se çka ato mund të fitojnë në shtëpi.

⁴⁶³⁰ IOM Kosovë, *Një Vështrim i Përgjithshëm i Mbështetjes Psikologjike dhe Shërbimit të Dhënë Viktimave të Trafikimit*, shtator 2003, fq. 4-5.

Rekrutimi

*“...në një kryeqytet, qoftë Tirana ose Budapesti, Praga ose Varshava...diku do të ketë një hotel, një kinema, një bar, një restorant, një kafene...me emrin, siç e dëshirojmë, Evropa... Evropa është një ...bollëk: ushqim, makina, dritë, çdo gjë....Ajo është toka e premtuar, Utopia e re...”*⁴⁷³¹

Deri diku pak gra rrëmbehen, të flakura në fundin e një makine dhe të transportuara për t'u shitur. Sipas IOM-it, vetëm tetë për qind e grave të trafikuar nga Moldavia në Kosovë raportohet të jenë rrëmbyer me forcë; shumë prej tyre zgjodhën për të punuar jashtë se u ishte premtuar të punonin në Itali – megjathtë puna dhe vendi që u ishte premtuar ishte mjaft i ndryshëm nga çfarë i priste ato.⁴⁸³² Sipas IOM-it, 80 për qind e grave raportojnë se ato janë rekrutuar nga një i afërm, një mik ose një i njohur. Në pothuajse gjysmën e rasteve, ky person është një grua, shpesh një mik:

*“Unë kam tri vjet këtu. Unë isha 17 vjeçe kur erdha këtu. Miku im më tha: 'Do të shkosh e të punosh në Kosovë?' Une thashë jo. ... në shtëpi isha e mërzitur. Unë nuk kisha çfarë të bëja, pra, i telefonova atij. Unë erdha të punoj për 10-15 DM, që është 5 – 7 Euro, si kamariere. Kjo ishte pagesë ditore. Une kalova dy javë në Beograd në një familje të mirë atje-njerëz shumë të mirë.... pastaj ata morën një pasaportë falso dhe mua më çoi një burrë në kufirin e Kosovës. ... Unë dhe miku im kaluam kufirin, vetëm ne. Ne qëndruam në një hotel, pastaj një ditë më vonë shkuam në Prizren. Dy javë në një hotel në Prizren dhe atëherë miku im i pagoi të gjitha. Ai më çoi në një bar në një fshat pranë Prizrenit. Pastaj miku im më braktisi dhe unë nuk e kam parë qysh atëherë.”*⁴⁹³³

Këta miq e të njohur mund të premtojnë punë në Itali ose gjetkë në Evropën Perëndimore-si kamariere, punëtore shtëpie, dado, valltare, mendeshë- duke u thënë atyre se do të fitojnë deri më 1,000 € ose 1,500 € në muaj.⁵⁰³⁴ Gratë rekrutohen gjithashtu edhe nga agjencitë e udhëtimit ose gazetatat, reklamat për valltare, modele, kamariere ose për striptizë. Mjaft premtime janë më të zakonshme: një nëna të vetmuar që fitonte 30 € në muaj duke punuar në një bar në vendin e saj amtar iu premtua 300 € në muaj si kamariere në Kosovë:

⁴⁷³¹ Slavenka Drakulic, *Kafë Europa. Jeta pas komunizmit*, përkth., Londër, 1996, fq. 5 & 12.

⁴⁸ IOM Kosovë, *Projekti i Kthimit dhe i Riintegritimit*, 2002, fq. 14. Shih edhe “Raporti i Entitetit: Kosova”, në *Pika Rajonale e Informacionit, Raporti Vjetor për Viktimat e Trafikimit në Evropën Juglindore*, IOM, Pakti i Stabilitetit, Komisioni Katolik Ndërkombëtar i Migritimit (ICMC), 2003.

⁴⁹ Grua e trafikuar nga Moldavia; Ajo u detyrua më vonë për prostitucion.

⁵⁰ Më rrallë strategjitë përfshijnë premtimin për martesë në vendet e Evropës Perëndimore .



“Unë kisha një mikeshë që punoi këtu. Ajo nuk është e bukur. Bosi i saj e pyeti nëse kishte ndonjë mikeshë të bukur. Ajo foli me mua dhe më propozoi për kamarierë.” 51³⁵

Rreth 22 për qind e grave moldave të intervistuar nga IOM-i ishin të paktën pjesërisht në dijeni se ato mund të punonin në ndonjë sektor të industrisë së seksit.⁵² Sidoqoftë, ato ende prisnin të punësoheshin ligjërisht.

Kjo grua e re, për shembull, u punësua fillimisht për striptizë: *“Unë kam një mikeshë që punonte këtu. Kur ajo u kthye, më tha se ka një punë. Ajo tha se do ta rregullonte për një kontratë dhe pastaj ne mund të shkojmë bashkë. Tri nga ne shkuan bashkë. Kontrata ishte shqip dhe anglisht. Ishte përkthyer në rusisht. Ishte për të fituar 300 € në muaj, dhe pastaj 50% zbritje për pijet. Ne premë një biletë nga Kievi për Stamboll e Prishtinë. Unë gjithshu u propozova mikeshave të tjera të mia të shkonim bashkë. Ne erdhëm tri. Kur erdhëm në Gjakovë, shkuam tek një avokat për të firmosur kontratën dhe për një kontroll mjekësor, dhe të regjistroheshim në polici, se do të punonim.” 53³⁶* Ajo u kap më vonë në një bastisje policore, më tej raportohet se mjaft gra të tjera të punësuar në këtë klub u transferuan në lokale të tjera dhe u detyruan për prostitucion.

Gjithnjë e më shumë, rekrutuesit po zgjedhin gra me kontrata të ligjshme punësimi në dukje. Kjo synon si për ta shmangur ligjin, dhe për të qetësuar frikën e grave se ato do t'i nënshtrohen shfrytëzimit. Disa kontrata shpesh përcaktojnë shprehimisht se prostitucioni është i përjashtuar nga kontrata, ose është i ndaluar në ndërtesat ku ato do të punojnë. ⁵⁴

Disa gra – IOM-i i llogarit vetëm nën tre për qind – janë në dijeni se do të punojnë si prostituta. Një grua, me krahët e saj të mbuluar me djegie, e cila kishte shpëtuar duke kërcyer nga dritarja, tha: *“Po, natyrisht që e di... Unë kam pesë vëllezër dhe motra, asnjëri nga ne në shtëpi nuk punon ...por për mua kjo nuk ishte ajo që unë prisja – Unë mendova se do të paguhesha ... Unë do të doja t'i zgjidhja klientët e mi – ky nuk është prostitucion.” 55³⁸*

Udhëtimi

Rrugët e trafikimit

“Atë natë dy serbë erdhën atje dhe morën me vete dy vajza të tjera dhe mua. Të gjitha ne hymë [në Jugosllavi]

⁵¹ Grua e trafikuar nga Bulgaria.

⁵² IOM-i përdor termin “punë e lidhur me seksin”.

⁵³ Grua ukrainase; referimi i saj për një kontroll mjekësor do të thotë se ajo priste të punonte si prostitutë.

⁵⁴ Intervistë e AI me personelin e IOM-it, shtator 2003; shih edhe procedimet në rastin e Klubit të Miami Beach, fq. 16-17, më poshtë.

⁵⁵ Grua e trafikuar.

ilegalisht, së pari me makinë dhe pastaj duke përshkuar lumin me këmbë, deri sa takuam dy burra të tjerë që po prisnin ne. Këta burra na çuan në një shtëpi për të kaluar natën dhe të nesërmen dikush tjetër na çoi tek një shtëpi tjetër. Unë nuk e di emrin e qytetit që ishim duke ndenjur. Ishte një grua që na mori me vete këtë herë.” 56³⁹

Më shumë se gjysma (52 për qind) e grave që vijnë në Kosovë trafikohen nëpërmjet Serbisë, nga 22 për qind që vijnë nëpërmjet Maqedonisë.⁵⁷⁴⁰ Gratë trafikohen gjithashtu për në Kosovë nga Shqipëria. Sipas Policisë Kufitare të UNMIK-it, rreth 10 gra në javë trafikohen nëpërmjet aeroportit të Prishtinës, nga të cilat të gjitha kanë një kontratë të ligjshme punësimi në dukje.⁵⁸⁴¹

Shtrirja gjeografike e Serbisë, një dhjetëvjeçar lufte dhe sanksionesh dhe lulëzimi i krimit të organizuar⁵⁹⁴² e kanë bërë Serbinë një bosht qendror të trafikimit të grave nga Evropa Qendrore dhe Lindore për në Kosovë, Bosnjë-Hercegovinë, Shqipëri dhe, tani e tutje, për në Evropën Perëndimore nëpërmjet Italisë ose Greqisë.

E shitur “si një copë leckë”

Gratë merren zakonisht në grupe të vogla për në “firmat tregtare”, në hotele dhe apartamente private përqark Beogradit, Pançevos dhe Novi Sadit, po ashtu edhe në Mal të Zi. Atje ato vihen të parakalojnë para blerësve të mundshëm, shpesh duke u detyruar të zhvishen para se t'u shiten “pronarëve” të tyre të rinj.

“Në fillim ata do të na vinin të zhvisheshim dhe të rrinim vetëm me të brendshmet, të na vështronin e të shihnin se si dukeshim. Në qoftë se ti dukesh OK dhe ata [të pëlqejnë] do të të blejnë.” 60⁴³

“Ata na vënë në një radhë, në këmbë, dhe pastaj ulen në karrike dhe na shikojnë, duke zgjedhur një prej nesh.”

“Ti nuk do ta marrësh vesh se kush të bleu. Ata vetëm do të vijnë e do të të thonë se duhet të bëhesh gati, sepse ti [do të] ikësh.” 61⁴⁴

Një gazetar që vizitoi një “firmë tregtare” pranë Beogradit, i konfirmoi këto raporte. Ai vëzhgoi gjithashtu një burrë duke bërë pazar për një grua, ndërsa i fliste blerësit me telefon celular.⁶²⁴⁵

⁵⁶ E cituar po aty., fq. 8.

⁵⁷ “Raporti i Entitetit: Kosova”, Raporti i Parë Vjetor i Pikës Rajonale të Informacionit, fq. 134.

⁵⁸⁴¹ Intervistë e AI me Stefano Failla, Shef i Hetimeve, Policia Kufitare/e Vijës Kufitare e UNMIK-it, shtator 2003.

⁵⁹⁴² Shih Amnesty International, Serbia dhe Mali i Zi: Njoftime për torturë gjatë “Operacionit Sabre”, AI Index: EUR 70/019/2003, shtator 2003.

⁶⁰⁴³ Rrëfimi i një gruaje të trafikuar, se si ishte “blerë”.

⁶¹ Gra të trafikuar në Kosovë përshkruajnë se si ishin shitur.

⁶²⁴⁵ Intervistë e AI, shtator 2003



Prej këtu, gratë mund të trafikohen për në një sërë destinacionesh, duke përfshirë Kosovën. Rrjete të tjera veprojnë brenda dhe ndërmjet komuniteteve shqiptare në Serbinë Jugore, Kosovë dhe Maqedoni.⁶³⁴⁶

Disa gra mund ta shohin veten të mbahen në Kosovë vetëm për pak kohë, para se të dërgohen për në destinacione të tjera. Si shumë vende të tjera ballkanike me kufij porozë, pa regjim vizash dhe me sisteme të dobta ligjore dhe ekonomike, Kosova është gjithashtu një vend tranzit. Mund të jetë një çështje shansi në rast se një grua nuk e sheh veten të trafikuar në Itali ose Kosovë.

Në tranzit

Shumë gra janë të ndërgjegjshme se udhëtimet e tyre përmes vendeve tranzit nuk janë plotësisht të ligjshme. Ndonjëherë dyshimet e tyre ngrihen qysh kur janë në vendet e tyre amtare. Gratë mund të mbahen në një dhomë të kyçura ose të lëvizin vetëm gjatë natës nga disa individë të ndryshëm radhazi, ndonjëherë duke përfshirë edhe oficerë të zbatimit të ligjit. Në kohën që janë çuar në një vend tjetër, disa nisin të kuptojnë çfarë po ndodh ose u thuhet se ato janë trafikuar.

Këto gra janë privuar në mënyrë të paligjshme nga liria e tyre, duke shkelur të drejtat e tyre për lirinë dhe sigurinë e personit, të mishëruara në nenin 9 të ICCPR-së dhe në Nenin 5 të ECHR-së. Pak nga ato përpiqen të shpëtojnë. Dokumentet e tyre të identifikimit janë marrë zakonisht, dhe u është thënë se, në qoftë se arratisen, nuk ka të ngjarë që ta arrijnë ose ta kalojnë kufirin pa u arrestuar.⁶⁴⁴⁷ Disa trafikantë kërkojnë që t'i qetësojnë ato duke u thënë se, sapo të arrijnë destinacionin e tyre, çdo gjë do të shkojë për bukuri. Gra të tjera kanë raportuar se janë droguar ose u janë bërë qetësues. Gratë që protestojnë u nënshtrohen kërcënimeve të egra dhe abuzimeve të përshtatshme si proces "qetësimi" - shpesh duke përfshirë rrahjen dhe përdhunimin. Ky abuzim është projektuar me paramendim për t'u shtënë frikën grave dhe për të krijuar varësi nga trafikuesit e tyre.

Nga kjo pikëpamje, gratë janë skllavëruar efektivisht ose "përvetësuar" nga trafikuesit e tyre, nga ndërmjetësuesit, dhe, së fundi, nga pronari i lokalit ku ato do punojnë. Ndonëse disa gra nuk kanë dijeni, deri sa arrijnë në Kosovë, se janë shitur, të tjera kanë vënë re parë që ndërrojnë duar, ose janë përdhunuar nga blerësit kur ata "përpiqen të bëjnë pazar".

⁶³⁴⁶ Në proceset gjyqësore të 2002 në Gjykatën e Qarkut të Prishtinës u zbulua një rrjet që përfshinte gjashtë të pandehur shqiptarë, dy prej të cilëve me origjinë nga bashkia e Bujanovcit në Serbinë Jugore, dy nga Ferizaj në Kosovë dhe dy nga bashkia e Tetovës në Maqedoni, shih Vendim P. nr 225/2002, 2 tetor 2002.

⁶⁴⁴⁷ IOM Kosovë llogarit që më pak se gjysma e grave të trafikuar kanë ndonjë lloj dokumenti ligjor.

Gratë janë shitur shpesh disa herë derisa, madje para se të arrijnë në Kosovë. Sipas IOM-it, gratë mund të shiten midis 50 € dhe 3500 € në varësi nga vendi i saj i origjinës. Në kohën që ajo mbërrin në Kosovë, mund të jetë blerë dhe shitur disa herë, çmimi i saj ngrihet çdo herë që ajo është rishitur.⁶⁵⁴⁸

Në Kosovë

*"Unë nuk mund të ngopem asnjëherë më gjumë. Unë bie në shtrat rreth orës 4 ose 5 në mëngjes, pasi pastroj të gjitha tavolinat, enët, gotat dhe dyshemetë, dhe gotat e thyera nëpër kafene. Une jam e rrskapitur kur shkoj në shtrat dhe nuk mund të fle menjëherë. Në orën 10 ose 11 të mëngjesit unë mund t'i dëgjoj ata duke na bërtitur për t'u zgjuar dhe ne duhet të bëjmë pastrimin e dhomave dhe shtretërve, dhe të gjithë çarçafët. Klientë vijnë herët në kafene dhe ne duhet t'u shërbejmë atyre. Neve na jepet ushqim sikur të ishim kafshë, shumë shpesh ne duhet të hamë gfarë ka mbetur; ne duhet t'u shërbejmë klientëve deri në mbrëmje dhe rreth orës 11 duhet të shkojmë të shërbejmë [të bëjmë seks me] klientët në dhomat e tyre. Ndonjëherë ky shërbim nis më herët."*⁶⁶⁴⁹

Me të mbërritur në Kosovë, gratë çohen në bare, restorante ose klube ku ato ose i shiten një pronari të ri, ose punojnë për trafikantin. Disa gra fillojnë duke punuar si kamariere, duke shërbyer ushqimin ose pijet.⁶⁷⁵⁰ Të tjera janë të detyruara të prostitudojnë menjëherë, shpesh duke parashikuar që të punojnë si kamariere gjatë ditës dhe si prostituta natën.

Një dëshmi në Gjykatën e Qarkut të Prishtinës tregoi se si grave të kontraktuara për të punuar si valltare në klubin Miami Beach në Prishtinë, u kërkohej të punonin si prostituta-pavarësisht nga pretendimet e mbrojtjes se prostitucioni ishte i ndaluar sipas rregullores së firmës dhe se gratë thjesht nxiteshin të "krijonin atmosferë".⁶⁸⁵¹ Gruaja përshkroi se si atyre u thuhej që t'u thoshnin klientëve të mundshëm se, po që se ata dëshironin të rrinin vetëm me ato, atëherë duhet të blinin një shishe shampanjë. Në varësi se sa shumë pagoi klienti - duke filluar nga 50 DM deri në 2.400 DM për shishe - ai kishte të drejtë për një periudhë kohe me gruan në një nga anekset ose kabinat që rrethonin sheshin e vallëzimit. Një shishe edhe më e madhe dhe më e shtrenjtë i jepte të drejtë klientit të

⁶⁵⁴⁸ IOM Kosovë raporton se kosovaret, bullgaret dhe shqiptaret janë "më të lirë" dhe ukrainaset, moldavet "më të shtrenjtat", Intervistë e AI me IOM-in dhe e-mail i marrë prej IOM-it, IOM, Kosovë.

⁶⁶⁴⁹ I mitur i trafikuar brenda vendit, vjeç 17.

⁶⁷⁵⁰ Tradicionalisht, puna në bare dhe restorante ka qenë një punë meshkujsh në Kosovë, megjithatë kjo nuk është më gjendja, veçanërisht në qytete të mëdha.

⁶⁸⁵¹ Gjykata e Qarkut të Prishtinës, P.No.137/2001; akt-akuza PP No, 287/2001, datë 4 shtator 2001. Gjyqi u zhvillua mes 4 dhjetorit 2001 dhe 25 janarit 2002.



bënte seks me gruan në një hotel ose apartament privat. Sisteme të ngjashme veprojnë edhe në lokale të tjera.

Privimi i lirisë

Kufizimet për lirinë e lëvizjes së gruas nisin herët në procesin e trafikimit, kur asaj i merren pasaporta ose dokumentet e udhëtimit. Pa këto dokumente një grua ka të ngjarë të arrestohet për shkelje të [ligjeve]emigracionit ose shkelje të tjera. Privimi nga liria e tyre vazhdon përgjate gjithë procesit:

“...shumica e grave mbahen kundër dëshirës së tyre në kushte që ju nuk do të mbanit as edhe një kafshë”, Ish-kryetar i TPIU-së.⁶⁹

Grave të trafikuar rrallë u lejohet ndonjë liri lëvizjeje jashtë ndërtesës në të cilën ato punojnë. Ato janë të kufizuara si nga kërcënimet, ashtu dhe nga detyrimi, ose nga të kyçurit brenda.

“Ne punonim nga 9 paradite deri 11 pasdite. Pas kësaj, tha ai, ‘Ju bëni çfarë të doni’, por ne na kyçnin. Kur ne kërkuam të dilnim jashtë, ai tha, jo, se ne duhet të ishim aty. Ne flinim në një dhomë bashkë, unë dhe vajza tjetër. Të gjitha dritaret kishin hekura. Ai nuk më rrahu ndonjëherë; kishte vetëm kërcënime psikologjike. Ne detyroheshim në atë mënyrë; Unë nuk mund të dilja jashtë.”⁷⁰

Një grua i raportoi CPWC-së se ajo ishte kyçur në një dhomë dhe ishte mbajtur në errësirë, pa mundur, madje, të shikonte edhe burrat që hynin në dhomë për të bërë seks me të. Një tjetër NGO që punonte me gratë e trafikuar në Kosovë, raportonte se shumë nga gratë e reja me të cilat ato punonin, ishin mbajtur në mënyrë të ngjashme, dhe ishin kaq të çorientuara, saqë nuk kishin idenë se me sa burra ishin detyruar të bënin seks.⁷¹

Tek një gjyq në Gnjilane/Gjilan më 2002, një grua e trafikuar dëshmoi se ishte mbajtur në një qilar ku ajo flinte natën dhe u shërbente klientëve gjatë ditës. Ushqim, pije dhe një kovë për ta përdorur si banjë i çohet asaj poshtë. Ajo dilte nga qilari vetëm kur transportohej nga i pandehuri për të takuar klientët.⁷²

Disa gra kanë qenë të mbyllura në dhoma hotelesh, pa u lejuar madje të dalin jashtë për të blerë materiale higjienike.⁷³ Gra të tjera ishin lejuar të dilnin jashtë për pazar, por të shoqëruara dhe pa pasaporta ose dokumente udhëtimi. Disa gra, sidoqoftë, kanë arritur të shpëtojnë:

⁶⁹ Intervistë me Ish-kreun e TPIU-së, “Duke i Shpëtuar Vajzat nga Jeta e Skllavërisë Seksuale”, *Gazeta e Belfastit*, 30 korrik 2002.

⁷⁰ Grua rumune e trafikuar në Kosovë.

⁷¹ Intervistë me personelin tek CPWC dhe CPVPT.

⁷² Vendim gjyqi, N.F., 15 maj 2002, Gjykata e Qarkut Gjilan/Gnjilane.

⁷³ Vendim gjyqi Pr. Nr. 131/2001.

“Unë mendoja vazhdimisht mbi një mënyrë për të shpëtuar. Kur një klient më mori për në një qytet pranë me makinën e tij, unë përfitova nga rasti dhe ia mbatha. Pas disa orësh, duke u fshehur nëpër shkurre, unë trokita në një derë për të kërkuara ndihmë. Një burrë i ri hapi derën dhe më tha të prisja: unë kisha frikë se do më shiste, por unë e dija se asgjë nuk mund të ishte më e keqe sesa të kthehesha prapë në bar. Ai i telefonoi policisë.”⁷⁴

Pas bastisjeve të TPIU-së në bare dhe restorante, trafikantët i lëvizën shumë gra për në ndërtesa të tjera-mjaft shpesh dhoma në apartamente private. Këtu ato presin klientët të drejtuar nga baret ose nëpërmjet telefonit. Pothuajse të gjitha këto gra janë të mbyllura brenda, pa liri për çfarëdo lëvizje, dhe shkallët e dhunës, duke përfshirë përdhunimet, raportohet të jenë shumë më të larta se sa në bare.⁷⁵

Torturë dhe forma të tjera të trajtimit të egër, çnjerëzor dhe degradues

“Para se të shitesha në një bar në Prizren, unë u mbajta në një apartament në Gjilan për katër ditë dhe u përdhunova nga rojat disa herë.”⁷⁶

Gratë dhe vajzat e trafikuar i nënshtrohen rregullisht torturës, duke përfshirë përdhunimin dhe forma të tjera të trajtimit të egër, çnjerëzor dhe degradues, të cilat dhunojnë të drejtat e tyre sipas Nenit 7 të ICCPR-së, Nenit 3 të ECHR-së dhe Nenit 37 të Konventës për Fëmijët. Më shumë se gjysma e grave të intervistuar nga IOM-i raportuan se ato janë abuzuar fizikisht nga pronari i barit. Një tjetër 25 për qindësh tha se ato gjithashtu ishin rrahur nga personeli i barit, klientët ose njerëz të tjerë.

Strehëzat që punojnë me gratë e trafikuar në Kosovë raportojnë se rreth 40 për qind e grave mbajnë shenja të abuzimeve fizike kur hyjnë në strehëz; ato kryesisht ishin djegur, por disa kishin edhe brinjë të thyera. Një grua ishte rrahur kaq egër, saqë u riatdhesua menjëherë për operim për të shpëtuar shikimin e saj.⁷⁷

Në një rast, dyshohet se një grua 18-vjeçare moldave, trupi i së cilës u gjet në një lumë pranë Prizrenit më 19 shkurt 2001, mund të jetë vrasë. Gruaja, e cila u gjet me çantën dhe dokumentet e saj, kishte vdekur në dukje nga mbytja. Sipas Policisë së UNMIK-ut, meqenëse lumi ishte shumë i cekët në atë pikë, ata dyshuan se ajo mund të ishte mbytur më forcë ose ishte hedhur në lumë ndërsa ishte ende gjallë, dhe ishte mbytur kur ishte pa ndjenja. Më vonë u çel një hetim për vrasje. Megjithatë, ndonjëse policia

⁷⁴ Grua 18-vjeçare moldave.

⁷⁵ Intervistë e AI me Pasquale Lupolli, IOM, shtator 2003.

⁷⁶ Grua moldave, vjeç 21.

⁷⁷ Intervistë e AI me personelin e IOM-it; shih edhe “Raporti i Entitetit: Kosovë”, në *Raportin Vjetor të Pikës Rajonale të Informacionit*, fq. 147.



njoftoi për kallëzime dhe dyshime të forta në përfshirjen e trafikantëve, nuk u gjet provë direkte dhe nuk u identifikuan të dyshuar. Çështja u mbyll më vonë më 4 prill 2001 nga prokurori, por çështja mbeti hapur dhe raportohet se është riparë më mars 2004, për arsye të informacione të reja të cilat "dolën në dritë në dy vitet e fundit".⁷⁸⁶¹

Në proceset gjyqësore kundër trafikantëve të dyshuar, gratë e trafikuaru zakonisht dëshmojnë se dhuna është përdorur si një mjet detyrimi dhe kontrolli. Për shembull, Gjykata e Qarkut Prishtinë dëgjoi një dëshmi se 11 gra, të kontraktuar për të punuar si valltare tek klubi Miami Beach në Prishtinë, i ishin nënshtruar prostitucionit të detyruar dhe, për një periudhë të paktën gjashtëmuajore, një radhe shkeljesh të tjera të të drejtave të njeriut. Shtatë nga gratë dëshmuar⁷⁹⁶² se i pandehuri mbante një revole në brez, të me të cilën zakonisht i kërcënonte, me qëllim që t'i detyronte për të siguruar seks për klientët. Një grua ishte rrahur me një patericë që i pandehuri e mbante në zyrën e tij.⁸⁰⁶³

Familjet e grave gjithashtu kërcënohen. L.J.-së, për shembull, iu tha nga pronarët e saj se, po qe se ajo refuzonte të ofronte shërbime seksuale, ata do ta vrisnin vajzën e saj tre vjeçe e cila rrinte në shtëpi në vendin e saj të origjinës. Sipas dëshmisë së paraqitur në gjyq, vajza ishte marrë më vonë peng.⁸¹⁶⁴

Gratë e trafikuaru dhe vajzat mund të përdhunohen në tranzit dhe disa përdhunohen më vonë në mënyrë të përsëritur nga pronarët e tyre, të cilët i përdhunojnë si një mjet kontrolli dhe detyrimi.⁸²⁶⁵ Një grua moldave e trafikuar në Pejë/Pec dëshmoi në procesin hetimor se, kur ajo refuzoi të punonte si prostitutë, i pandehuri e rrahu dhe e përdhunoi atë, me sa thuhet, për t'i mësuar çfarë do të ndodhte në qoftë se ajo nuk bënte çfarë i thuhej.⁸³⁶⁶

Rrethanat shtrënguese të grave të trafikuaru e bëjnë gjithashtu të pamundur për ato të japin miratimin e tyre të

⁷⁸⁶¹ E-mail për AI nga Derek Chappell, Policia e UNMIK-ut, 12 mars 2004.

⁷⁹⁶² Pohimi i tyre u bë në stadin hetimor të procedurave gjyqësore, shih Kapitulli 4, më poshtë.

⁸⁰⁶³ Shih Vendimin, Gjykata e Qarkut Prishtinë, P. No. 137/2001 dhe apeli i Vendimit, Gjykata e Lartë e Kosovës, AF 80/2002.

⁸¹¹ Shih Gjykata e Lartë Kosovë, Çështje Vendim Apeli, 3 prill 2003 kundër vendimit të Gjykatës së Qarkut Prishtinë P. nr. 225/2003.

⁸²⁶⁵ Shih, për shembull, vendimi P. No 10/2001 i 26 prill 2001, në të cilin tri burra serbë të deklaruar fajtorë dhe të dënuar më vendim gjyqi, së bashku me dy të tjerë, për shkeljen trafikim u shpallën fajtorë gjithashtu për përdhunim. Dy gra moldave dhe dy gra serbe dëshmuar se ato u përdhunan si një mënyrë për t'i detyruar për të punuar; vendimi u konfirmua në apel; shih vendimin AP.252/2001, 19 mars 2003.

⁸³⁶⁶ Shih Departamentin e të Drejtave të Njeriut dhe të Rendit të OSCE-së, Kosovë, *Një Vështrim i Sistemit Penal, 1 shtator 2000 – 28 shkurt 2001*, fq. 58-9; i pandehuri u dënua më vonë me tre vjet dhe gjashtë muaj për tri akuza për përdhunim dhe ndërmjetësim në prostitucion; ai u lirua në pritje të rigjykit në apel.

sinqertë për të bërë seks me "klientët". Amnesty International vë re se Elementet e Krimit e ICC-së nuk e kërkojnë forcën si element të përdhunimit: në këtë kuptim është e mundur që "klientët" e bordellove, që janë në dijeni për mjedisin shtrëngues në të cilin mbahen grate e trafikuaru, mund të kryejnë përdhunim. ⁸⁴⁶⁷

*"Ajo bëri seks 2,700 herë në më pak se një vit; ajo iu nënshtrua seksit me grupe; seks nën kërcënimin e armëve; [ajo] fitoi 200,000 marka gjermane [për trafikantët], ajo u kthye vërtet në viktimitë"*⁸⁵⁶⁸

Dhuna është pjesë e procesit të detyrimit. Ndonjëherë rrihet vetëm një grua, për të treguar pasojat e mosbashkëpunimit me të tjerët dhe për të përforcuar raportin e forcës mes trafikantit/pronarit dhe gruas së trafikuar. ⁸⁶⁶⁹ Kur gratë trafikohen nga burra që pretendojnë se janë "dashnorët" e tyre, një përzierje bujarie dhe dhune mund të përdoret për të përforcuar varësinë e gruas së trafikuar pas trafikuesit të saj.

Gratë e trafikuaru u nënshtrohen në mënyrë të përsëritur abuzimeve psikologjike. Kjo mund të përfshijë frikësim dhe kërcënime, gënjeshtër dhe mashtrim, manipulim emocional dhe pengmarrje, veçanërisht duke i kërcënuar se do t'u thonë familjeve të tyre në atdhe rreth natyrës së vërtetë të punës së tyre.

Trafikantët i mbajnë gratë vazhdimisht të pasigurta, duke krijuar një mjedis të pa-parashikueshëm dhe të pasigurt, ⁸⁷⁷⁰ duke përfshirë lëvizjen e gruas nga njeri vend në tjetrin, siç përshkruhet nga mjaft gra të trafikuaru në Kosovë. Ai përfshin gjithashtu mbajtjen e tyre në kushte që Amnesty International i konsideron se mund të arrijnë deri në trajtim çnjerëzor dhe degradues:

"Ne jetonim në katin e dytë, [të gjitha] vajzat në një dhomë. Bari ndodhej në katin e parë. Pronari ynë na ushqente me salçiçe mëlçie, peshk dhe bukë. Ne nuk merrnim para. Ata nuk na blenin neve asnjë rrobë. Po të

⁸⁴⁶⁷ Shih, për shembull, përkufizimin e përdhunimit si një krim kundër njerëzimit në Nenin 7(1) (g)-1 l. Shkaktari e zotëron trupin e një personi duke përfunduar me depërtimin, sado të lehtë, të çfarëdo pjese të trupit të viktimës ose të shkatërit me një organ seksual, ose nga hapja anale ose gjenitale e viktimës me çdo lloj objekti ose e çdo pjese tjetër të trupit. 2. Zotërimi shkaktohet me forcë, ose duke kërcënuar për forcë a detyrim, ashtu si ajo që shkaktohet nga frika e dhunës, egërsia, paraburgimi, shtypja psikologjike ose abuzimi me fuqinë kundër këtij personi ose një tjetër personi, ose duke përfutur nga avantazhi i një mjedisi detyruar, ose zotërimi u krye kundër një personi të paafte që të japë një miratim të natyrshëm.

⁸⁵⁶⁸ Intervistë e AI me një prokuror ndërkombëtar, mars 2003.

⁸⁶⁶⁹ IOM Kosovë, Një Vështrim i Përgjithshëm i Mbështetjes Psikologjike dhe Shërbimit të Dhënë Viktimave të Trafikimit, shtator 2003, fq. 10.

⁸⁷⁷⁰ Shih *Rreziqet e Shëndetit dhe Pasojat e Trafikimit të Grave dhe Adoleshenteve. Rezultate nga një Studim Evropian*, Kathy Zimmerman, et al, London School of Hygiene and Tropical Medicine, 2003. fq. 49-51.



refuzoja të punoja, ata më rrihnin. Kur isha sëmurë, nuk mora ndihmë. Ishte shumë ftohtë atje .88⁷¹

Gratë e trafikuar në Kosovë, raportohet se mbaheshin në kushte johigjienike, mbipopullimi dhe gjithë stres, pa mundësi për intimitet. Shumë gra duhet të flenë dhe jetojnë në të njëjtën dhomë në të cilën punojnë, shpesh me të tjerë. Të rraskapitura fizikisht nga orët e gjata dhe nga numri i klientëve me të cilët ato janë të detyruara të bëjnë seks, gratë raportojnë gjithashtu se u privohet ushqimi : *“Ne merrnim një hamburger dhe një yoghurt në ditë. Ne duhet të ndanim katër hamburger dhe një paketë cigaresh mes tetë vajzash” .89⁷²*

Një NGO që punonte me gratë e trafikuar përshkruante sa e vështirë ishte për gratë të rifitonin sensin e tyre të dinjitetit pas eksperiencës së tyre të trafikimit, pasi i ishin nënshtruar këtij trajtimi kaq poshtëronjës dhe degradues.90⁷³

E drejta për shëndet

“Unë u sëmura dhe po kollesha shumë. Kisha një dhembje koke të tmerrshme dhe temperaturë. ... Unë rrija shtrirë në krevat dhe po tretesha, kur djali i pronarit erdhi shpejt në dhomën time dhe unë u rraha keq nga ai. Si përfundim, unë vuajta nga lëndime të rënda trupore. Ndenja në shtrat për tri muaj. Përveç dëmtimeve të tjera, ai më theu edhe dorën. Gjithë kohën që kalova në krevat, ai vazhdimisht më shfrytëzoi.”91⁷⁴

Amnesty International konsideron se grave të trafikuar u janë mohuar të drejtat e tyre për shëndet, të garantuara nga Neni 12 i ICESCR-së dhe neni 12 i CEDAW-it ,sepse u është mohuar mundësia për kujdes shëndetësor nga trafikuesit e tyre dhe sepse janë detyruar të punojnë me seks të pambrojtur. Më 2002, u raportua se 36 për qind e grave të trafikuar në Kosovë thuhet se u është mohuar çdo lloj kujdesi shëndetësor, ndërsa vetëm 10 për qind u ishte siguruar mundësia për kujdes të rregullt shëndetësor; shumica e grave të trafikuar ishin detyruar të bënin seks të pambrojtur, nga vetëm 40 për qind që përdornin “në disa raste” prezervativë.92⁷⁵ Amnesty International është gjithashtu në dijeni të raporteve se gratë e trafikuar u janë nënshtruar dështimeve të detyruara.93⁷⁶

Një NGO që punon me gratë e trafikuar raportonte se disa trafikantë i shoqërojnë gratë tek doktorët

88⁷¹ Grua ukrainase e trafikuar në Kosovë.

89⁷² Grua e trafikuar për në Kosovë.

90⁷³ Intervistë e AI me Naime Sherife, CPWC, shtator 2003.

91⁷⁴ Një grua shqiptare e trafikuar brenda vendit, vjeç 21.

92⁷⁵ UNICEF, UNOHCHR, OSCE/ODIHR, *Trafikimi i Qenieve Njerëzore në Evropën Juglindore*, 2002, fq. 96.

93⁷⁶ Shih, për shembull, “Si u dhunua Shqipja 22 vjeçare?”, *Kosovarja*, 1-15 maj 2003.

privatë, faturat e të cilëve paguhen pastaj nga fitimet e grave. Në kohën që gratë çoheshin në këto klinika, gjendja e tyre ishte zakonisht mjaft serioze, por shumë gra nuk kishin mundësi të ktheheshin në klinikë për të marrë rezultatet e testeve dhe të merrnin mjekimin e uhur.94⁷⁷ Shumë gra të trafikuar vuajnë nga dëmtime afatgjata, për shkak se nuk kanë marrë mjekimin e përshtatshëm dhe në kohën e duhur.95⁷⁸ Organizata vëren se ,ndonëse strehëzat janë të afta t’u sigurojnë mjekimin e kërkuar për sëmundjet e transmetuara seksualisht grave të trafikuar, asnjë test vullnetar i HIV-it nuk është në dispozicion të tyre.

Gratë që janë trafikuar vuajnë gjithashtu nga stresi i zgjatur, sfilitja dhe ankthi, si dhe dëmtimi i dinjitetit të tyre dhe ndjenjave të vlefshmërisë së tyre .Një studim i IOM-it konstatoi se një numër i madh i grave të trafikuar shfaqën edhe gjendje që përfshinin reagime akute stresi, çrregullime stresi pas traumave, depresion dhe gjendje të tjera.96⁷⁹

Gratë e reja veçanërisht, shpesh shfaqin shenja të vetëdëmtimit, duke përfshirë prerje ose djegie me cigare në krahët e tyre. Një dëshmitare përshkroi se si ajo pa një vajzë “që me dashje digjte veten e vet në mjaft raste me cigare në vende të shumta në krahët e saj. ... ishte një klithmë e dëshpëruar për ndihmë”.97⁸⁰ Të dërguarit e Amnesty International takuan dy vajza të reja që treguan qartë shenja të ngjashme vetëdëmtimi.

Skllavëria dhe pengmarrja për borxhe

Protokolli i Trafikimit përfshin brenda përkufizimit të tij të trafikimit, skllavërinë dhe praktikat e ngjashme me skllavërinë. Këto janë të ndaluara shprehimisht në Nenin 8(1) të ICCPR-së,98⁸¹ Nenin 4 të ECHR-së, Konventën e

94⁷⁷ Limanovska, *Trafikimi i Qenieve Njerëzore në Evropën Juglindore* 2002, fq. 96. Deri më 2003, NGO-ja ndërkombëtare Komiteti i Bashkuar Metodist për Ndihmë (UMCOR) kreu një shërbim falas, duke përfshirë një klinikë ambulante, duke vendosur lidhje me pronarët e bareve dhe duke i nxitur ata t’i linin gratë të shkonin në klinikën ambulante të UMCOR-it.

95 Pasojat afatgjata të infeksioneve seksuale të transmetuara të pamjekuara mund të përfshijnë sëmundjen inflamatore të pelvikut, dëmtime të zgjatura të traktit riprodhues, veshkave dhe fshikëzës urinare, shterpësi, dështime, fëmijë të pazhvilluar dhe vdekshmëri, dhe kancer cervical, *Rreziqet e shëndetit dhe pasojat e trafikimit të grave dhe adoleshenteve*, fq.46.

96⁷⁹ Një vështrim i përgjithshëm i mbështetjes psikologjike dhe shërbimeve të dhëna viktimeve të trafikimit., IOM Kosovë, Shtator 2003. Shih dhe *Rreziqet e shëndetit dhe pasojat e trafikimit të grave dhe adoleshenteve*. Të dyja studimet vërejnë se nuk janë kryer kërkime të mjaftueshme për traumat psikologjike që kanë vuajtur gratë e trafikuar si pasojë e eksperiencave të tyre, *po aty*, fq. 2 dhe *po aty*, fq.13-18, respektivisht.

97⁸⁰ Vendim gjyqi, AF Nr. 80/2002.

98⁸¹ Neni 8, ICCPR: (1) “Asnjë nuk duhet të mbahet në skllavëri; skllavëria dhe tregtia e skllevërve në të gjitha format duhet të ndalohet. (2) Asnjë nuk duhet të mbahet në punë të detyruar. (3) (a) Asnjërit nuk



ILO-s (105) për Ndalimin e Punës së Detyruar dhe në Nenin 1(a) të Konventës Plotësuese për Konventën e Skllavërisë, e cila ndalon praktikën e veçanta të ngjashme me skllavërinë, duke përfshirë pengmarrjen për borxhe.⁹⁹⁸²

Gratë e trafikura në Kosovë shiten si skllave. Secila nga gratë e trafikuar të intervistuar nga Amnesty International i referohej burrit që ato i ishin shitur ndërkohë si "pronari" i tyre: NGO-të që punonin me gratë e trafikuar raportojnë të njëjtën gjë.

Ndonëse gratë mund të kene rënë dakord më parë për ta paguar, nga rrogat e tyre, personin që ka rregulluar, për shembull, kostot e udhëtimit të tyre të pritshëm në Itali, pak prej tyre e kuptonin ose e prisnin që ato të ishin blerë në fakt, dhe se ato do të duhet t'i shlyenin "pronarit" të tyre shumën që ai kishte paguar për to. As edhe nuk e prisnin të paguanin shuma shtesë, që i shtoheshin rregullisht borxhit të tyre, shpesh, gjatë, për koston e ushqimit dhe strehimit të tyre.

Një grua e re që mendonte se po shkonte të punonte në një punë të ligjshme në një bar në Kosovë, dhe e cila, përveç punës në bar, e pa veten të detyrohet për prostitucion, i tha Amnesty International:

"Unë firmosa një kontratë për një rrogë mujore 100€, për shkak të taksave që do të hiqeshin nga rroga ime. Megjithatë, unë kisha një marrëveshje me shkrim në vendin tim që të punoja për 300 € në muaj. Pronari i barit tha 'Unë të bleva për 200 €; ti duhet të m'i kthesh ato prapë', dhe më tha se unë i kisha një diferencë 4€. Pastaj një ditë ai më tha, 'Ti më detyrohesh 80€' dhe unë duhet të paguaja me kohën time. Çdo tri apo katër ditë ai do të më thoshte, 'Ti je minus 20€' apo diçka tjetër. Për tre muaj unë fitova vetëm 300-350 €, por unë duhet të kisha pasur 900€... Kur isha në vendin tim, ata më thanë se do të kisha ushqim, cigare etj. Nuk kishte asgjë nga ajo marrëveshje. Unë pagova për uniformën time, pagova për kontrollin mjekësor, pagova për kontratën time, pagova për udhëtimin tim, çdo gjë. Unë pagova 16€ për bluzën time. Ajo kishte emrin tim përpara dhe emrin e kompanisë prapa." 100⁸³

duhet t'i kërkohet të kryejë punë të detyruar ose me përdhunë." Neni 4(1) i ECHR-së përmban një dispozitë të ngjashme.

⁹⁹⁸² "Pengmarrja për borxhe, që do të thotë, statusi ose gjendja që rrjedh nga zotimi i një borxhliu për shërbimet e tij personale, ose të atyre të një personi nën kontrollin e tij, si garanci për një borxh, në qoftë se vlera e atyre shërbimeve, siç është vlerësuar në mënyrë të arsyeshme, nuk është aplikuar ndaj likuidimit të borxhit ose borxhi a zgjatja dhe natyra e këtyre shërbimeve nuk janë respektivisht kufizuar dhe përcaktuar."

¹⁰⁰⁸³ Grua bullgare e trafikuar në Kosovë; në këtë rast, gruaja mori një pagesë të vogël: IOM raporton se disa trafikantë kanë adoptuar këtë taktikë me qëllim që t'i mbajnë gratë më të nënshtuara, Intervistë e AI me IOM-in, shtator 2003.

Gratë tek klubi Miami Beach, ku sipas kontratës së tyre supozohej të merrnin një komision për pijet e shitura, dëshmuar në proceset gjyqësore në Gjykatën e Qarkut të Prishtinës se ato rrallë i merrnin këto para. Në vend të kësaj ato "gjobiteshin" rregullisht për arsye të ndryshme: përfshirë bërjen e seksit jashtë hotelit me klientë që nuk kishin paguar shumën e nevojshme; refuzimin për të bërë seks me një klient që kishte marrë drogë; për dehje-edhe pse pirja e sasive të mëdha të alkoolit ishte pjesë e punës së tyre; ose për ardhjen vonë në punë.¹⁰¹⁸⁴

Gra të tjera raportojnë se shlyenin një borxh, vetëm për t'u ndeshur me një tjetër, në një rreth pengmarrjeje prej borxhit nga i cili është pothuajse e pamundur të shpëtosh. "Unë mësova se i isha shitur një tutori për 2200 DM (955 €). Paratë që ai kishte shpenzuar për mua unë duhet t'i paguaja me punë. Kur unë e bëra shumën, tutori më shiti në Kosovë për 1750 DM. Unë nuk shkova kurrë për ndihmë tek njeri, sepse nuk pata mundësi për të lëvizur. Punoja natën me [rojë] vetëm 15 hapa larg gjithë kohën. Unë isha e kyçur në dhomë gjatë ditës. Po të kisha pasur mundësi, unë do të isha përpjekur të gjeja Kryqin e Kuq për ndihmë.¹⁰²"⁸⁵

Gratë dhe vajzat e trafikuar nga brenda

"Para se të ishin viktimë të trafikimit, ato ishin viktimë të dhunës në familje ose të përdhunimit [në] luftë, ose të shkollimit të pakët – ato të gjitha kishin disa arsye për të qenë viktimë të trafikimit." 103⁸⁶

Ashtu si edhe ato që janë trafikuar në Kosovë nga jashtë, një numer gjithnjë në rritje grash dhe vajzash vendase janë duke u trafikuar gjithashtu për në industrinë vendase të seksit. Sipas CPWC-së, numri i grave të trafikuar brenda është rritur në mënyrë dramatike së fundi, me mbi dyfishin e numrit të vajzave dhe grave të ndihmuara më 2002 ndaj 2000. Nga 253 gra dhe vajza të trafikuar brenda të mbështetura nga CPWC-ja gjatë kësaj periudhe, shumica – rreth 81 për qind – ishin nën moshën 18 vjeç. Pothuajse një e treta, 32 për qind, ishin midis 11 dhe 14 vjeç.¹⁰⁴⁸⁷ Më 2003 CPWC-ja asistoi 92 raste të tjera, 79 për qind e të cilave ishin nën moshën 18 vjeç.¹⁰⁵

¹⁰¹⁸⁴ P. No. 137/2001.

¹⁰²⁸⁵ Grua ukrainase e trafikuar më parë në Serbidhe pastaj në Kosovë.

¹⁰³⁸⁶ Intervistë me Naime Sherife, CPWC, shtator 2003.

¹⁰⁴⁸⁷ CPWC, *Raporti Vjetor 2002*, 25 prill 2003. TPIU-ja i ka vënë në dyshim publikisht këto shifra, duke argumentuar se CPWC-ja nuk bën dallim mes viktimës së trafikimit, abuzimit seksual dhe dhunës në familje; shih po ashtu UNICEF/UNHCHR, OSCE/ODIHR, *Trafikimi i Qenieve Njerëzore në Evropën Juglindore, Azhornim i Situatës 2003*, fq 174. Në Raportin e saj Vjetor, për 2002, CPWC-ja raporton se në 10 qendra nëpër Kosovë, NGO-ja asistoi afro 5361 viktimë, nga të cilat 165 u identifikuan si viktimë të trafikimit, (duke përdorur përkufizimin e Protokollit të Trafikimit), pjesa tjetër si viktimë të përdhunimit ose dhunës në familje.



Kushtet ekonomike në Kosovë, veçanërisht në zonat rurale nga ku vijnë shumica e këtyre grave të reja, nuk kanë mundur ta marrin veten pas luftës, dhe papunësia, ndonëse më pak më 2000, është ende duke u luhatur tek afro 60 për qind.

Sipas CPWC-së, 84 për qind e grave të trafikuar brenda vendit me të cilat ata punuan, kishin marrë vetëm një nivel bazë arsimimi. Disa nuk e kishin mbaruar arsimin fillor dhe pesë për qind ishin analfabete. Vetëm 10 për qind kishin ndjekur arsimin 7/8-vjeçar dhe vetëm një për qind kishte marrë ndonjë formë të arsimit të mesmë. Më 2002, Banka Botërore raportoi se vetëm 56 për qind e vajzave 15 deri 18 vjeçe, grupi më i pambrojtur nga trafikimi, ishte regjistruar në arsim me kohë të plotë. Por edhe vajzat me njëfarë arsimit nuk janë të imunizuara.

“Unë isha një nxënëse e shkëlqyer në shkollën fillore. Një ditë takova një mikeshë të një klase tjetër në të njëjtën shkollë. Ajo më ftoi të dilnin shëtitje së bashku. Ajo më njohu me disa njerëz që më pëlqyen dhe duket se ishin shumë të këndshëm.... Mua më çuan në një dhomë dhe më përdhunuan. ... qysh atëherë unë nuk jam më e lirë ...” 106⁸⁸

Personel i CPWC-së i tha Amnesty International se shumica e grave të reja janë me prejardhje të varfër, shpesh nga familje që nuk shkojnë, me nivel të lartë të dhunës familjare dhe alkoolizmit. Mjaft familje kanë kaluar gjithashtu përmes shumë vitesh shpërnguljeje, lufte dhe traume:

“Ne vuajtëm shumë gjatë luftës. Shtëpia jonë u dogj. Ne kemi kalua shumë terror në [R.] edhe gjatë dëbimit. Menjëherë sapo mbaroi lufta, im at më martoi me kunatin e motrës sime. Unë nuk e doja atë. Pas ca kohe atje, unë ika nga shtëpia e tij e rrahur dhe e gjymtuar. Ishte errësirë. Unë kërkova ndihmë në rrugën e asfaltuar të fshatit. Një shofer ndaloi pranë, ai më mori në makinë dhe më premtoi të më ndihmonte, dhe pastaj më çoi në qytet... Mua më çuan në një kafe-bar dhe më dorëzuan tek pronari i atij vendi. Tërë kohën që isha aty, unë u shfrytëzova dhe u përdhunova në mënyrë të përsëritur. Më vonë, pronari më shiti në një vend ku më vonë u shpëtova nga policia, shtatë muaj më pas. Sa herë që kërkoja të më lironin, pronari më thoshte se nuk kisha punuar mjaft, duke pretenduar se unë kisha mundur të fitoja vetëm 300 DM nga shërbimet e mia, kurse ai më bleu mua me një çmim 1500 DM..” 107⁸⁹

Megjithëse një shumicë e vajzave dhe grave të trafikuar brenda rekrutohen në rrugë të ngjashme me gratë nga jashtë, duke përfshirë edhe ofrimin e punës në Evropën

105⁵⁹ CPWC-ja gjithashtu vazhdoi të mbështetë 59 gra dhe vajza nga numri i çështjeve të tyre 2002, CPWC Projekt Raport i papublikuar për 2003.

106⁸⁸ Grua e trafikuar nga brenda..

107⁸⁹ Grua e trafikuar nga brenda, vjeç 19.

Perëndimore, një përqindje e lartë raportohet se janë rrembyer me forcë. Gjendja e varfër ekonomike i bën gjithashtu gratë e reja më të ndjeshme ndaj “djalit të dashur” trafikant: “.. ai i ofron ta largojë atë prej aty, ai i premtun ta dojë atë, ai i premtun asaj martesë, ai i premtun asaj punë; ai i premtun asaj ta largojë nga Kosova”. 108⁹⁰

Gratë e trafikuar brenda vendit përgjithësisht ndeshin të njëjtat kushte si ato nga jashtë Kosovës, ndonëse shifrat që raportojnë se ato marrin ndonjë formë pagesë janë jashtëzakonisht pak. Si gratë dhe vajzat e huaja, dhe ato vendase janë gjendur në të njëjtat bare dhe gjatë gjithë raportit janë trajtuar në të njëjtën mënyrë nga pronarët e bareve dhe punëtorët e tjerë, ndonëse disa janë mbajtur në kushte shumë më të këqija. Raportohet se shumë nga ato flenë tri ose katër orë në natë, duke u shërbyer midis 10 dhe 15 klientëve çdo ditë, dhe u jepen pije” me energji të lartë” për t’i mbajtur zgjuar.

Shumica e grave të reja të këshilluara nga CPWC-ja thonë se kanë punuar midis tetë muaj dhe dy vjet para se të arratiseshin ose të “shpëtoheshin” nga policia. Në kundërshtim me gratë e trafikuar nga jashtë, 109⁹¹ vetëm 24 për qind janë referuar drejtpërdrejt nga TPIU-ja ose nga oficerët e tjerë të zbatimit të ligjit, me shumicën e grave të referuara nga agjenci të tjera ose që kanë kërkuar ndihmë vetë, pasi ai dolën të arratiseshin.

Disa gra të reja janë shitur nga vetë pjesëtarët e familjeve të tyre. Një 14-vjeçare ishte martuar me një pronar bar-bufetje vendas, që e dhunonte fizikisht atë dhe e detyroi për prostitucion, duke e shitur më në fund tek tre vëllëzër, të cilët e morën atë në Prishtinë ku e detyruan të bënte seks me ta dhe burra të tjerë. 110⁹² Në një rast tjetër, raportuar tek Amnesty International, një vajzë 13-vjeçare rome u shit fillimisht 500 € për martesë me një burrë 40-vjeçar, i cili e rrahu dhe e përdhunoi. Kur ajo u arratis prej atij, u kthye përsëri në shtëpi: në mënyrë që të shlyente pagesën e martesës, e ëma e prostituoi atë në dyqanet vendase. Fëmija tani duhet të mbrohet nga vetë familja e saj. Në shkurt policia e UNMIK-ut njoftoi arrestimin e një burri që përdhunoi një pjesëtar të vogël të vetë familjes së tij dhe pastaj ai shiti atë një burri tjetër për 100 € ai u akuzua për përdhunim të mituri dhe trafikim. 111⁹³

Por pa mbështetjen e familjes, gratë e reja janë edhe më të pambrojtura:

108⁹⁰ Intervistë e Amnesty International me Naime Sherifi, CPWC, shtator 2003.

109⁹¹ Shih footnote x, fq. 14 më sipër. ????

110⁹² Pa ndonjë mbështetje dhe mundësi për t’u kthyer në shtëpinë e saj, ajo u kthye të punojë si prostitutë nëpër bare. OSCE, *Raport për Qendrat e Punës Sociale*, fq. 25.

111¹ Shënime Përmbledhëse të UNMIK-ut, 26 shkurt 2004.



“Prindërit e mi janë të divorcuar. Unë jetoj ku të mund, me familjen e xhaxhait tim, gjitonët dhe kushërinjtë. Një burrë plak e vuri re se unë jam vetëm dhe zuri të më përkëdhelte. Ai më ftoi të shkoja në shtëpinë e tij. Ai zuri të thotë se më donte shumë. Ai prekte trupin tim dhe madje më dha para për rroba dhe gjëra të tjera. Por atje kishte burra të tjerë që gjithashtu më morën mua ... ai i njihnte ata, por asnjehërë nuk i ndaloi ata ... ndërmjet shërbimeve të tjera, unë duhet të zhvishesha në tavolinë në një apartament, një dhomë e madhe dhe plot me njerëz perreth, që më shihnin mua të vallëzoja; kishte edhe vizitorë ndërkombëtarë, një herë, unë kam parë ushtarë ndërkombëtarë” 112⁹⁴

Procese janë duke u zhvilluar aktualisht për rastin e pesë fëmijëve, që u gjetën të kyçur në një dhomë ku u dyshua se ata ishin dhunuar si nga burra homoseksualë, dhe heteroseksualë. Nuk dihet nëse ata ishin jetimë apo të braktisur. Kur fëmijët u gjetën, ata ishin të kequshqyer, kishin kokën me morra dhe ishin jashtëzakonisht të traumatizuar. 113⁹⁵ Fëmijë të tjerë të pambrojtur, nga sa raportohet janë rekrutuar fillimisht për të shitur çimçakizë ose për të lypur nëpër rrugë; ndërsa djemtë lëvizin për të shitur cigare dhe karta telefonike, vajzat detyrohen për prostitucion.

Amnesty International ka marrë gjithashtu raporte se vajzat e reja në Kosovë janë të pambrojtura nga një formë tjetër e shfrytëzimit seksual, që Amnesty International mendon se pajtohet me përkufizimin e trafikimit, siç citohet në Protokollin e Trafikimit. Këto janë raste ku ka ndodhur shfrytëzim seksual abuziv, nuk është plotësisht e qartë se ka një motiv ekonomik. Në këtë formë trafikimi, vajzat e reja janë rrëmbyer dhe më pas i janë nënshtruar përdhunimit të përsëritur, ndonjëherë nga i njëjti grup burrash, ose në mënyrë të përsëritur janë rrëmbyer dhe detyruar të bëjnë seks me burra të ndryshëm për një periudhë mbi disa muaj. Pas provës së tyre fillestare, që zgjat ndonjëherë deri më një muaj, gratë e reja lëshohen, shpesh flaken jashtë shtëpise ose shkollës së tyre; pak javë ose muaj më vonë ato do të rrëmbehen përsëri. Më 14 shkurt 2004 policia e UNMIK-ut mori një njoftim se një vajzë 14 vjeçe kishte humbur; pas një hetimi, ajo u shpëtua nga policia më 1 mars: për një periudhë prej 20 ditësh ajo ishte përdhunuar në mënyrë të përsëritur nga tetë burra të rritur. 114⁹⁶ Në një rast të ngjashëm:

“Unë po shkoja në shkollë. Vura re se një grua e re pranë oborrin të shkollës po më shikonte. Unë ndalova pranë një

byrektoreje 115⁹⁷ dhe hodha sytë brenda. Gruaja e çuditshme m'u afrua dhe më ofroi një byrek. Ajo e pagoi atë. Kjo zgjati për shumë ditë, deri sa ne u bëmë mikështa. Një ditë ajo më sugjeroi të bënim një xhiro me të në makinën e saj. Unë shkova me të. Makina nuk ndaloi në lagjen ku banoj unë, por ata vazhduan ta ngitnin makinën në një rrugë të panjohur për mua. Shofer ishte një burrë. Kur unë pyeta për vendin ku po shkonim, ata me thanë se ne po vizitojmë një qytet të vjetër, ku unë nuk kam qenë ndonjëherë më parë. Në të vërtetë mua më çuan atje dhe më mbajtën në një motel për tri javë rresht. Katër burra më përdhunuan. Unë bërtisja, por asnjëri nuk mund të më dëgjonte, pasi më kishin mbyllur gojën. Erdhën dhe burra të tjerë. Pas tri javësh ata më çuan në një qytet tjetër. Atje, gjithashtu, unë u detyrova të bëja seks me cilindo që vizitonte atë shtëpi private. Pas ca kohësh ata më lanë të lirë dhe unë u ktheva prapë në shtëpi. Ata nuk donin të më linin rehat. Erdhën tek dera, duke më kërcënuar se do të shkojnë në shkollën time dhe do t'i tregojnë çdo njeriu se çfarë kishte ndodhur. Ata madje më kërcënuan që do t'u thoshin prindërve të mi se isha unë që vendosa me dëshirë të shkoja me ta. Unë u detyrova të shkoja me ta kohë pas kohe, javë pas jave dhe ndonjëherë edhe për tri muaj. Unë nuk mund ta vazhdoja shkollën, meqenëse disa muaj kishin kaluar tashmë dhe unë kisha munguar qysh nga fillimi i tetorit ... Unë kam turp dhe më duket sikur çdo njeri po më shikon sikur jam kriminel, dhe kam shumë frika nga ... Unë nuk jam paguar kurrë. Ata më dhanë ushqim dhe më veshën me rroba nusërie. Unë mbërdhija nga të ftohtët kur ishte dimër. Unë duhej të vishja minifunde dhe të rrija pothuajse lakuriq. Kur ftohesha, nuk mund të shkoja tek doktori. Më jepnin ca hapje dhe një lëng të përgatitur vetëm për mua. Edhe kur u ktheva prapë në shtëpinë time, unë nuk mund të dilja jashtë, dhe nuk u thashë kurrë prindërve të mi se çfarë më kishte ndodhur, sepse kisha frikë dhe turp, deri sa u bë shumë e rëndë për mua, dhe shumë vonë.” 116⁹⁸

Trafikimi jashtë Kosovës

Gratë dhe vajzat shqiptare, serbe dhe rome nga Kosova ndeshin gjithashtu edhe një rrezik gjithnjë në rritje të trafikimit jashtë. Në kohën e këtij shkrimi, destinacioni i tyre kryesor janë zonat me shumice etnike shqiptare të Maqedonisë, ku TPIU-ja, IOM-i dhe CPWC-ja raportojnë për gra të reja që transferohen ose ritrafikohen prej Kosovës. 117^{99,100} Megjithatë, grave të reja të trafikuar

115⁹⁷ Byrek me petë të holla i mbushur me mish, djathë ose spinaq.

116⁹⁸ Vajzë shqiptare kosovare, vjeç 13.

117⁹⁹ Intervistë e Amnesty International me Pasquale Lupolli, IOM; Irina Cocos, TPIU dhe Naime Sherife, shtator 2003.

118¹⁰⁰ 16-vjeçare nga Peja/Pec, Kosovë.

112⁹⁴ Vajzë shqiptare e trafikuar nga brenda, besohet të jetë nën moshën 12 vjeç.

113⁹⁵ Intervistë e AI me manaxherin e strehëzës së fëmijëve.

114⁹⁶ Shënime Përmbledhëse të UNMIK-ut, 3 mars 2004.



brenda gjithashtu njoftohet se u ofrohet punë në Itali dhe duket se ato janë duke u trafikuar gjithnjë e më shumë, nëpërmjet Shqipërisë, për në Itali dhe pjesë të tjera të Evropës Perëndimore.

“Një miku im, ai është më i madh se unë, më tha se mund të më ndihmojë të gjej një punë në Maqedoni; Unë kisha mundësinë të lija të gjitha gjërat e këqija pas [ajo ishte përdhunuar dhe e kishte raportuar përdhunimin në polici, duke pasur probleme me familjen e saj dhe miqtë] Burri më çoi në një fshat pranë Gostivarit. Mua më kujtohet që ai i pagoi 200 DM (100 €) një shoferi taksie, që të më kalonte mua përmes kufirit. Pasi mbërritëm në Maqedoni, mua më çuan në një bar dhe më thanë se duhet të punoja atje si kamariere për 10 DM (5 €) në ditë. Unë u strehova në një shtëpi së bashku me vajza të tjera nga Moldavia dhe Rusia, mendoj se ato ishin ruse. Asnjëra nga ne nuk ishte e lirë të dilte nga shtëpia gjatë ditës, në ishim të detyruara të qëndronim brenda deri sa na duhet të shkonim në bar. Pas ca javësh gjërat ndryshuan, pronari më kërkoi të ulesha më klientët e barit dhe, në qoftë se ata do të dëshironin, t'i shoqëroja lart për në dhomat e gjumit.” 118⁰¹

Deri më maj 2003, afro 17 gra kosovare njoftohet se janë riatdhesuar në Kosovë. Nga nëntë që ishin ndihmuar nga IOM-i, tre kishin qenë të trafikuar në Maqedoni, dy në Itali, një në Belgjikë dhe një në Mbretërinë e Bashkuar.

“Pas ca kohe njëri nga djemtë [që e kishte marrë peng dhe e kishte përdhunuar] më çoi me makinë në Shqipëri. Ata më çuan në një motel tjetër dhe më lanë atje... për një muaj tjetër. Ata ... më përdhunuan mjaft herë... Një natë mua më çuan në një qytet tjetër. Ata më hipën në një skaf të njerëzve të dëshpëruar dhe më dërguan në Itali. ... Ata më kyçën në një apartament. Të nesërmen më thanë se duhet të punoja për ata – në rrugë. Unë refuzova, fillova të bërtas... Ata më rrahën shumë; ata më thanë se, po të refuzoja, ata do të më vrisnin mua dhe familjen time në Kosovë.... Unë isha shumë e frikësuar. Unë isha në Itali ilegalisht. Nuk mund të kërkoja ndihmë.” 119⁰²

Një veprim i shpejtë dhe efektiv nevojitet për të zvogëluar rrezikun që gra të reja nga Kosova të dërgohen në emigracion ilegal, i cili do t'i ekspozojë ato nga ana tjetër ndaj rrezikut të abuzimit dhe shfrytëzimit, duke përfshirë, në veçanti, mosmbrojtjen nga trafikimi dhe abuzime të tjera të drejtave të njeriut.

Një veprim i tillë duhet të përballojë dimensionet gjinore të varfërisë në rritje në Kosovë, dobësinë e sistemit arsimor dhe nivelet e larta të dhunës në familje dhe dhunën e përhapur kundër grave.

101

119⁰² 16-vjeçare shqiptare nga Kosova, e trafikuar në moshën 14 vjeçare në Itali.

Kapitulli 3: Përgjigjet ndaj trafikimit – zbatimi i ligjit dhe gjykata penale

Në mungesë të rendit kur UNMIK-u erdhi në Kosovë, mandati i UNMIK-ut përfshinte vendosjen e një force policore dhe funksionimin e sistemit të gjykatës penale. Ai u ndesh me shkelje të vazhdueshme të drejtave të njeriut, përfshirë edhe vrasjen e rrëmbimin e pjesëtarëve të komuniteteve të minoritetit, vrasje politike mes komunitetit të etnisë shqiptare dhe krime të tjera të rënda, dhe dështimin e shteteve pjesëtare të UN-it për të përballuar sistematikisht trafikimin deri më nëntor 2000, kur u themelua Njësia Hetimore e Trafikimit dhe Prostitucionit (TPIU) brenda policisë së UNMIK-ut.

Bastisje, arrestime dhe dëbime

Përgjigjja fillestare e UNMIK-ut në periudhën nga 1999 deri më 2000 duket se ka qenë të përpiket ta kontrollojë prostitucionin-i cili është i paligjshëm në Kosovë-sesa të zgjidhë çështjen e trafikimit. Kjo u bë kryesisht nëpërmjet bastisjeve nga Policia e UNMIK-ut dhe KFOR-it në ndërtesat ku besohej se punonin gratë e trafikuar. Policia e UNMIK-ut arrestoi gjithashtu gra për emigracion [të paligjshëm] ose dokumentacion të parregullt në kufij dhe brenda Kosovës. Megjithatë, vetë trafikantët rrallë ishin në shënjestër.

Bastisjet u kryen nga policia e UNMIK-ut në bashkëpunim me KFOR-in, 120⁰³ shpesh me ndihmën e forcave të policisë ushtarake, përgjegjëse për kontigjentet e tyre përkatëse të KFOR-it, duke përfshirë karabinierët italianë, xhandarmërinë franceze ose të tjera forca speciale të armatosura.

Më 1999, në mungesë të procedurave për të identifikuar dhe mbrojtur viktimat e trafikimit, gratë duket se zakonisht janë paraburgosur dhe më pas janë akuzuar për prostitucion, ose shkelje të tjera. UNIFEM-i njoftoi për tri bastisje të policisë ushtarake ose KFOR-it në mungesë të policisë së UNMIK-ut, ku me sa duket, nuk u bë asnjë përpjekje për të vendosur nëse gratë ishin viktimat e trafikimit ose për të përcaktuar nevojat e tyre për asistencë. Pas një bastisjeje në Mitrovicë, për shembull, dy gra serbe dhe dy gra ukrainase, të gjitha të besuara se ishin trafikuar, u paraburgosën dhe pastaj u liruan pas tre javësh” sepse askush nuk donte të mbante përgjegjësi për to”. Njëra ishte vajzë 16-vjeçare. Në Prishtinë karabinierët goditën një bordello pranë aeroportit, i larguan gratë e reja të pranishme, por s’ mundën të ndërmerrnin veprime për të

120⁰³ KFOR-i mori rolin e policimit prej korrikut 1999 në bazë të paragrafit 9 (d) UNSCR-së 1244/99, i cili e ngarkoi KFOR-in me “sigurimin e sigurisë publike dhe rendit deri sa prania ndërkombëtare civile të mund të marrë përgjegjësinë për këtë detyrë”.

arrestuar pronarët. Në rastin e tretë, Xhaketat e Blerta Mbretërore të UK (pjesë e KFOR-it) goditën një bar në Prishtinë, por me sa duket, nuk bënë përpjekje për të zbuluar nëse gratë ishin trafikuar, deri sa një civil i huaj i pranishëm tha se ata duhet të kontrollonin nëse ato i kanë pasaportat e tyre".¹²¹

Në fillim të 2000, pas vendosjes në Kosovë të Programit Kundër Trafikimit të IOM-it, IOM-i futi procedura për identifikimin dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit të arrestuara në bastisje të tilla. Deri në fund të prillit 2000, afro 50 gra raportohet se kanë qenë riatdhesuar nga IOM-i. Megjithatë, procedurat për të identifikuar gratë e trafikuar nuk ishin zbatuar gjithmonë rregullisht nga policia e UNMIK-ut dhe gratë, që me të drejtë besoj se ishin trafikuar, vazhdonin të akuzoheshin për prostitucion.

Deri më shkurt 2001, vetëm pesë persona ishin dënuar sipas Nenit 251 për "ndërmjetësim në prostitucion".¹²²

Njësia e Hetimit të Trafikimit dhe Prostitucionit

Më nëntor 2000 u themelua brenda policisë së UNMIK-ut Njësia e Hetimit të Trafikimit dhe Prostitucionit (TPIU), e koordinuar nga Prishtina dhe që përfshinte pesë njësi rajonale. Qëllimi i saj ishte të mblidhte informacion dhe të ndërtonte një bazë të dhënash për lokalet dhe për të dyshuarit, që mendohet se ishin përfshirë në trafikim, dhe për të identifikuar "gra që punojnë në këto rrethana", me qëllim që të ndihmonin në procedimin e atyre që besoj se ishin përgjegjës për trafikim. TPIU-ja u pajis me personel, qysh në fillim të saj, si me punonjës policie ndërkombëtarë, edhe me pjesëtarë të Shërbimit Policor të Kosovës (KPS).

Njësia e formuar rishtazi ndërmori një sërë bastisjesh tejmbanë Kosovës, në bashkëpunim me KFOR-in.

Rregullorja e Trafikimit

Më 12 janar 2001 SRSG-ja shpalli Rregulloren e UNMIK-U 2001/4, *Për ndalimin e trafikimit të personave në Kosovë*. Rregullorja e Trafikimit e bazon përkufizimin e saj të trafikimit mbi Protokollin e Trafikimit.¹²³

Seksioni 2 i Rregullores së Trafikimit penalizon ata që merren me trafikim dhe jep dënime nga dy deri më 12 vjet burg; kur është trafikuar një i mitur, dënimi maksimal është vendosur 15 vjet burg. Sipas Rregullores, ata që shpallen fajtorë për organizimin e trafikimit u nënshtrohen dënimeve nga pesë deri më 20 vjet, dhe përfshihen

¹²¹ UNIFEM, *Nuk ka vend të sigurt*, fq. 77-8.

¹²² OSCE, *Kosovë: Një vështrim i Sistemit të Gjykatës Penale, I shtator 2000 – 28 shkurt 2001*, fq. 8.

¹²³ UNIS/CP/439, 7 korrik 2003.

gjithashtu edhe ata që lehtësojnë trafikimin. Seksioni 3 jep dispozita për dënimin e atyre që mbajnë dokumentet e identifikimit të grave të trafikuar.

Në mënyrë domethënëse, Rregullorja zgjidh edhe çështjen e kërkesës, duke i penalizuar ata që, me dijeni, i përdorin ose përfitojnë nga shërbimet e personit të trafikuar; të pandehurit që janë shpallur fajtorë mund të dënohen nga gjashtë muaj deri më 5 pesë vjet burgim; ku personi është një i mitur, dënimi maksimal shkon deri më 10 vjet burgim.

Rregullorja përfshin gjithashtu një numër masash që kanë si qëllim të mbrojnë të drejtat e grave të trafikuar. Këto përfshijnë: dispozita që sigurojnë se e drejta e tyre për riatdhesim vullnetar nuk duhet të zvarritet nga procesi hetimor; dispozita për mbrojtjen e dëshmitarit; dhe ndalimi i përdorimit të historisë së kaluar të viktimës kundër saj, si një dëshmi në gjyq, përveçse *in camera*, pas një kërkesë të mbrojtjes; dhe dispozita për gratë e trafikuar që t'u garantohet rezidencë në Kosovë. Këto dispozita janë diskutuar më me hollësi më poshtë.

Seksioni 11 parashikon që personat e trafikuar nuk janë përgjegjës penalisht për akuzat e prostitucionit ose hyrjes ilegale në Kosovë. Megjithatë, kjo dispozitë e vë barrën mbi gruan për të siguruar dëshmi që të mbështetin një besim të arsyeshëm se ajo është një viktimë e trafikimit. Masa të mëtejshme të parashtruara në Seksionin 10 synojnë të sigurojnë një program të koordinuar ndihme, por vetëm në qoftë se gruaja siguron dëshmi të mjaftueshme që ajo është trafikuar. Seksioni 10 mbetet që të zbatohet.

Mungesa e këshillimit me prokurorët vendas dhe gjyqësorin gjatë hartimit të Rregullores së Trafikimit dhe paaftësia për të siguruar trajnim për gjithë pjesëtarët e gjyqësorit, ka çuar në probleme si në interpretimin, ashtu edhe në zbatimin e këtij ligji, i cili pavarësisht nga mangësitë e tij, është përshkruar nga Pakti i Stabilitetit si një nga legjislacionet më të mira në rajon.¹²⁴

Pas Rregullores së Trafikimit

"*Gratë trajtohen si kriminele dhe si prostituta, burrat nuk i shohin ato si viktime.*" Intervistë e Amnesty International me një oficer të KPS.

¹²⁴ Sipas UNSCR 1244/999 Kosova mbetet pjesë e Serbisë dhe Malit të Zi, duke mbajtur kufijtë e jashtëm me Shqipërinë, Maqedoninë, të cilët, si Vija Kufitare Administrative (ABL) me Serbinë, mbulohen nga Policia Kufitare e UNMIK-ut; ABL patrullohet gjithashtu nga KFOR-i. Pavarësisht nga pezullimi, e ndaloi efektivisht policinë nga refuzimi i hyrjes, përveç Rregullores 200/10 të UNMIK-ut ose mbi bazën e dokumenteve të parregullta. Në Kosovë nuk përfitohet regjim vizash, dhe me përjashtim të grave të dyshuara se janë trafikuar, vizitorët ose punëtorët e huaj, duke përfshirë pjesëtarët e komunitetit ndërkombëtar, nuk kërkohet të regjistrojnë prezencën e tyre në Kosovë.



Pavarësisht nga shpallja e Rregullores së Trafikimit, Amnesty International është e preokupuar se as Policia e UNMIK-ut, as KPS-ja, as gjyqësori nuk ishin informuar plotësisht për dispozitat e saj dhe, për pasojë, nuk arritën të zbatonin dispozitat e saj, duke përfshirë edhe masat për mbrojtjen e grave të trafikuar. Si rrjedhim, si oficerët e zbatimit të ligjit, ashtu edhe gjyqësori dështuan në identifikimin e grave që besohet të jenë trafikuar. Seksioni 8 i Rregullores parashikon që një person të japë provë për të mbështetur një besim të arsyeshëm se ai është viktimë e trafikimit, në mbrojtje nga procedimi për prostitucion ose hyrje ilegale në Kosovë. Pavarësisht nga kjo dispozitë, gratë e trafikuar kanë vazhduar të arrestohen dhe të ndiqen për shkelje të statusit ose kufirit, ose akuzohen për kundërvajtjen e prostitucionit pas bastisjeve të policisë së UNMIK-ut, pa atë çfarë duket të ketë qenë një hetim i mjaftueshëm në rrethanat apo statusin e tyre. Në disa raste ato janë dënuar pastaj deri më 10-30 ditë burgim dhe urdhra dëbimi. Gratë e arrestuara në inspektimet e rregullta të bareve ishin dënuar dhe dëbuar gjithashtu.

Në 20 raste të monitoruara nga Shërbimet e Monitorimit të Sistemeve Ligjore të OSCE-së (LSMS) më 2001, LSMS-ja vëzhgoi se gjykatësit nuk arritën të respektojnë këtë mbrojtje kundër ndjekjes për prostitucion ose shkelje të statusit, të parashikuara për viktimat e dyshuara të trafikimit. Gjyqësori argumentoi se atje nuk kishte pasur procese, për shembull, në Gjykatën përkatëse të Qarkut, për të vendosur nëse gratë ishin viktimat të trafikimit. Në raste të tjera ata pretenduan se Rregullorja e Trafikimit nuk arriti të vendoste një standard dëshmie, me anë të së cilës gratë do të mund të provojnë statusin e tyre si viktimat. Diku gjetkë, gjykatësit që dënuan katër gra të huaja me 15-20 ditë burgim me akuzat e kalimit të paligjshëm të kufirit nga Maqedonia dhe një urdhër dëbimi dyvjeçar, informuan LSMS-në se ata nuk e kishin parë kurrë Rregulloren e Trafikimit.¹²⁵¹⁰⁷

Më 2002, thuhet se 100 gra të huaja u arrestuan nga personeli i TPIU-së, 20 për prostitucion, 25 për zotërim të dokumenteve të rreme, 22 për kalim të paligjshëm kufiri dhe 10 për joshje ose prokurim; Amnesty International nuk ka mundur të gjejë shifra për numrin e grave të shpallura fajtoresh, të dënuara me një periudhë burgimi ose të dëbuara.¹²⁶¹⁰⁸

¹²⁵¹⁰⁷ LSMS-ja ia ngarkoi këto arrestime, dënime dhe dëbime pazotësisht për të qarkulluar mjaftueshëm Rregulloren e Trafikimit, dhe për ta informuar plotësisht gjyqësorin mbi dispozitat e saj; OSCE, *Kosovë: Vështrim i Sistemit të Gjykatës Penale, mars 2001 – gusht 2001*, nëntor 2001, fq. 55-61.

¹²⁶¹⁰⁸ Në një rast, më 22 prill 2002, një grua bullgare dhe një burrë shqiptar u ndaluan në një makinë nga policia e UNMIK-ut. Asaj nuk iu gjetën dokumente të rregullta dhe u arrestua me dyshimin për prostitucion. Shqiptari nuk u arrestua për dyshimin e përfshirjes në trafikim, por për shkelje të qarkullimit. Azhurnime të shtypit të policisë

Si doqoftë, numri i grave të arrestuara dhe dëbuara ra që nga 2002, 127¹⁰⁹ nga një ndërrim politike, jo i udhëhequr nga nevoja e mbrojtjes së të drejtave të grave të trafikuar, por sipas TPIU-së, nga mungesa e fuqive ekzekutuese për urdhrat e dëbimit të dhëna nga gjykatat.¹²⁸¹¹⁰

Deri më dhjetor 2003, afro 33 gra ishin arrestuar për prostitucion dhe gjashtë për zotërim të dokumenteve falso, duke përfshirë një grua të trafikuar në Kosovë, e cila i tha Amnesty International se, kishte braktisur "mi kun" e saj:

*"Unë shkova në rajonin e policisë, sepse kisha pasaportë falso, dhe ata më thanë, 'Përse nuk na e the këtë më parë?' Unë thashë, 'Është puna juaj, jo imja'. Unë kalova 14 ditë në burg në Prizren dhe gjashtë ditë në Lipjan. Pas gjashtë muajsh unë duhet të shkoja në gjyq për të dëshmuar si e gjeta pasaportën falso."*¹²⁹¹¹¹

Amnesty International është e preokupuar se në këto dhe në raste të tjera, duket se nuk ka pasur hetim të mjaftueshëm për statusin e këtyre grave, pavarësisht nga motivet e duhura për të dyshuar se, në mjaft raste, ato kanë qenë të trafikuar. Ashtu siç ka njoftuar Zyra për Insituacione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut e OSCE-së (ODIHR), gratë e trafikuar nga jashtë nëpër rajon ka prirje të njihen si viktimat vetëm në rast se pranojnë të marrin pjesë në programin e riatdhesimit të IOM-it; ato që – për arsye të ndryshme – nuk dëshirojnë të identifikohen kështu ose që autoritetet nuk mund t'i identifikojnë, më pas ose penalizohen, ose lihen të kthehen në prostitucion.

Policia ose TPIU-së rralë u siguron këtyre grave mundësinë e një avokati ose shërbimet e duhura të përkthimit. Gjyqësori, duke i shpallur fajtoresh e duke i dënuar këto gra, s'ka mundur të zbatojë dispozitat e Rregullores dhe i ka shërbyer penalizimit të grave të trafikuar në Kosovë. Në të gjitha këto raste – duke përfshirë ato të prostitucionit të mundshëm ose shkeljes së statusit – grave duhet t'u garantohen të gjitha të drejtat që i gëzojnë të paraburgosurit kur arrestohen, duke përfshirë të drejtën për ndihmë ligjore.

së UNMIK-ut, datat si më sipër. Më se 50 incidente të tjera janë njoftuar në mënyrë të ngjashme.

¹²⁷¹⁰⁹ Kjo u vëzhgua duke ndjekur raportet e shtypit ditor të Policisë së UNMIK-ut dhe u konfirmua nga TPIU-ja.

¹²⁸¹¹⁰ Intervistë e AI me Irina Cocos, Nënkrjetare, TPIU, shtator 2003.

¹²⁹¹¹¹ Grua moldave, e trafikuar qysh e mitur; ajo më vonë mori ndihmë nga OSCE-ja dhe IOM-i. Asnjë ndihmë ligjore nuk duket t'i jetë dhënë.



Strategji të ndryshme

Qysh nga miratimi i Rregullores së Trafikimit, TPIU-ja ka zbatuar një numër strategjish të ndryshme për të zgjidhur problemin e trafikimit.

Në fillim të 2001, një sistem i regjistrimit të grave të huaja që punonin në bare dhe që dyshoheshin për prostitucion u zbatua tejetbanë Kosovës nga TPIU-ja. Kjo strategji ishte përdorur nga policia e UNMIK-ut në rajonin Gnjilane/Gjilan nga marsi 2000 dhe e cila përfundoi me dëbimin e tyre.¹³⁰¹¹² Regjistrimi u drejtua nga oficerët e TPIU-së, që u kërkuan grave të plotësonin –në gjuhën e tyre amtare-hollësitë personale, duke përfshirë emrin e tyre, vendin dhe datën e lindjes, vendin e punës, punën dhe adresën në Kosovë. Lidhja me dëbimin u braktis.

Regjistrimi u hartua si një mjet hetimor, që identifikonte baret dhe lokalet e tjera në të cilat gratë dyshoheshin se punonin në prostitucion (të detyruar), dhe identitetin e trafikantëve, i cili duhet të vihej në lidhje me këto lokale në mënyrë që të merrej dëshmi,” kështu që rastet më të hetueshme të mund të ndiqeshin”.

Ish-kryetari i TPIU-së i tha Amnesty International se regjistrimi u dha atyre rrugën për tek “viktimat” e mundshme “të trafikimit”, duke i lejuar nëpunësit t’u shpjegonin grave të regjistruara se ato” mund të ishin në rrezik që të detyroheshin për prostitucion dhe në rrezik për të qenë të trafikuar brenda vendit”; dhe se duke u bërë vizita të rregullta këtyre lokaleve, TPIU-ja ishte e aftë t’u jepte grave mundësinë për të raportuar sjelljen kriminale kundër tyre. ¹³¹¹¹³

TPIU-ja e përdori regjistrimin gjithashtu për të vëzhguar ritrafikimin e grave të transferuara ose të shitura nga pronarët e tyre tek “pronarë” të tjerë në Kosovë, ose ndonjëherë në Maqedoni. TPIU-ja informoi Amnesty International për rastin e një gruaje të re, që kishte arritur t’u telefononte atyre për t’i informuar se ishte thuar gati për t’u shitur; TPIU-ja pastaj kreu një operacion për ta larguar atë nga lokali. ¹³²¹¹⁴

Nga fundi i 2001, baza e të dhënave e TPIU-së përfshinte afro 1028 gra, disa të listuara në skemën e regjistrimit, të tjerat të identifikuar gjatë “hetimeve të TPIU-së, bllokimeve të automjeteve nga patrullat me uniformë, patrullat e KFOR-it dhe policia kufitare”. ¹⁷²⁷

¹³⁰¹¹² Gratë e regjistruara u autorizuan të rrinë në Kosovë një muaj, ose sa zgjatja e “kontratës” së tyre, pas së cilës ato i nënshtroheshin dëbimit, OSCE, *Kosovë: Vështrim i Sistemit të Drejtësisë Penale, mars 2001 – gusht 2001*, fq. 50-1. Sistemi i ri nuk lidhet më me dëbimin.

¹³¹¹¹³ Intervistë e AI me Jamie Higgins, Ish-kryetar i TPIU, nëntor 2002.

¹³²¹¹⁴ Intervistë e AI me Irina Cocos, TPIU, shtator 2003.

gra të tjera u regjistruan më 2002 dhe 1096 të tjera më 2003. ¹³³¹¹⁵

Më 6 korrik 2001, 11 gra nga Rumania, Moldavia dhe Ukraina, që ishin duke punuar si valltare tek klubi i natës Miami Beach në Prishtinë, u intervistuan nga hetuesit e TPIU-së dhe u “këshilluan të regjistroheshin”. UNMIK-u njoftonte se: “Asnjë arrestim apo sekuestrim nuk u bë në këtë rast. Operacione të tilla do të vazhdojnë në të ardhmen që të vëzhgojë gratë që dallohet se janë në rrezik të madh për nënshtrim ndaj prostitucionit. Regjistrimi i grupeve të tilla në shënjestër nga TPIU-ja do të ndihmojnë për të mbikëqyrur më mirë lëvizjet dhe aktivitetet e tyre e do të shërbejnë si një siguri kundër shfrytëzimit të tyre të mundshëm.” ¹³⁴¹¹⁶ Në përgjigje të një ankese nga dy prej grave, TPIU-ja inicoi më pas një hetim ndaj thënieve të tyre. Megjithatë, gratë qëndruan në klub edhe një muaj tjetër para se pronari dhe ndihmësi i tij të arrestoheshin.

Amnesty International mendon se në disa raste sistemi i regjistrimit nuk ka arritur t’i mbrojë të drejtat e grave të trafikuar, duke i lënë ato të punojnë nëpër bare dhe lokale të tjera ku ato janë të pambrojtura nga shkelje të mëtejshme të të drejtave të tyre njerëzore, deri sa të mblidhen dëshmi të mjaftueshme për ndjekje kundër “pronarëve” të tyre.

Në rastin e Miami Beach gratë ishin në gjendje të parajmëronin policinë, por Amnesty International u informua më 2003 nga organizata që punojnë me gratë e trafikuar që, me sa duket, marrëdhëniet “miqësore” ndërmjet TPIU-së dhe policive të tjera, dhe pronarëve të bareve e bënë të vështirë për gratë të besojnë tek policia. Ato njoftojnë se gratë vërejnë vizita të rregullta të policisë në bare-pa pasur ndonjë rezultat të dukshëm-sigur të legjitimitonin prostitucionin e tyre të detyruar, dhe disa besojnë se policia është marrë vesh me trafikuesin e tyre që t’i mbajë ato atje. Një grua e trafikuar i tha Amnesty International:

“Shumë policë vijnë çdo ditë dhe ata ishin miq me pronarin e barit. Policia e UN-it erdhi dy herë. Pjesën tjetër të kohës ishte kryesisht KPS. Një polic erdhi dhe më kërkoi të dilja jashtë. Ai më bëri disa pyetje, por unë nuk mund të thosha asgjë për shkak të kërcënimeve të pronarit. Mikesha e tij flet gjuhën time dhe pronari më vuri të shkruaja çdo gjë që i kisha thënë policisë. Ishte një proces regjistrimi. Pronari, vajzat dhe të gjithë policët [ulur] bashkë, kështu që ne mund të dëgjonim çdo gjë që po thoshte secili.” ¹³⁵¹¹⁷

¹³³¹¹⁵ Raporti Vjetor i TPIU-së, dhjetor 31, 2001; Raporti Vjetor i TPIU-së 2002, dhjetor 31, 2002; Raporti Vjetor i TPIU-së, 2003.

¹³⁴¹¹⁶ UNMIK-u-KFOR-i Policia e UNMIK-ut-Përmbledhje e shtypit e UNHCR-së, 9 korrik 2001.

¹³⁵¹¹⁷ Grua bullgare “e shpëtuar” më 2003.



Kjo grua i tha Amnesty International se sa e vështirë kishte qenë t'i transmetonte një oficeri të TPIU-së se ajo donte të arratisej, "Polici foli anglisht,pastaj serbisht. Ne folëm me kujdes dhe unë i thashë atij të më thoshte, 'ti duhet të vish me ne'."

Amnesty International është veçanërisht e preokupuar se vajzat nën 18 vjeç përbëjnë midis 15 dhe 20 për qind të atyre të regjistruara dhe, në vend që t'i largojnë vajzat e dyshuara se janë trafikuar, TPIU-ja u lejon atyre të qëndrojnë nëpër bare. 136¹¹⁸ Në përgjigje të shqetësimeve të organizatës,TPIU-ja i tha Amnesty International se në disa raste ata kontaktuan IOM-in, por asnjë përpjekje nuk u bë nga TPIU-ja për t'i larguar ato: "Në qoftë se ju e futni të miturin në strehëz,ai arratiset dhe ju e gjeni atë përsëri në bar.Ata ia mbathin nga shtëpia dhe arratisen nga strehëza."137¹¹⁹

Amnesty International është e preokupuar se regjistrimi, i cili është përdorur kryesisht si mjet hetimor,u lejon grave dhe vajzave që të besojnë se janë trafikuar për të qëndruar në bare, të pambrojtura nga abuzime të mëtejshme,deri sa të mblidhen dëshmi kundër "pronarëve " të tyre.Në vend që të jetë një masë për të mbrojtur të drejtat e grave të trafikuar,procesi i regjistrimit ndodh në prani të "pronarit " të tyre,dhe nuk është udhëzues për gruan sa që të jetë e zonja që të identifikojë në mënyrë të sigurt vetveten si një viktimë e trafikimit.Për më tepër,për shkak me sa duket të marrëdhënieve miqësore mes pronarëve të bareve dhe policisë, regjistrimi duket,në sytë e grave, se legjitimon prostitucionin e tyre të detyruar.

Kontrolli i kufirit

Masat për të kontrolluar trafikimin nëpërmjet identifikimit të grave të trafikuar ose arrestimit të trafikantëve të dyshuar në kufi, kanë qenë relativisht joefektive.Pak gra të trafikuar janë identifikuar,qoftë në kufijtë ndërkombëtarë, apo në vijën kufizuese administrative mes Kosovës dhe Serbisë vetë,edhe pse ata mbulohej nga 12 rajone policie dhe nga patrulla të rregullta të KFOR-.

Pezullimi nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të UN më 2002 i Ligjit mbi Lëvizjen dhe

136¹¹⁸ Intervistë e AI me Jamie Higgins, me pas Kryetar i TPIU, nëntor 2002.

137¹¹⁹ Intervistë e AI me Irina Cocos, më pas Kryetar i Përkohshëm i TPIU, tetor 2003.

138¹¹⁹ Sipas UNSCR-së 1244/999 Kosova mbetet pjesë e Serbisë dhe Malit të Zi, duke mbajtur kufijtë e jashtëm me Shqipërinë,Maqedoninë, të cilët, si Vija Kufitare Administrative(ABL) me Serbinë,mbulohej nga Policia Kufitare e UNMIK-ut;ABL patrullohet gjithashtu nga KFOR-i.Në Kosovë nuk përfitohet regjim vizash,dhe me përjashtim të grave të dyshuara se janë trafikuar, vizitorët ose punëtorët e huaj,duke përfshirë pjesëtarët e komunitetit ndërkombëtar, nuk kërkohet të regjistrojnë prezencën e tyre në Kosovë.

Qëndrimin e të Huajve,138¹²⁰ i cili parashikon arrestimin e menjëhershëm dhe dëbimin e personave që gjenden në mënyrë të paligjshme në Kosovë, e parandaloi efektivisht policinë kufitare që të refuzonte hyrjen ose të bënte arrestime,përveçse sipas Rregullores së UNMIK-ut 2001/10 ose për shkelje në dokumente,pa provë të qartë trafikimi. Megjithatë,në rastet ku Policia Kufitare ishte në gjendje të identifikonte gra ose vajza që ata dyshojnë se janë trafikuar, ata i intervistojnë ato veçmas,në mënyrë që të vendosin ku mund të jenë duke udhëtuar dhe pastaj të njoftojnë TPIU-në,e cila mund të ndërmarrë veprimin e duhur.Më 13 maj 2002, për shembull,dy burra u arrestuan menjëherë pasi kaluan kufirin dhe iu dorëzuan TPIU-së .Dy pasagjeret e tyre femra ukrainase-të cilat ishin rrahur dhe përdhunuar-u siguruan në strehëz 139. ¹²¹

Mbyllja e lokaleve

Më tetor 2003,pavarësisht nga arrestimi i një klienti dhe një gruaje(që TPIU-ja e dinte se ishte trafikuar) gjatë aktit seksual,dhe dëshmia e klientit se miqtë e tij kishin blerë shërbimet seksuale të gruas për të, Gjykatësi hetimor refuzoi të lëshonte një urdhër për të mbyllur lokalin.Gruaja më pas u shpall fajtores për prostitucion dhe u dënua me 20 ditë burgim.Kur Amnesty International pyeti përse ata kishin ngritur akuza kundër gruas për prostitucion, TPIU-ja iu përgjigj: "Disa nga gratë nuk kanë dashur të konsiderohen viktimat; ato veç vazhdojnë me këtë punë". Klienti nuk u akuzua sipas Rregullores së Trafikimit. 140¹²²

Seksioni 6.2 i Rregullores së Trafikimit parashikon një gjykatës hetimor me fuqi për të mbyllur lokalet që besohet se janë përfshirë ose e mbështetin trafikimin;sidoqoftë,shifrat e lokaleve të mbyllura kanë qenë të vogla në krahasim me numrin e bastisjeve të kryera: më 2002, 370 bastisje përfunduan me mbylljen e afro 57 lokaleve.141¹²³ TPIU-ja i shprehu zemërimin e saj Amnesty International se gjyqësori tregohet ngurrues për të mbyllur lokale, pavarësisht nga kompetencat e tyre sipas ligjit të zbatuar.

Organizata vëren se ligji i zbatuar në Kosovë e ndalon punësimin e personave nën 18 vjeç në "punë,që nga natyra e saj,ose nga rrethanat në të cilat kryhet, ka të ngjarë të rrezikojë shëndetin,sigurinë apo moralin e një personi të ri në moshë".142¹²⁴ Organizata veç është në dijeni të një

139¹²⁰ Ligji për Lëvizjen dhe Qëndrimin e të Huajve, *Sluzbeni List SFRJ* Nos.56/80,53/85 dhe 30/89.

140¹²¹ *UNMIK-u- Policia e UNMIK-ut –Përmbledhja e Shtypit e KFOR-it*, 20 maj 2002.

141¹²² Intervistë e AI me Irina Cocos, më pas Kryetar i Përkohshëm i TPIU, tetor 2003.

142¹²³ TPIU, *Raporti Vjetor 2002 dhe Raporti Vjetor 2003*.

143¹²⁴ Seksioni 3.1, Rregullorja e UNMIK-U 2001/27, *Për Ligjin Bazë të Punës në Kosovë*, 8 tetor 2001.



rasti që ky legjislacion është përdorur si një arsye për mbyllje bari 143¹²⁵ dhe u kërkon autoriteteve të bëjnë përdorim të mëtejshëm të këtyre masave, kur ka baza të arsyeshme për të dyshuar se, ato vajza që punojnë në ato lokale, mund të jenë trafikuar për prostitucion të detyruar ose mund të jenë në rrezik për t'u trafikuar.

Më qershor 2001 TPIU-ja përdori një strategji, që policia të shoqëronte zjarrfikësit e bashkisë vendore dhe inspektorët e rregullores së shëndetit kur kryenin ekzaminime të rastësishme të bareve dhe kafeneve dhe pyetnin klientët dhe gratë e gjetura në ato biznese .Për shembull,një ekip i përbashkët inspektimi Zjarrfikës-Shëndetësi-Polici kryen ekzaminime të shumë bareve në Prizren, të dyshuara se ishin vende prostitucioni, që përfunduan me mbylljen e njërit për shkelje shëndetësore dhe me shtrimin në spital të katër grave moldave 20-vjeçare.Megjithëse kjo strategji ka qenë efektive në Bashkinë e Prizrenit,jo të gjitha autoritetet bashkiake kanë qenë kaq dashamirëse për të bashkëpunuar me TPIU-në.

Megjithatë,aty ku lokale të tilla janë mbyllur,disa pronarë thjesht i kanë transferuar veprimtarinë e tyre në zonë tjetër. Gjithnjë e më tepër, ka dëshmi se, me qëllim që të shmangin ndërprerjen e biznesit të tyre,trafikantë i kanë lëvizur gratë nga baret për në apartamente private.Klientët tani vizitojnë barin,kafenenë ose restorantin,blejnë seks(zakonisht duke blerë një artikull të shtrenjtë në menu),dhe pastaj çohen,ose u jepet adresa e një shtëpie private,apartamenti ose dhoma hoteli,ku mbahen gratë e trafikuar.

Operacionet e fshehta

Ndonëse TPIU-ja mendon se bastisjet e bareve ishin fillimisht një strategji efektive,e shqetësuar nga mungesa e përparimit dhe nga dyfishimi i lokaleve të përfshira në prostitucion midis 2002 dhe 2003,144¹²⁶ më qershor 2003 TPIU-ja vendosi gjerësisht t'i braktisë bastisjet, dhe të shkojë drejt një strategjie hetimore të bazuar në operacionet e fshehta dhe përgjimin,të kryera në bashkëpunim me Policinë e Krimin të Organizuar të Kosovës dhe me Njësinë Hetimore Kriminale Qëndrore.¹²⁷

Nga korriku 2003, TPIU-ja kishte kryer 14 operacione të fshehta, që përfunduan më arrestimin e gjashtë trafikantëve të dyshuar. Më 17 qershor 2003,në një

144¹²⁵ Më 28 shtator 2002, policia dhe KFOR- kryen bastisje në 11 kafé-bare në Gjakovë/Đjakovica, 10 prej të cilëve më pas u mbyllën për prostitucion ose për punësim të të miturve, ose që të dyja;tre të mitur "u shpëtuan", Shënime Përmbledhëse të Shtypit të UNMIK-U, 1 tetor 2002. 145¹²⁶ Qysh nga hyrja e Rregullores, numri i lokaleve në "listën e gjërave të ndaluar" është thujse dyfishuar. Më 1 janar 2002, ishin listuar 110 lokale;një vit më vonë, ishin listuar 210 lokale; dhe nga marsi 2004, ishin listuar afro 171 lokale.

¹²⁷ Të autorizuar sipas rregullores së UNMIK-ut 2002/6, *Për masat e fshehta dhe teknike të përgjimit dhe hetimit*, 18 mars 2002.

operacion të fshehtë për hetimin e Restorant California në Prizren,një oficer i KPS i veshur civil konfirmoi dyshimin se klientëve u ofroheshin shërbime prostitucioni dhe se personeli i restorantit ishte i përfshirë drejtpërdrejt.Më pas ,drejtuesi i restorantit dhe dy gra u arrestuan,dhe gjashtë gra të tjera që punonin në restorant u paraburgosën për t'u hetuar.TPIU-ja më pas kërkoj mbylljen e përhershme të restorantit.¹²⁸

Duke iu përgjigjur kërkesave

Amnesty International vëren se pak është bërë për t'u përgjigjur kërkesës për shërbimet e grave të trafikuar në Kosovë. TPIU-ja rrallë ka arrestuar burra të dyshuar që përdorin "me dijeni"shërbimet e grave të trafikuar sipas Seksionit 10 të Rregullores së Trafikimit.

Megjithatë, TPIU-ja i tregoi Amnesty International se ajo ka për qëllim të përndjekë personelin e UNMIK-ut dhe KFOR-it që dyshohet për shkeljen e Seksionit 10 më me ashpërsi, dhe se ka përdorur një strategji të re për të arritur që dhe personeli civil ndërkombëtar, i cili punon për kontraktorët ndërkombëtarë të KFOR-it, të përfshihet.Një kontraktor u arrestua më tetor 2003,por më pas u lirua nga detyra dhe u riatdhesua; kundër tij nuk u bë procedim penal¹²⁹

Disa shqiptarë të dyshuar se me dijeni kanë blerë shërbimet e grave të trafikuar-kryesisht në raste që përfshijnë vajza – ishin arrestuar, por TPIU-ja njoftoi se ka pasur vështirësi në mbledhjen e dëshmive të mjaftueshme për t'i çuar rastet në gjyq.

Amnesty International u informua nga TPIU-ja se ata vazhdojnë të pengohen në përpjekjet e tyre nga mungesa e fondeve ose pajisjeve,veçanërisht për trajnime dhe për pajisje për operacionet e fshehta. Ndonëse gratë ia kanë arritur të lënë gjendjen e tyre si rezultat i stategjive kundër trafikimit të UNMIK-ut,policia e UNMIK-ut nuk ka mundur të zgjidhë problemin e trafikimit në Kosovë në mënyrë të kënaqshme.Numri i lokaleve ku gratë e trafikuar mendohet se punojnë(dhe numri i grave të trafikuar)është rritur,dhe numri i shkelësve të çuar para drejtësisë mbetet i ulët.Pavarësisht nga dispozitat e Seksionit 4 të Rregullores së Trafikimit ,e cila penalizon ata që me dijeni përdorin ose tregtojnë shërbimet e grave të trafikuar, UNMIK-u ka dështuar veçanërisht për të zgjidhur çështjen e kërkesës për shërbimet e grave të trafikuar. ¹³⁰ Ndërkaq,një numër i madh grash,të konsideruara nga TPIU-ja se kanë qenë të trafikuar, janë përndjekur në vend që të mbrohen.

¹²⁸ *Shënime përmbledhëse të Policisë së UNMIK-ut*, 24 qershor 2003.

¹²⁹ Intervistë e AI me Irina Cocos, më pas Kryetar i Përkohshëm i TPIU-së, tetor 2003; email: Derek Chappell, Policia e UNMIK-ut, mars 2003.

¹³⁰ Për sa ka dijeni organizata,asnjë procedim nuk është bërë sipas Seksionit 4.



Policia e UNMIK-ut dhe gjyqësori nevojitet të sigurojnë që të drejtat e grave të trafikuar të respektohen plotësisht brenda sistemit të drejtësisë penale, në mënyrë që, pasi kanë shpëtuar nga një seri shkeljesh të të drejtave të njeriut, gratë e trafikuar të mos i nënshtrohen më një serie tjetër shkeljesh në duart e autoriteteve.

Procese penale kundër trafikantëve

Numri i procedimeve të burrave të dyshuar për përfshirje në trafikim është i ulët në krahasim me numrin e bastisjeve dhe operacioneve të tjera të kryera nga TPIU-ja. Kjo mundet, pjesërisht, të shpjegohet nga një ngurrim i kuptueshëm i mjaft grave të trafikuar-i lindur nga trauma që kanë vuajtur tashmë dhe nga frika e vazhdueshme prej trafikuesve të tyre-që të dëshmojnë në procedurat penale. Ka prova për të menduar se shumë gra të trafikuar brenda preferojnë të riatdeshohen sa më shpejt të jetë e mundur, sesa të presin pastaj deri në arrestimin e trafikuesit të tyre dhe pastaj të marrin pjesë në procedimin penal kundër trafikuesve të tyre.

Duke e njohur këtë, Seksioni 5.1 i Rregullores së Trafikimit parashikon që "marrja e një deklaratë nga oficeri i zbatimit të ligjit ose gjykatësi hetimor nuk duhet të ndalojë kurrsesi ose të vonojë riatdeshimin vullnetar të një viktime të pandehur trafikimi. Kjo dispozitë është një burim tensioni ndërmjet IOM-it, si organizatë riatdeshimi, dhe TPIU-së e Departamentit të Drejtësisë dhe atij që mendon se riatdeshimi i shpejtë i dëshmitarëve potencialë nxjerr një barrierë për ndjekje ligjore të suksesshme. Duke qenë se, me sa ka dijeni TPIU-ja, shumica e grave nuk do' të marrë pjesë në proceset gjyqësore penale - "ato duan veç të dalin jashtë prej këtej" - mbetet të shihet nëse masat e përmirësuara për mbrojtjen e dëshmitarit do t'i nxitin gratë të rrinë e të dëshmojnë. Në kohën e këtij shkrimi, në mungesë të një programi të përshtatshëm të mbrojtjes së dëshmitarit, është më e sigurt për gratë dhe vajzat e trafikuar jashtë të lënë vendin. Për gratë e trafikuar brenda vendit, zgjidhjet janë më të ndërlikuar.

Sipas TPIU, më 2001 u ngritën afro 52 padi kundër trafikantëve të dyshuar. Deri në fund të 2001, bazuar në raporte, në 25 prej këtyre rasteve, 15 përfunduan me dënim për shkeljen trafikim, pesë me lirim ose dhënie pafajësie të dyshuarit dhe pesë procese vazhdonin. Më 2002, 92 padi të tjera u sollën në vëmendjen e gjykatave. Bazuar në raportet, në 68 të këtyre rasteve, afro 27 njerëz u dënuan, 19 fituan pafajësinë ose u liruan dhe afro 22 qëndrojnë para gjykatave. Afro 60 padi të tjera u ngritën më 2003; deri në fund të vitit afro 16 njerëz u dënuan, 18 u shpallën të pafajshëm ose u liruan dhe afro 26 qëndrojnë para gjykatave.¹³¹

¹³¹ TPIU, *Raporti vjetor për 2001, 2002 dhe 2003*.

Shifrat e përgjithshme të siguruara për Amnesty International nga Departamenti i Drejtësisë, megjithatë, ndryshojnë. Sipas Departamentit të Drejtësisë, deri më dhjetor 2002, afro 80 raste trafikimi janë skeduar sipas Rregullores së Trafikimit. Nga keto, 45 ishin mbyllur, duke përfunduar me dënimin e afro 76 të dyshuarve; tetë të tjerë ose ishin shpallur të pafajshëm, ose akuzat kundër tyre u rrëzuan. Ndonëse sipas Rregullores së Trafikimit dënimi minimal për shpalljen fajtor për përfshirje ose përpjekje për përfshirje në trafikim është dy vjet-dhe pesë vjet për një person të shpallur fajtor për organizimin e një grupi me qëllim trafikimi¹³² - dënimet e dhëna nga gjykatat deri në fund të 2002 shkonin nga katër muaj deri më gjashtë vjet, me 88 për qind ndërmjet katër muajve dhe tri vjetëve.

Shpjegimet mbi pazotësinë për të dhënë të paktën dënimet minimale, të përcaktuara në Rregulloren e Trafikimit, janë kundërshtuar. Pjesëtarë të komunitetit ndërkombëtar kanë pohuar se gjykatësve shqiptarë kosovarë, të cilët drejtojnë këto raste, u mungon kuptimi i Rregullores së Trafikimit dhe i gravitetit të krimit, por pranojnë gjithashtu se disa u nënshtrohen presioneve nga trafikantët. Disa pjesëtarë shqiptarë të gjyqësorit kanë pohuar se ngurrimi i tyre për të dhënë dënime më të rënda vjen nga shqetësimet për sigurinë e tyre personale. Deri më 2003, politika e Departamentit të Drejtësisë së UNMIK-ut duket se ishte që rastet e trafikimit, kurdo që të ishte e mundur, të drejtoheshin nga nga gjykatës dhe prokurorë ndërkombëtarë, të cilët ishin të pajisur me skortë sigurimi.¹³³ Megjithatë, prania e një gjykatësi ndërkombëtar në rastet e trafikimit prapë nuk përfundon gjithnjë më dhënien e dënimin minimal pas shpalljes fajtor.

Gjatë seancave dëgjimore avokatët që përfaqësojnë të dyshuarit për trafikim shpesh më sukses demonstronjë rrethana lehtësuese me pretekste që përfshijnë moshën ose gjendjen martesore të të dyshuarit, ose mungesën e ndonjë dënimi të mëparshëm. Në një rast, një burrë i shpallur fajtor për dy akt-akuza trafikimi dhe dy akt-akuza për mbajtjen e dokumenteve të identifikimit, sipas Seksioni 2.1 dhe 3 të Rregullores, u dënuar me tri vjet burgim, bazuar në atë që "i akuzuari, gjatë, nuk ka qenë i dënuar deri tani, se ai kishte një farë mendjelehtësie, ai nuk është i mirarsimuar, jeton më vete pa asnjë lloj familjeje që do të mund t'i jepte atij mbështetje dhe drejtim për jetën e vet, se ai kishte një gjendje të keqe financiare, se ai nuk i detyroi T. dhe M. [gratë e trafikuar] të bënin seks më të, se ai i kishte rrahur ato, por jo shumë [herë]; se ai i kishte marrë

¹³² Seksioni 2.1 dhe 2.3 Reg. UNMIK-ut. 2001/4.

¹³³ Më 2003, për shkak të një numri në rritje të gjyqeve për krime lufte të nivelit të lartë, gjyqtarët ndërkombëtarë kryesuan vetëm afro një gjyq trafikimi, në të cilin ata dënuan një të pandehur me tri vjet burgim dhe dy të tjerë më katër vjet, e-mail AI nga Ioan Tudorache, Departamenti i Drejtësisë, mars 2004.



dokumentet [e tyre] të identifikimit,por jo qysh nga fillimi.”¹³⁴

Amnesty International vëren,megjithatë,se një vajzë 17-vjeçare ,e dënuar për trafikim të të miturve të tjerë, u dënua për të shërbyer deri më pesë vjet në një institucion riedukimi.¹³⁵

Amnesty International vëren se pjesëtarë të gjyqësorit ndërkombëtar dhe kosovar nuk kanë arritur në shumicën e rasteve të japin vendime sipas dispozitave të Rregullores,dhe të cilat përputhen më peshën e shkeljeve penale dhe abuzimet e të drejtave të njeriut që i vuajtën viktimat.¹³⁶

Në mjaft nga këto raste,shpallja e të akuzuarit i pafajshëm ose dhënia e vendimit nën minimumin që është parashikuar në Rregulloren e Trafikimit i është veshur faktit se gratë e trafikuar nuk ishin të pranishme për të dëshmuar gjatë proceseve të gjykatave të shkallës së parë,duke qenë shumica ose e riatdhesuar,ose pa dëshirë për të dëshmuar.

Ato që ishin përgatitur për te dëshmuar,kishin mundësi ta bënin këtë sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale i cili i lejon dëshmitarit ose palës së dëmtuar të bëjë një deklaratë para gjykatësit hetimor.¹³⁷ Kjo deklaratë mund pastaj të lexohet si dëshmi gjatë gjyqit,në rast se këshillit të mbrojtjes i është dhënë mundësia që të kundërhetojë dëshmitarin.¹³⁸ Megjithatë,sipas informacionit që zotëron Amnesty International, këto deklaratë ka më pak të ngjarë të mbajnë peshën e deklaratave të dëshmimeve të mbrojtjes të cilat paraqiten në gjyq.¹³⁹

Sipas kodit të ri të procedurës penale,i cili hyri në fuqi më 6 prill 2004,si një rregull i përgjithshëm, vetëm deklaratat e bëra gjatë procesit gjyqësor do të pranohen.Kjo do të thotë se gratë e trafikuar nuk do kenë më mundësi të sjellin dëshmi para një gjykatësi hetimor,pasi hetimi do të

¹³⁴ Gjykata e Qarkut Peja/Pec, P.Nr 131/2001, 8 janar 2002;Seksioni 2.1 mori një dënim me dy vjet burgim,dhe Seksioni 3,një dënim minimal me gjashtë muaj.

¹³⁵ Intervistë e AI me Sebiha Mexhuani, OSCE, shtator 2003.

¹³⁶ Në mënyrë të ngjashme, dënime të lehta u dhanë sipas Nenit 251, para Rregullores.Më 2 shkurt 2001, për shembull, D.N., u dënua për një akuzë sipas Nenit 251, tri akuza për përdhunim dhe një për falsifikim doekumentesh, me tri vjet e gjashtë muaj burgim dhe u lirua në pritje të apelimit. Sipas ligjit të zbatuar,Neni 103 i Ligjit Penal të Republikës së Serbisë,përdhunimi atëherë merrte një dënim ndërmjet një dhe dhjetë vjet burgim.

¹³⁷ Rregullorja e UNMIK-ut No. 2000/17, Për Vlefshmërinë e Disa Deklaratave të Dëshmitarit në Hetimet Paraprake, 23 mars 2000.

¹³⁸ Si TPIU-ja dhe LSMS-ja raportojnë se këshilli i mbrojtjes shpesh nuk ka mundur të paraqitet në procedime të tilla.

¹³⁹Shih për shembull, Vendim i një çështjeje të Apelit, Gjykata e Lartë e Kosovës, 29 prill 2003, që la në fuqi vendimin e Gjykatës së Qarkut të Prizrenit, P. no. 243/2002, datë 29 nëntor 2002, në të cilin i dyshuari u shpall i pafajshëm për akuzat sipas seksionit 2.2 të Rregullores së Trafikimit.

bëhet nga zyra e prokurorit publik.Megjithatë Amnesty International vëren se kjo nuk jep siguri ose mund të çojë në papranueshmërinë e deklaratave të bëra gjatë hetimeve-të cilat do të kryhen nga policia dhe prokuroria -rëndësi i duhet dhënë futjes së masave të mëtëjshme speciale për sigurimin e dëshmisë nga dëshmitarët-viktimë,të cilët mbrojnë të drejtat e tyre,por nuk i kompromentojnë të drejtat e të pandehurit për një gjykim të drejtë.¹⁴⁰

¹⁴⁰ Sipas Kodit Penal të ri,hetimet do të inicoohen nga zyra e prokurorit publik, Shih Kapitujt XXIII- XXV, Kodi Penal i Përkohshëm i Kosovës për pyetjen e dëshmitarëve para proceseve gjyqësore, shih Nenin 238, (Mundësi e Jashtëzakonshme Hetimore) i cili parashikon që një gjykatës paragjyqësor të marrë dëshmi nga një dëshmitar ”kur ka një mundësi të vetme për të mbledhur dëshmi të rëndësishme ose ka rrezik të konsiderueshëm që kjo dëshmi të mos jetë disponibël në gjyqin kryesor”.



Kapitulli 4: Mbrojtje dhe mbështetje për gratë dhe vajzat e trafikuar

Asistenca për gjithë gratë e trafikuar, pavarësisht në se ato marrin pjesë në proceset penale, është themelore për të siguruar respekt për to dhe mbrojtje të drejtave të tyre, duke përfshirë aftësimin e tyre që të bëhen aktorë aktivë në përcaktimin e së ardhmes së tyre dhe duke siguruar mundësinë e tyre për zhdëmtim, përfshirë dëmshpërbilimin, për shkeljet e të drejtave të njeriut të cilave ato u janë nënshtruar.

E drejta për asistencë

Standardet nderkombëtare u kërkojnë shteteve të sigurojnë mbrojtje të përshtatshme dhe shërbime ndihmëse për gratë që janë viktime të dhunës. Rekomandimi i Përgjithshëm 19 i UN-it CEDAW u kërkon shteteve të sigurojnë:

“Shërbime të përshtatshme mbrojtëse dhe ndihmëse” dhe “Masa mbrojtëse, duke përfshirë azil, këshillim, rehabilitim dhe shërbime ndihme për gratë që janë viktimat e dhunës ose që janë në rrezik nga dhuna”.¹⁴¹ Udhëzimi i UNHCHR-së 4.5 këshillon shtetet të “sigurojnë që kjo e drejtë për këtë informacion, ndihmë dhe mbështetje të menjëhershme nuk është arbitrare, por është e vlefshme si një e drejtë për të gjithë personat që janë identifikuar si të trafikuar”.¹⁴²

Amnesty International vëren gjithashtu se Nenet 6 dhe 7 të Protokollit të Trafikimit parashikojnë për këtë mbështetje, ndihmë dhe mbrojtje të viktimave të trafikimit, si bëjnë dhe Nenet 24 e 25 të Konventës për Krimin e Organizuar Ndërshtetëror. Megjithatë, këto dispozita vetëm u kërkojnë palëve shtet të “kenë parasysh zbatimin” e tyre “në rastet e duhura”. Në Kosovë, dispozitat si për “mbrojtjen, dhe për ndihmën e viktimës” janë përcaktuar në Seksionin 10 të Rregullores së Trafikimit.

Afro tri vjet pas shpalljes së Rregullores së Trafikimit, Amnesty International është e preokupuar se një Direktivë Administrative (AD), që synon të japë udhëzime për zbatimin e Seksionit 10 të Rregullores, pret ende të hyjë në fuqi.¹⁴³ Organizata është gjithashtu e shqetësuar se

¹⁴¹ Neni 24 (b), Rekomandimi i Përgjithshëm 19 i CEDAW-it.

¹⁴² Deklarata e Parimeve të Drejtësisë për Viktimat e Krimin dhe Abuzimit me Forcën, e UN-it, për shembull, parashikon si për “Mundësi për Drejtësi dhe Trajtim të Ndershëm”, ashtu dhe “Asistencë”, përcaktohet se përfshijnë “materialin e nevojshëm, ndihmën mjekësore, psikologjike dhe asistencën sociale nëpërmjet mjeteve qeveritare, vullnetare, me bazë komunitare dhe lokale”. Rezoluta e UN GA 40/34, 29 nëntor 1985.

¹⁴³ Teksti i një AD që zbaton Seksionin 10 të Rregullores së Trafikimit njoftohet se u përfundua deri më prill 2001, por autorizimi i tij përfundimtar u zgjat, nga sa thuhet për shkak të shqetësimeve të lidhura me mungesën e kapacitetit për të përballuar kostot e kompensimit si dhe me debatin e mëtejshëm rreth dispozitave të tij. Një projekt i dytë përfundoi më prill 2002 dhe një i tretë më shtator 2003.

teksti i projektit të përfunduar më shtator 2003, i cili ishte pritur të hynte në fuqi më 1 tetor 2003,¹⁴⁴ nuk arriti të sigurojë njohjen e duhur të të drejtave të viktimave të trafikimit për ndihmë dhe një të drejtë të detyrueshme për kompensim.

Projekti i shtatorit 2003 i AD përcakton procedurat përmes të cilave një grua e trafikuar mund të bëjë kërkesë për ndihmë dhe dëmshpërbim. Ajo kërkon që gruaja e trafikuar t'i bëjë një kërkesë, duke paraqitur dëshmi dokumentare mbështetëse, koordinatori të Ndhmës për Viktimat (VAC) me qëllim që të marrë ndihmën falas të një përkthyesi dhe një këshilltari ligjor; një strehim të përkohshëm të sigurt, ndihmë psikologjike, mjekësore dhe asistencë sociale; ndihmë për riintegrim dhe/ose kthim; ndihmë financiare dhe dëmshpërblime. Vendimet duhet të merren nga VAC brenda 30 ditësh nga kërkesa.

Amnesty International është e preokupuar se shtresa burokratike të krijuara nga kjo procedurë, dhe mungesa e detyrimeve shoqëruese për të këshilluar viktimën për të drejtat e saj, mund ta minojnë gëzimin e këtyre të drejtave.

Organizata është veçanërisht e preokupuar se këto procedura janë duke krijuar pengesa të reja për gëzimin e këtyre të drejtave duke qenë se, në kohën e këtij shkrimi, gjithë këto shërbime, me përjashtim të këshillimit ligjor dhe mundësisë për kompensim, janë siguruar tashmë nga organizatat nderkombëtare dhe vendase, puna e të cilave është përshkruar me vonë në këtë kapitull. Amnesty International beson se futja e një procesi aplikimi për një ndihmë të tillë mundet, në praktikë, të jetë e papajtueshme me Rekomandimin e Përgjithshëm 19 të CEDAW-it dhe me Udhëzimin 9.1 të UNHCHR-së, i cili kërkon që: “viktimat e trafikut kanë një të drejtë të detyrueshme për zhdëmtime të drejta dhe të përshtatshme, duke përfshirë mjetet për një rehabilitim sa më të plotë që të jetë e mundur. Këto zhdëmtime mund të jenë me natyrë penale, civile ose administrative”.

AD-ja gjithashtu e vlerëson si një përgjegjësi të gruas së trafikuar të sigurojë dëshmi “për të mbështetur një besim të arsyeshëm” se ajo është trafikuar. Amnesty International është e preokupuar se kjo imponon një barrë të panevojshme mbi personin e trafikuar dhe vëren nga ky këndvështrim se ka të ngjarë që një grua, e cila është në diejini për kërkesat për të bërë një aplikim të tillë me qëllim që të mundësojë shërbime dhe asistencë, do të jetë identifikuar ndërkaq nga TPIU-ja, OSCE-ja ose dhe IOM-i ose, për shembull, CPWC-ja, si një “viktimitë e trafikimit”. Projekti i mëparshëm i AD-së, i datuar prill 2002, nuk i përfshinte dispozitat që i kërkojnë një gruje të trafikuar t'i

¹⁴⁴ Amnesty International e kupton se projekti i AD-së nuk u autorizua për shkak të një numri shqetësimesh rreth dispozitave të tij të shprehura si nga TPIU-ja, ashtu dhe nga organizata që punojnë më gra të trafikuar.



nënshtrohet një procedure për t'u kualifikuar për asistencë, por deri diku e koncepton rolin e VAC si *koordinues* i dhënies së asistencës nga një numër NGO-sh të ndryshme, UNMIK-u dhe PISG-u; t'organizata rekomandon që projekti aktual të amendohet për të pasqyruar këto dispozita të projektit të prillit 2002.

Duke parashikuar për një vendim asistence që të bëhet brenda 30 ditësh, AD s'arrin gjithashtu të pranojë se personat e trafikuar kërkojnë mbështetje të menjëhershme në vijim të "shpëtimit" të tyre ose arratisjes nga një situatë trafikimi (si në praktikën aktuale në Kosovë). Madje, edhe një proces i shpejtë në të cilin një vendim jepet brenda tri ditësh, siç parashihet në Seksionin 7, sipas pikëpamjes të Amnesty International, ndoshta nuk do t'i përgjigjej mjaftueshëm urgjencës së nevojës për asistencë dhe shërbime për personat e trafikuar. Lidhur me këtë Amnesty International vëren se rekomandimi 13 i Deklaratës së Brukselit pranon se gratë e trafikuar kërkojnë asistencë të menjëhershme dhe mbrojtje.¹⁴⁵

Përveç kësaj, Amnesty International është e preokupuar se përbërja e panelit, e parashikuar në procedurën e apelimit, ngre shqetësime të tjera.¹⁴⁶ Në veçanti, organizata është e shqetësuar se ka rrezik që e drejta e gruas së trafikuar për konfidencialitet do të kompromentohet nga bërja e informacionit konfidencial të disponueshëm për një audience më të gjerë se sa duhet të jetë e nevojshme, duke e ekspozuar kështu gruan ndaj rrezikut tjetër të pasojave.¹⁴⁷ Organizata vëren gjithashtu se TPIU-ja ka shprehur shqetësime se kjo procedurë mund të kompromentojë hetimet e tyre, duke i bërë hollësitë që lidhen me trafikuesit të disponueshme për panelin dhe duke vënë personelin e strehëzave edhe në një rrezik tjetër.¹⁴⁸

Ndonëse organizata e përshëndet një mekanizëm që merr masa për dëmshpërblime jashtë një procedure gjyqësore, Amnesty International është e preokupuar se, si dhënia e asistencës, dhe sigurimi i dëmshpërblimit nuk janë vetëm objekt i një vlerësimi të mundësive të gruas së trafikuar-ndonëse hollësitë se si këto duhet të vlerësohen nuk janë përcaktuar në projekt-por janë gjithashtu të varur nga

¹⁴⁵ Deklarata e Brukselit për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore, 18-20 shtator 2002.

¹⁴⁶ Paneli i rishqyrtimit do të përbëhet nga Gjykatësi i Gjykatës së Lartë, dy përfaqësues të Departamentit të Asistencës Sociale, policia e UNMIK-ut dhe përfaqësues të [IOM-it] dhe NGO-ve përkatëse vendase, Seksioni 3.2 Projekt-Direktiva, shtator 2003.

¹⁴⁷ Projekt-Seksioni 4.2 (d) kërkon nga aplikanti të japë hollësi të rrethanave në të cilat ajo u trafikua dhe "informacion për trafikantët e pandehur".

¹⁴⁸ Intervistë e AI, Jennifer Mc Mullan, Ish-kryetar i TPIU, shtator 2003.

burimet në dispozicion, të cilat VAC e ka pranuar se janë shumë të kufizuara.¹⁴⁹

Amnesty International është gjithashtu e preokupuar se përgjegjësia për zbatimin e AD do të bjerë mbi Departamentin e Drejtësisë, në vend të, për shembull, mbi Departamentin e Shëndetit dhe Asistencës Sociale, i cili mund të duket se është vendi më i përshtatshëm për sigurimin e asistencës dhe mbështetjes.¹⁵⁰

Pas takimeve me Avokatët e Viktimës dhe Njësinë e Asistencës (VAAU) më mars dhe shtator 2003, në të cilët organizata ngriti shqetësimet e saj, në një bisedë telefonike të mëvonshme me Zyrën e Çështjeve Ligjore të UNMIK-ut më nëntor 2003, Këshilltari i Lartë i Deputetit të SRSG-së përmendi se shqetësimet e Amnesty International rreth nevojës që asistencë e kërkuar nga gratë e trafikuar do të zgjidhet, ndonëse nuk u dha siguri e veçantë.¹⁵¹

Në dritën e këtyre shqetësimeve Amnesty International i kërkon UNMIK-ut të amendojë AD-në e shtatorit 2003, në mënyrë që të sigurojë që gratë dhe vajzat e trafikuar të marrin asistencë të menjëhershme dhe të përshtatshme, pa qenë nevoja të bëjnë një kërkesë formale. Organizata pranon se nevojitet një proces për të aftësuar gruan e trafikuar që të realizojë të drejtat e saj për dëmshpërblim, duke qenë se veç pak gra të trafikuar janë të afta ta bëjnë këtë nëpërmjet proceseve penale ose civile kundër trafikantëve.

Amnesty International vëren gjithashtu se projekti i AD-së nuk ka dispozita të veçanta për fëmijët që janë viktime të trafikimit. Organizata kërkon që UNMIK-ut të sigurojë që AD-ja e amenduar të përfshijë masa të veçanta për të ruajtur interesat më kryesore të fëmijëve të trafikuar, që është gëzimi i menjëhershëm i së drejtës për asistencë dhe kompensim të përshtatshëm.

Përzgjedhja për asistencë

Afërsisht 50 për qind e grave që përdorin strehëzat janë "shpëtuar" nga policia gjatë bastisjeve; të tjera-nëpërmjet veprimet të tyre, ose me ndihmën e të tjerëve-që përpiqen të arratisen, ose janë lejuar rastësisht të ikin nga trafikuesit e tyre, mund t'u jenë referuar strehëzave nga NGO të tjera dhe agjenci.¹⁵² Statusi i gruas së "shpëtuar" në bastisjet e policisë përcaktohet gjatë një zinxhiri deri në tri intervista të kryera në polici. Këto intervista kryhen, shpesh, në orët e para të mëngjesit, pa praninë e një avokati.

¹⁴⁹ Afro 50.000 €-u parashikuan: Intervistë e AI me Mumbi Njau, Koordinator, Avokatët e Viktimës dhe Njësia e Asistencës, shtator 2003

¹⁵⁰ Amnesty International vëren një prirje të fortë lidhur me Rekomandimet e Këshillit të Evropës që dhënia e asistencës dhe mbështetjes duhet të shpëputet nga procesi gjyqësor.

¹⁵¹ Bisede telefonike e AI me Nick Booth, OLA, nëntor 2003

¹⁵² Intervistë e AI me IOM-in dhe CPWC-në, shtator 2003.

CPWC, Raporti vjetor, prill 2003.



Kur gratë largohen nga baret, ato arrestohen dhe trajtohen si kriminelë të dyshuar, deri sa të mund të provojnë të kundërtën. Megjithatë, atyre nuk u jepen të drejtat që u takojnë të paraburgosurve sipas ligjit të zbatuar, duke përfshirë mundësinë për një avokat; për më tepër, fëmijët intervistohen pa praninë e një kujdestari ligjor (shih më poshtë). Ata do të privohen nga liria e tyre përveçse dhe deri sa ata të mund të vërtetojnë se janë viktimat të trafikimit.

Një zëdhënës i policisë e përshkroi paraburgimin e gruas si një "formë e butë arresti", duke pretenduar se një proces arrestimi formal do t'i traumatizonte ato me tej.¹⁵³ Megjithatë, NGO vendase i kanë raportuar Amnesty International se TPIU-ja dhe policë të tjerë ndërkombëtarë shpesh s'arrijnë t'i trajtojnë këto gra dhe vajza si viktimat të krimit, perkundraz, ata u janë referuar vajzave të trafikuar brenda si "prostituta".¹⁵⁴

Sipas "Procedura Standarde e Operimit" (SOP),¹⁵⁵ gratë e trafikuar nga jashtë intervistohen së pari nga TPIU-ja për të verifikuar nëse ato janë trafikuar. Në qoftë se një grua identifikohet si grua e trafikuar, TPIU-ja pastaj kontakton Pikën Fokale Rajonale të Trafikimit të OSCE-së,¹⁵⁶ e cila kryen një intervistë tjetër me gruan dhe merr vendimin nëse ajo duhet t'i referohet IOM-it. Nëse po, ajo çohet në Prishtinë për një intervistë tjetër për të verifikuar nëse është e përshtatshme për asistencën e IOM-it dhe nëse dëshiron të hyjë në programin e riatdhesimit të IOM-it. Siç vihet re më poshtë, nuk ka procedura të veçanta brenda SOP për fëmijët e trafikuar nga jashtë.

*"Ndonjëherë gruaja vendos [të riatdhesohet] menjëherë, por në raste të tjera ne duhet të rrimë nja ca orë për ta bindur atë."*¹⁵⁷

IOM-i kërkon të sigurohet që gratë janë pjesëmarrëse me dëshirë në programin e riatdhesimit dhe e kupton se ato do të çohen në strehëzën më të afërt dhe praktikisht do të paraburgosen deri në riatdhesim. IOM-i kishte kryer, që nga 2000, mbi 700 intervista përzgjedhëse, por vëzhguan

¹⁵³ Intervistë, Derek Chappell, tetor 2003; shih edhe, UNMIK-u-KFOR-i—UNHCR-ja-Udhëzime të Policisë së UNMIK-ut, 18 qershor 2001. Në postat rajonale të policisë, gratë mbahen në zyrat e TPIU-së; në pritje të konfirmimit për financim, një apartament i posaçëm ku gratë mund të intervistohen thuhet se është përgatitur në Prishtinë, Bisedë telefonike e AI me TPIU, mars 2004.

¹⁵⁴ Intervistë, Naime Sherife, CPWC, shtator 2003. NGO që punojnë me vajzat e trafikuar nga brenda gjithashtu kishin dyshime për teknikat hetimore të policisë.

¹⁵⁵ SOP është një marreveshje midis TPIU-së, OSCE-së, dhe IOM-it për rolet e tyre përkatëse dhe përgjegjësitë ndaj grave dhe vajzave të trafikuar nga jashtë.

¹⁵⁶ Pika Fokale Rajonale e Trafikimit është një nëpunës i të drejtave të njeriut brenda Divizionit të të Drejtave të Njeriut dhe Rendit të OSCE-së, e themeluar më 2001.

¹⁵⁷ Intervistë e AI me një pjesëtar të personelit të IOM-it, shtator 2003.

më 2003 se më pak gra dëshiruan të pranojnë shërbimet e tyre.¹⁵⁸

Disa gra nuk duan të riatdhesohen: disa kanë frike se duke u riatdhesuar nga IOM-i ato do të identifikohen shumë lehtë si viktimat të trafikimit kur të kthehen në shtëpi, duke pasur frikë nga hakmarrja e trafikuesve të tyre, nga familja ose komuniteti i tyre. Për gratë që nuk duan të hyjnë në programin e riatdhesimit, por duan të kthehen në vendin e tyre të lindjes, IOM-i siguron një mini-program të kufizuar, duke i asistuar gratë në marrjen e dokumenteve të nevojshme të udhëtimit.¹⁵⁹

Gratë e trafikuar që zgjedhin të mos e identifikojnë veten si viktimat të trafikimit, ose nuk mundet në kohën e intervistës të vendosin nëse duan të riatdhesohen, përjashtohen nga programi i asistencës i IOM-it ndonëse u jepet një numër telefoni për të marrë nëse ndërrojnë mendje. Ndonjë di spozi të është bërë tek strehëza Mjedi si i Sigurt i Përkohshëm (ISF, shih më poshtë) për gratë e trafikuar jashtë që nuk dëshirojnë menjëherë të riatdhesohen.

Për ato që s' mundin ose s' dëshirojnë të identifikohen si viktimat të trafikimit, ka pak mbrojtje, këshillim ose shërbime të tjera, qysh nga transferimi i klinikës shëndetësore ambulante të drejtuar nga Komiteti Metodist i Bashkuar për Ndihmë (UMCOR, shih më poshtë). Në qoftë se arrestohen, ato kanë pak shanse pas lirim të tyre, veç të kthehen në bare. Për shembull, TPIU-ja informoi Amnesty International për një grua që u dënua më katër muaj burgim për prostitucion.¹⁶⁰ Pas lirim të saj, ajo donte të kthehej në vendin e saj të lindjes, por nuk mund të merrte një pasaportë, as policia nuk kishte fuqi për ta dëbuar atë: *"Ajo është mbërthyer tani në një qark vicioz. Nuk ka mundësi për atë që të ike nga Kosova dhe ajo rri duke punuar në një bar. Nuk ka ambasada ose zyra të vendeve të tjera në Prishtinë, dhe ndonëse ka gjëra të tilla në Beograd, ato nuk lejohen të kalojnë kufirin me qëllim që të kontaktojnë ambasadat e tyre, pra ato veç kthehen prapë në bare."*¹⁶¹

¹⁵⁸ Kjo shifër përfshin intervista të përsëritura me gra të cilat ishin intervistuar në disa raste para se, më në fund, vendosën të hynin në programin e IOM-it.

¹⁵⁹ Asistencë e ngjashme është dhënë nga OSCE-ja.

¹⁶⁰ Ndonëse kjo grua kishte udhëtuar vullnetarisht për në Kosovë për të punuar si prostitutë, TPIU-ja, duke marrë parasysh rrethanat e saj, atë e identifikoi si grua të trafikuar.

¹⁶¹ Intervistë, Irina Cocos, Nënkryetare e TPIU-së; IOM-i e informoi gjithashtu Amnesty International për raste të grave të trafikuar të liruar nga Burgu i Lipjanit.



Amnesty International ka mjaft shqetësime rreth këtij procesi. Gratë i kryejnë intervistat nga policia dhe të tjerë në mjedise jofamiljare, shpesh pa ndonjë grua police të pranishme dhe pa ndonjë përfaqësues ligjor. Brenda disa orëve nga arrestimi i tyre, ato duhet të vendosin nëse do të hyjnë në një program riatdhësimi. Për më tepër, nuk ka procedura të veçanta për vajzat nën 18 vjeç. Gratë e trafikuar nga brenda intervistohen në mënyrë të ngjashme nga TPIU-ja dhe pastaj nga punonjësit e çështjes nga një NGO vendase, dhe pastaj i referohen një strehëze. Nga fundi i marsit 2004, nuk ishte rënë dakord ende për një Procedure Operimi Standarde për gratë dhe vajzat e trafikuar nga brenda.

Mbështetje dhe asistencë për vajzat

“Fëmijët që janë viktimë të trafikimit do të identifikohen si të tillë. Interesi i tyre më kryesor do të konsiderohet më i larti në çdo kohë. Fëmijëve viktimë të trafikimit do t’u jepet asistencë e përshtatshme dhe mbrojtje. Konsideratë e plotë do të kihet për dobësitë e tyre të veçanta, të drejtat dhe nevojat”. Parimi 10, Parimet dhe Udhëzimet e UNHCHR-së.

Standardet ndërkombëtare apelojnë ndaj atyre që njihen si të rritur për masa shpesh, që të mbrojnë të drejtat e fëmijëve që trafikohen dhe që të sigurojnë në përputhje me Nenin 3(1) të Konventës së Fëmijëve që *“Interesat më kryesorë të fëmijës do të jenë konsiderata primare”*.¹⁶²

Sipas ligjit të zbatuar, përgjegjësia për mbrojtjen e gjithë vajzave të trafikuar në Kosovë bie mbi PISG-un dhe, nëpërmjet tij, mbi Ministrinë e Punës dhe Asistencës Sociale.¹⁶³ Një marrëveshje model ekziston ndërmjet Ministrisë së Punës dhe Asistencës Sociale dhe strehëzave për mbrojtjen e fëmijës në Prishtinë dhe Prizren (shih më poshtë), e cila specifikon procedurat që duhen ndërmarrë dhe kriteret që duhen zbatuar në raste emergjente dhe në pranimet e planifikuara në këto strehëza.¹⁶⁴ Procedura të mëtejshme të zhvilluara më 2003 nga Ministria për të identifikuar dhe mbrojtur vajzat e trafikuar nga brenda, duke përfshirë disa fëmijë me të vërtetë të vegjël, nuk janë përcaktuar ende si duhet ose nuk janë plotësisht operacionale. Deri nga fillimi i 2003, vajzat e trafikuar nga brenda merreshin drejtpërdrejt nën kujdesin e CPWC-së. Procedurat e reja të inicjuara nga Departamenti i Asistencës Sociale, përfshinin caktimin e një punonjësi të çështjes dhe, ku ishte e nevojshme, një kujdestar ligjor për çdo fëmijë. U vendos një sistem shërbimi 24-orësh “në telefon”, në mënyrë që punonjësit socialë të mund të thirreshin në rajonet e policisë për të

¹⁶² Këto masa janë përcaktuar me hollësi në Udhëzimin 8 të Parimeve dhe Udhëzimeve të UNHCHR-së.

¹⁶³ Inset applicable law.

¹⁶⁴ Ministria e Punës dhe Asistencës Sociale, Kriteret pranimi për Strehëzat e Mbrojtjes së Fëmijëve në Prishtinë dhe Prizren, mars 2003.

kryer një vlerësim dhe për t’i referuar vajzat në një strehëz të përshtatshme.¹⁶⁵ Megjithatë, sipas TPIU-së dhe NGO-ve strehëz, punonjësit socialë nuk kanë qenë gjithnjë të disponueshëm, një pohim i pranuar nga Departamenti i Asistencës Sociale. Në disa raste, si përfundim, vajzat janë paraburgosur për një natë në rajonet e policisë, përfshirë edhe nëntorin 2002, kur mjaft vajza shqiptare kosovare u paraburgosen, madje pa u njoftuar prin dërit e tyre.¹⁶⁶ Organizata vëren se kapaciteti i Qendrave për Punë Sociale të rajonit (CSW)¹⁶⁷ për të trajtuar çështjet e vajzave të trafikuar është vënë në dyshim nga OSCE-ja.¹⁶⁸

Këto dispozita ende të kufizuara zbatohen vetëm për fëmijët e trafikuar nga brenda dhe nuk ka procedura të veçanta për vajzat e trafikuar nga jashtë brenda programit të IOM-it, siç rekomandohet nga Fondi i Fëmijëve i Kombeve të Bashkuara (UNICEF).¹⁶⁹

Strehëzat

Shtetet do të sigurojnë që personat e trafikuar të mbrohen nga shfrytëzimi i mëtejshëm dhe rreziku dhe të kenë mundësi për përkujdesje fizike dhe psikologjike të mjaftueshme. Kjo mbrojtje dhe përkujdesje nuk duhet të bëhet i kushtëzuar nga aftësia ose dëshira e personit të trafikuar për të bashkëpunuar në procedurat ligjore.” Paragrafi 8, Parimet dhe Udhëzimet e Rekomanduara të UNHCHR-së.

Në Kosovë është bërë një dispozitë, sipas Seksionit 10.1(c) të Rregullores së Trafikimit, për gratë e trafikuar, që të marrin strehim të sigurt të përkohshëm, kujdes psikologjik, mjekësor dhe social. Deri më qershor 2003, kjo sigurohej nga strehëzat e administruara në bashkëpunim me IOM-in, CPWC-në dhe NGO të tjera në Kosovë. Më qershor 2003, sipas një marrëveshjeje mes OSCE-në dhe UNMIK-un dhe në ndjekje të Rregullores, u hap Mjedisi i Sigurt i Përkohshëm (ISF) dhe administrohet nga Departamenti i Drejtësisë VAAU. Prej marsit 2004, ISF-ja u ka siguruar strehë 10 grave – të trafikuar si nga brenda dhe nga jashtë – duke përfshirë shtatë gra që ende duhet të

¹⁶⁵ Në secilin rast, TPIU-ja kreu një vlerësim të rrezikut, i cili u është dhënë strehëzave përkatëse.

¹⁶⁶ Informacion i marrë nga AI, nëntor 2002; intervistë e AI me personel të Departamentit të Shëndetit dhe Asistencës Sociale, shtator 2003.

¹⁶⁷ Ministria e Shëndetit dhe Asistencës Sociale dhe Qendrat për Punë Sociale (CSW) kaluan nën PISG-un.

¹⁶⁸ Departamenti i Drejtave të Njeriut dhe Rendit i OSCE-së, Kosovë. Raport për Qendrat për Punë Sociale, Shërbimet Sociale, Mars 2003, fq.5.

¹⁶⁹ Shih për shembull, Seksioni 3.2, Udhëzime për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve Viktimë të Trafikimit në Evropën Juglindore, UNICEF, maj 2003. AI vëren se IOM-i u takua me Kryetarin e Departamentit të Asistencës Sociale më shkurt 2004 për të diskutuar një Memorandum Marrëveshjeje, e-mail nga IOM-i Kosovë, mars 2004.



marrin një vendim nëse dëshirojnë të hyjnë në programin e riatdhesimit të IOM-it.¹⁷⁰

Ndonëse qëllimi i shpallur i ISF-së ishte të inkurajonte bashkëpunimin e viktimave të trafikimit me agjencitë e zbatimit të ligjit, duket se ky qëllim nuk është arritur ende. Prej marsit 2004, nga sa ka dijeni organizata, vetëm një grua është paraqitur në ISF kur po merrte një vendim për të dëshmuar apo jo. Përveç kësaj, meqenëse siguria e ISF-së u kompromentua nga policia ndërkombëtare brenda një jave nga hapja e saj, as TPIU-ja dhe as Njësia e Mbrojtjes së Dëshmitarit (WPU) e UNMIK-ut nuk e konsideron atë të përshtatshme për mbrojtjen e dëshmitarit.¹⁷¹

Shqetësime iu shprehën Amnesty International qoftë nga më pas manaxheri i ISF-së, ashtu dhe ente të tjera rreth standardit të mbështetjes, asistencës dhe pajisjes me personel tek ISF-ja, duke përfshirë mungesën e aftësive të duhura (përfshirë aftësitë gjuhësore) dhe përvojë në mes të personelit. Amnesty International është gjithashtu e preokupuar se ISF-ja duket se ka pak qartësi rreth rolit të saj, veçanërisht në lidhje me ente të tjera dhe në shumëfishimin sistemeve ekzistuese të saj të mbështetjes për gratë e trafikuar nga brenda.¹⁷²

Strehëzat për gratë e trafikuar nga jashtë

Nga shkurti 2000 një strehëz për gratë e trafikuar nga jashtë, të cilat pranuan të hyjnë në programin e IOM-it, u sigurua nga një NGO ndërkombëtare që punonte me personel vendas; më 2004 përgjegjësia për strehëzën e IOM-it ishte në proces duke u transferuar tek një NGO vendase, e pajisur me punonjës strehëze me përvojë. Strehëza u hap më shkurt 2000 dhe punoi më pas me më shumë se 300 gra dhe vajza të trafikuar.

Strehëza siguron ushqim, strehim, mbështetje mjekësore, këshillim dhe një sërë aktivitete edukative e aktivitete të tjera. Organika përfshin punonjës socialë, personel mjekësor dhe një infermiere psikiatrie. Mundësohet mjekim për gra me infeksione seksualisht të transmetueshme, por jo analiza. Analiza për HIV/AIDS nuk mundësohet. Para se të ikin nga Kosova, grave u jepet një librezë e shënimeve mjekësore dhe dosja e çështjes së tyre i përcillet organizatave partnere të IOM-it në vendin

¹⁷⁰ Të paktën dy gra kishin vendosur, pas pak ditësh, që të riatdesheshin nga IOM-i; të tjerat ikën, një raportohet se u kthye në barin ku kishte punuar; personeli i ISF-së parashikon që gratë mund të qëndrojnë për një periudhë maksimale prej një muaji para se të marrin një vendim, Intervistë e AI me manaxherin e ISF-së, shtator 2003; e-mail nga personeli i IOM-it, mars 2004.

¹⁷¹ Intervistë e AI me Ish-kryetarin e ISF-së, shtator 2003.

¹⁷² ISF-ja më shtator 2003 kishte strehuar tashmë një viktimë të abuzimit seksual në familje.

pritës, ku gruaja pritet të vazhdojë me programin e riintegrit.¹⁷³

Gjetkë në rajon, IOM-i është kritikuar se përdor një metodë e cila, në vend që t'i fuqizojë gratë e trafikuar, përforcon statusin e tyre si "viktima".¹⁷⁴ Megjithatë, ndonëse Amnesty International e pranon këtë shqetësim, po ashtu pohon aftësinë, kujdesin dhe angazhimin me të cilin gratë dhe vajzat e trafikuar mbështeten nga IOM-i dhe NGO-të e saj partnere.¹⁷⁵

Strehëzat për gratë dhe vajzat e trafikuar nga brenda

Grave të trafikuar nga brenda u është ofruar strehëz nga CPWC-ja qysh nga 2000.¹⁷⁶ Pas këshillimit fillestar, pas këshillimit mjekësor dhe ligjor, CPWC-ja kontakton organizata të tjera, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetit dhe Asistencës Sociale, për të ndihmuar ato që duan të riintegrohen prapë në familjen e tyre. Për shkak të nocionit të fortë të turpit në kulturën shqiptare, ky proces mund të jetë i gjatë dhe i vështirë.¹⁷⁷ Ministria ka nisur së fundi të rekrutojë dhe trajnojë familjet për të përkrahur vajzat e trafikuar familjet e të cilave nuk duan që ato të kthehen.

Në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, CPWC-ja i pajis vajzat me arsim, duke përfshirë mësimin e shkrimit e leximit, duke organizuar regjistrime në shkollë ose duke bërë marrëveshje për të dhënë provimet privatisht. Mundësohen teste dhe mjekime për infeksionet seksualisht të transmetueshme. CPWC-ja gjithashtu drejton një pikë shërbimi urgjence për gratë e trafikuar.

Vajzat e trafikuar nga brenda që konsiderohen se janë me rrezik të ulët riviktimizimi, strehohen në dy strehëza të

¹⁷³ Një vlerësim i efektivitetit të riintegrit të grave nga Kosova ishte jashtë qëllimit të këtij projekti për kthim. Megjithatë, janë ngritur shqetësime se pak gra marrin mbështetje afatgjatë dhe shumë janë rrituar, shih për shembull, UNICEF, UNOHCHR, OSCE/ODIHR, *Trafikimi i Qenieve Njerëzore në Evropën Juglindore, 2003 Azhornim mbi Situatën dhe Përgjigjet ndaj Trafikimit të Qenieve Njerëzore*, nëntor 2003, fq. 197-8.

¹⁷⁴ Kvinna Till Kvinna dhe Stiftelsen Kvinnoforum për Sida (Agjencia Suedeze e Zhvillimit të Bashkëpunimit Ndërkombëtar) Programi Rajonal Kundër Trafikimit në Ballkan i IOM-it, shih, për shembull, fq. 102-5.

¹⁷⁵ Gratë e trafikuar nga sa flitet e lidhin programin e IOM-it me stigmatizimin, kriminalizimin, riviktimizimin – nëpërmjet paraburgimit, mohimit të lirisë së lëvizjes nëpër strehëza, pyetjeve ndërhyrëse dhe personale dhe ekzaminimit mjekësor "i aftë për udhëtim", -mungesës së mbrojtjes afatgjatë dhe çdo mundësie reale për të ardhmen, *Trafikimi i Qenieve Njerëzore në Evropën Juglindore, 2003 Azhornim*, fq. 197-8. Shih edhe Sida, Programi Rajonal Kundër Trafikimit në Ballkan i IOM-it, fq. 83-6 & 105.

¹⁷⁶ CPWC-ja ka ndihmuar gjithashtu një numër grash të trafikuar nga jashtë.

¹⁷⁷ Një grua, sjellja e së cilës është "shameful" (e turpshme) nuk preket vetëm individualisht, por nëpërmjet perceptimit të fortë të përgjegjësisë familjare, edhe familja e saj është 'me marre' ose 'e shndëruar'.



hapura të mbrojtjes së fëmijëve, me një raport të lartë personeli për fëmijët, një në Prishtinë dhe një tjetër në Prizren. Shërbime këshillimi sigurohen nga personeli i NGO-ve vendase, duke përfshirë CPWC-në, dhe një psikolog klinike vullnetar. Personeli bashkëpunon me IOM-in për trajtimin mjekësor dhe këshillimin dhe me CPWC-në rreth rasteve me rrezik të lartë dhe të mesmë. Një kujdestar ligjor është caktuar për çdo fëmijë, dhe një punë me çështjen është planifikuar për të siguruar që, në përputhje me standardet ndërkombëtare, interesat kryesorë të fëmijës të jenë konsideratë parësore.

¹⁷⁸ Këto dispozita nuk janë shtrirë ende tek vajzat e trafikuar nga jashtë, ndonëse sipas ligjit të zbatuar, PISG-ja është përfundimisht përgjegjëse për mirëqenien dhe mbrojtjen e gjithë fëmijëve në Kosovë.

Vajzat dhe grate e rritura në rrezik mesatar ose të lartë sigurohen gjithashtu me strehim të sigurt në strehëz nga CPWC; NGO të tjera vendase drejtojnë strehëza në Gjakovë/Đakovica dhe Peja/Pec. ¹⁷⁹

Siguria e strehëzave

Përgjegjësia për mbrojtjen e grave të trafikuar nga jashtë, ndërsa ato qëndrojnë në Kosovë, bien mbi TPIU-në dhe policinë tjetër, dhe mbi NGO-të partnere të IOM-it të cilat drejtojnë strehëzën e IOM-it. Kjo strehëz ka mbetur e sigurt duke ndërruar rregullisht vend..

CPWC-ja është jashtëzakonisht e shqetësuar rreth sigurisë së grave nën kujdesin e tyre. Një vjedhje me thyerje ndodhi në zyrën e CPWC-së (jo në strehëz) më 4 janar 2003, në të cilën pesë hard disqe kompjuteri, që përmbanin të dhëna konfidenciale dhe dëshmi të grave dhe vajzave të trafikuar, dhe viktimave të tjera të dhunës kundër grave, u vodhën; nuk u morën pajisje të tjera me vlerë. Ndonëse policia e patrolloi zonën 24 orët e mëpasme, personeli i strehëzës i foli Amnesty International për shqetësimin e tyre se UNMIK-u s'kishte arritur të pranonte kërcënimin ndaj sigurisë së grave- duke përfshirë viktimat e trafikimit- dëshmitë e regjistruara të të cilave ishin vjedhur. Në përgjigje të kritikave për mungesën e përparimit nga policia në identifikimin e shkaktarëve dhe në kthimin e informacionit të vjedhur, një zëdhënës shtypi i policisë thuhet se deklaroi, "Ne patrulluam 24 orë në ditë në qytet para dhe pas incidentit dhe përipiqemi të bëjmë maksimumin për të parandaluar krime të tilla -por ne nuk

¹⁷⁸ Nenet 3.1 dhe Neni 12 i Konventës së Fëmijëve kërkon që pikëpamjet e fëmijës të tërhiqen dhe të respektohen.

¹⁷⁹ Strehimi i përkohshëm shpesh duhet të sigurohet nga azilet për viktimat e dhunës në familje; një punonjës në një nga këto strehëza i foli Amnesty International për vështirësitë që ata kanë provuar duke u siguruar mbështetje dhe shërbime grave dhe vajzave me kaq nevoja të ndryshme dhe të veçanta, , Intervistë e AI me personelin tek Shtëpia e Sigurt e Gruas, Gjakovë/Đakovica, nëntor 2002.

jemi roja sigurimi për bizneset private" [nënvizim i AI].¹⁸⁰

Me përjashtim të një incidenti, në të cilin një punonjës social they procedurën duke çuar familjen e vajzës së trafikuar në strehëz, siguria e dy strehëzave të hapura për rrezik të ulët të grave të trafikuar nga brenda nuk është kompromentuar ende. Siç është shënuar më lart, siguria e ISF-së u kompromentua nga policia ndërkombëtare brenda pak javësh nga hapja e saj.

E drejta për mbrojtje ndërkombëtare

"Kthim (dhe, sa është e mundur, vullnetar) i sigurt duhet t'u garantohet personave të trafikuar si nga shteti pritës, edhe nga shteti i origjinës. Personave të trafikuar duhet t'u ofrohen alternativa ligjore ndaj riatdhesimit, në rastet ku është e drejtë të arrihet në përfundimin se ky riatdhesim do të paraqiste një rrezik serioz për sigurinë e tyre dhe/ose për sigurinë e familjeve të tyre." Paragrafi 11, UNHCHR Parimet dhe Udhëzimet e Rekomanduara.

Shumë gra dhe vajza ndeshin një rrezik real nga frikësimi, detyrimi, kërcënimet ose dhuna e mëtejshme për veten ose pjesëtarë të familjeve të tyre, duke përfshirë rrezikun e ritrafikimit pas kthimit në vendin e tyre amtar. Komisioni i Lartë për Refugjatët i Kombeve të Bashkuara (UNHCR) pranon se, në disa rrethana një grua e trafikuar mund të jete e aftë të mbështetë një kërkesë për statusin e refugjatit, mbi bazën e përvojës së saj të trafikimit dhe rreziqeve që ajo has për pasojë.¹⁸¹

Për shkak të brishtësisë së veçantë të grave të trafikuar si në vendin e tyre të destinacionit, ashtu dhe në vendin e tyre të origjinës, në përputhje me standardet e zbatueshme në regjimin ndërkombëtar të mbrojtjes së refugjatit, Amnesty International nënvizon se, duhet të jetë një detyrim nga ana e autoriteteve që të verifikojnë dhe vlerësojnë çdo kërkesë për mbrojtje dhe ta peshojnë këtë rrezik, ku një grua e trafikuar shpreh një dëshirë për të mos u kthyer në vendin e saj të origjinës.¹⁸² Në të tilla rrethana, në qoftë se ajo konsiderohet me të drejtë për mbrojtje ndërkombëtare, duhet të ketë gjithashtu një përgjegjësi për ta ndihmuar në gjetjen e zgjidhjeve të përshtatshme afatgjata. Në veçanti, duhet pranuar se integrimi lokal në Kosovë (ku ajo mund të ketë kaq frikë sa

¹⁸⁰ Intervistë me Sevdie Ahmeti, CPWC, mars dhe shtator 2003; Shih edhe "Viktimat kosovare të abuzimit në rrezik", Raporti i Krizës Ballkanike, No. 403, 3 shkurt 2003.

¹⁸¹ Shih paragrafin 18, UNHCR Udhëzime për Mbrojtjen Ndërkombëtare: Perspektivi i Lidhur me Gjirinë brenda onteksit të Neni 1a(2) të Konventës së 1951-shtit dhe/ose Protokollit të saj të 1967-ës që lidhet me Statusin e Refugjatëve, HCR/GIP/02/01, 7 maj 2002.

¹⁸² Shih Paragrafin 196, UNHCR Manual mbi Procedurat dhe Kriteret për Përcaktimin e Statusit të Refugjatit sipas Konventës 1951 dhe Protokollit 1967 lidhur me Statusin e Refugjatëve HCR/IP/4/Eng/REV.1 Ribotim, Gjenevë, janar 1992, UNHCR 1979



ka dhe po të kthehet në vendin e saj të origjinës) mund të mos jetë frytdhënës dhe rivendosja në një vend të tretë mund të jetë alternativa e vetme më e mundshme).¹⁸³

Amnesty International vëren gjithshu lidhur me këtë se, parimi që asnjëri nuk duhet të kthehet në një vend ku ai rrezikohet nga abuzime serioze të të drejtave të njeriut (parimi i *non-refoulement*) mund të zbatohet jo vetëm sipas Konventës në Lidhje me Statusin e Refugjatëve e 1951-shit dhe Protokollit të saj përkatës të 1967-s, por gjithashtu të Neneve 3 si të EHCR-se, ashtu dhe Konventës Evropiane kundër Torturës, përkatësisht. Parimet dhe Udhëzimet e Rekomanduara e UNHCHR-së nënvizojnë më tej se parimet e përgjithshme të ligjit për të drejtat e njeriut mund të parashikojnë për mbrojtje nga dëbimi i shpejtë ose kthim kur ka shkak të arsyeshem për të kryer atë dëbim, ose kthimi do të paraqiste një rrezik të madh ndaj sigurisë së personit dhe/ose familjes së asaj/atij”.¹⁸⁴ Këto parime pasqyrohen në Rregulloren e Trafikimit.

Amnesty International përshëndet nënshkrimin më dhjetor 2002, nga Nënkrjetari i SRSG-së, në emër të Kosovës, i Deklaratës së Angazhimeve për të Legalizuar Statusin e Personave të Trafikuar (Deklarata e Tiranës). Duke bërë këtë, autoritetet e Kosovës ranë dakord t’i japin rezidencë të përkohshme viktimave të trafikimit nga jashtë për tri muaj ose më shumë.¹⁸⁵ Megjithatë, organizata nuk është ende në dijeni nëse janë futur mekanizmat formalë për ta zbatuar këtë.

Ndërsa shikojmë se zgjidhjet afatgjata mund të jenë problematike si për gratë e trafikuar nga brenda dhe ato nga jashtë, zgjidhje të tilla janë thelbësore për të siguruar që mbrojtja e të drejtave të tyre njerëzore është efektive. Gratë e trafikuar nga jashtë nevojitet të jenë të afta të arrijnë zgjidhjet që marrin plotësisht parasysh brishtësinë e tyre të veçantë, të paktën si dëshmitarë kryesorë dhe shpesh të pambrojtur mjaftueshëm të krimin të organizuar ndërshtetëror. Kërkimet në 10 shtete anëtare të UE-së nga Kundër Skllavërisë Ndërkombëtare kanë treguar se, në qoftë se viktimat e trafikimit kanë të drejtë të rrinë në vendin e destinacionit, përkohësisht ose vazhdimisht, dhe marrin shërbimet e duhura, nivelet e

¹⁸³ Shih edhe Seksionin 12.1 për Rregulloren e Trafikimit.

¹⁸⁴ UNHCHR Parimet dhe Udhëzimet e Rekomanduara 4, paragrafi 6, të cilët gjithashtu u kërkojnë shteteve të marrin në konsideratë mundësimin që mbrojtja e personave të trafikuar të ngrihet mbi bazën e legjislacionit të antitrafikimit.

¹⁸⁵ Marrëveshja u nënshkrua në Forumin e Tretë Rajonal Ministror nga Ministrat e Shqipërisë, Bosnjë-Hercegovinës, Bullgarisë, Kroacisë, Hungarisë, Maqedonisë, Moldavisë, Turqisë dhe Serbisë e Malit të Zi. (më vonë FR Jugosllavia), 11 dhjetor 2002.

dënimin të trafikanteve janë më të larta.¹⁸⁶

Megjithatë, kritikant për programin e rezidencës së përkohshme në Belgjikë, Itali dhe Vendet e Ulta sugjerojnë që mbrojtja e duhur, duke përfshirë mbrojtjen e dëshmitarit, mungon në këto shtete.¹⁸⁷ Amnesty International mendon se, me qëllim që të përbalim problemin e trafikimit në një mënyrë efektive, është e nevojshme të hapen zgjidhje afatgjata të, jo vetëm integritit lokal dhe riatdhesimit vullnetar me masa efektive riintegrimi, por gjithashtu dhe mundësi të rivendosjes në një vend të tretë, kur është e nevojshme. Aktualisht nuk ka kuadër ligjor për gratë e trafikuar nga jashtë, që të kërkojnë shtetësinë ose rezidencën në Kosovë. Në lidhje me integrimin social, edhe në qoftë se ato lejohen të qëndrojnë, mund të rezultojnë jashtëzakonisht të vështirë për gra nga, për shembull, Evropa Lindore për t’u integruar në komunitetin e Kosovës, kryesisht shqiptar, ku minoritetet, duke përfshirë serbët, vazhdojnë të hasin diskriminim dhe dhunë me motive etnike. Në të njëjtën mënyrë, mund të jetë e pamundur për disa gra të trafikuar nga brenda të integrohen në komunitetet e tyre të ngushta dhe se, pa mbrojtjen e familjeve të tyre dhe komunitetit, disa mund të kuptojnë se janë përsëri të pambrojtura ndaj ritrafikimit. Për këtë arsye, garantimi i mbrojtjes në një vend të tretë si një zgjidhje afatgjatë për personat e trafikuar nga brenda mund gjithashtu, në disa rrethana, të jetë i nevojshëm për të siguruar mbrojtje efektive.

Për këtë arsye Amnesty International rekomandon marrjen në konsideratë të mbrojtjes afatgjatë, mundësisht në vende të treta, si për viktimat e trafikuar nga jashtë ashtu dhe nga brenda, që janë në rrezik në vendet e tyre amtare dhe në nevojë për mbrojtje të vazhdueshme.

Kapitulli 5: Aksesi në Drejtësi

Shumë pak gra të trafikuar në Kosovë kanë mundësi të fitojnë akses në Drejtësi, duke përfshirë të drejtën për të kërkuara zhdëmtim nëpërmjet sistemit të drejtësisë

¹⁸⁶ Elaine Pearson, *Trafiku Njerëzor, Të Drejtat e Njeriut duke Ripërkufizuar Mbrojtjen e Viktimës*, Anti-Slavery International, 2002, fq. 4-5, 35-62.

¹⁸⁷ Shumë gra thuhet se i lënë programet për mbrojtjen e dëshmitarit, sepse ato janë efektivisht të burgosura në strehëza ose ato që jetojnë në strehëza më të hapura, janë të pambrojtura ndaj frikësimit nga trafikuesit e tyre. Të tjera ndeshin diskriminim të mëtejshëm duke kërkuar punë, shërbime sociale ose shërbime të tjera. Komisioni i Komuniteteve Evropiane, *DG Drejtësia dhe Çështjet e Brendshme, Kërkime të bazuara në raste studimore për trafikimin e qenieve njerëzore në 3 shtete anëtare të EU*, që janë: Belgjika, Italia dhe Vendet e Ulta,

Hippokrates JAI/2001/HIP/023. Shih dhe, Vendimi Kuadër i Këshillit për Luftën Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, 22 janar 2001; Direktiva e Këshillit të EU për Lëshimin e Lejes së Rezidencës Afatshkurtër Viktimave të Aksionit për të Lehtësuar Emigracionin Ilegal ose Trafikimin e Qenieve Njerëzore të cilat Bashkëpunojnë me Autoritet Kompetente, Bruksel, 11 shkurt 2002.



penale. Deri më sot asnjë grua e trafikuar nuk ka mundur të marrë dëmshpërblim për dëmin që ka pësuar si rezultat i shkeljeve të të drejtave të saj ngrëzore.

Mungesa e asistencës ligjore

“Asistenca ligjore dhe të tjera duhet t’u jepen personave të trafikuar për gjithë kohëzgjatjen e ndonjë veprimi penal, civil ose tjetër kundër trafikantëve të dyshuar.”
Parimi 9, UNHCHR Parimet dhe Udhëzimet.

Sipas ligjit të zbatuar në Kosovë, një palë e dëmtuar ka të drejtë për përfaqësim ligjor në të gjitha shkallët e çdo procesi penal.¹⁸⁸ Seksioni 10.1(b) i Rregullors së Trafikimit parashikon “këshillim ligjor falas në lidhje me çështje trafikimi (penale ose civile)”, dhe shpall se nëpunësit e zbatimit të ligjit duhet ta informojnë viktimën për këtë dhe të drejta të tjera.¹⁸⁹

Megjithatë, viktimat e trafikimit as nuk janë informuar për të drejtën e tyre për asistencë ligjore gjatë arrestimit, as u është dhënë mundësia për një avokat dhe, ndonëse NGO-të vendase kanë angazhuar avokatë për gratë e trafikuar nga brenda në raste të veçanta, gratë e trafikuar nga jashtë kufijve që dëshmojnë në proceset hetimore nuk janë pajisur me një avokat.¹⁹⁰ Në një proces të ndjekur nga Amnesty International, ndërsa një vajzë e trafikuar nga brenda asistohet nga një punonjës social dhe organizata vëzhgoi se punonjësi social, prokurori dhe gjykatësi e trajtonin dëshmitaren me ndjeshmëri, binte në sy mungesa e çdo lloj përfaqësuesi ligjor për dëshmitarin.

Mundësia për një avokat është themelore për të siguruar që, qysh në fillim, gratë të informohen rreth të drejtave të tyre dhe implikimet e bërjes së deklaratave që mund të përdoren në procese.

Avokata e Viktimave dhe Njësia e Asistencës e Departamentit të Drejtësisë (VAAU) e informoi Amnesty International më shtator 2003 se grave të trafikuar do t’u sigurohet këshillim ligjor nga Avokatët e Viktimës (VA), i themeluar brenda Departamentit të Drejtësisë VAAU. Deri më mars 2004, VA e ka siguruar këtë asistencë në 24 raste trafikimi.¹⁹¹ Megjithatë, këta Avokatë të Viktimës nuk janë avokatë të kualifikuar, as specialistë të trafikimit dhe, sipas koordinatorit të VA, roli i tyre është kryesisht ai i referimit, duke përfshirë asistencën për të fituar akses në drejtësi.¹⁹² Për këtë arsye, Amnesty International

¹⁸⁸ Neni 59 i Kodit të Procedurës Penale, *Sluzbeni List SFRJ*, No. 4, 14 janar 1977.

¹⁸⁹ Seksioni 10 (b).

¹⁹⁰ IOM-i e përshkruan informacionin e dhënë grave të trafikuar si këshillim ligjor, por ata nuk i pajisin gratë me akses tek një avokat, Intervistë e AI me IOM-in, shtator 2003.

¹⁹¹ E-mail AI nga Sebiha Mexhuani, OSCE, mars 2004.

¹⁹² Intervistë e AI me Judith Lavois, Koordinator i VA, tetor 2003.

konsideron se kjo dispozitë vazhdon të mohojë grave të drejtën e tyre për një avokat.

E drejta për mbrojtjen e dëshmitarit

“Shtetet duhet t’u sigurojnë mbrojtje dhe leje rezidence të përkohshme viktimave dhe dëshmitarëve gjatë proceseve ligjore”. Parimi 8, UNHCHR Parimet dhe Udhëzimet

Konventa e UN-it kundër krimit të organizuar ndërshtetëror¹⁹³ i kërkon shtetit “të marrë masat e duhura, brenda mundësive të tij, për të siguruar mbrojtje efektive nga hakmarrja ose frikësimi ndaj dëshmitarëve në proceset penale të cilët dëshmojnë lidhur me shkeljet e mbuluara nga kjo Konventë dhe, në mënyrë të përshtatshme, për të afërmit e tyre dhe persona të tjerë afër tyre.”

Më 1999, Asambleja e Përgjithshme e UN-it i ftoi qeveritë “të ndërmerrnin hapa, duke përfshirë masa/programe të mbrojtjes së dëshmitarit, për t’i aftësuar gratë që janë viktime të trafikimit t’i ankohen policisë dhe të jenë në dispozicion kur kërkohet nga sistemi i drejtësisë penale, dhe të sigurojë që gjatë kësaj kohe gratë të kenë mundësi për asistencë sociale, mjekësore, financiare dhe ligjore, dhe mbrojtje”.¹⁹⁴

Të gjithë viktimat e trafikimit, pavarësisht nga pjesëmarrja e tyre në proceset ligjore, gëzojnë mbrojtje. Gratë që vendosin të dëshmojnë si dëshmitare kundër trafikantëve mund të kërkojnë masa më të rrepta. Masat për të siguruar mbrojtjen e tyre nevojiten para proceseve, gjatë gjyqit dhe kur një person i dënuar është liruar në apel, deri sa të gjitha procedurat e mëtejshme të jenë përfunduar. Edhe atëherë, vëmendje duhet t’i kushtohet gjithashtu nevojave të mëtejshme për mbrojtje.¹⁹⁵

Pavarësisht nga dispozitat për mbrojtjen e dëshmitarëve të hartuara në Rregulloren e Trafikimit,¹⁹⁶ deri më shtator 2003 Amnesty International ka gjetur pak prova se – me disa përjashtime – masa të rregullta ishin marrë për t’u siguruar mbrojtje grave të trafikuar që dëshironin të dëshmonin në gjyq.

¹⁹³ Neni 24.1.

¹⁹⁴ UN GA Rezoluta 53/116 e 1 shkurtit 1999.

¹⁹⁵ Shih edhe dispozitat e Deklaratës së Parimeve Bazë të Drejtësisë për Viktimat e Krimit dhe Abuzimit me Forcën (A/RES/40/34), e UN-it, 29 nëntor 1985; Rekomandimet për Pozitën e Viktimës në Kuadrin e Ligjit dhe Procedurës Penale (1985) e CoE, (Rekomandimi R (85) 11 i Komitetit Ministror; Rekomandimet Rec. (2002) 5 e Komitetit Ministror për Shtetet Anëtare mbi mbrojtjen e gruas ndaj dhunës, adoptuar më 30 prill 2002 dhe Memorandumi Shpjegues; dhe Neni 68 i Statutit të Romës.

¹⁹⁶ Shih Seksionin 5.2 dhe Seksionin 7.4.



Mbrojtja e dëshmitarit - ligji

“Aftësia për të ndjekur me sukses rastet e trafikimit, kur ju nuk mund t’u jepni siguri dëshmitarëve, është thujtë zero.”¹⁹⁷

Mbrojtja e grave që janë përgatitur të veprojnë si dëshmitare kërkohet nga Seksioni 5.2 i Rregullores së Trafikimit dhe, ndonëse nuk përcaktohet shprehimisht në rregullore, mund të sigurohet nëpërmjet gjykatave ose, në një skemë të ndarë, nëpërmjet Njësisë së Mbrojtjes së Dëshmitarit (WPU).

Sipas Rregullores së UNMIK-ut 2001/20, *Për mbrojtjen e palëve të dëmtuara dhe dëshmitarëve në proceset penale*, prokurorët publikë, këshilli i mbrojtjes, palët e dëmtuara ose dëshmitarët mund të bëjnë kërkesë për masë mbrojtëse ose një procedurë anonimati.¹⁹⁸ Sipas kësaj Rregulloreje, masat mbrojtëse përfshijnë: “mospërmendjen ose fshirjen e emrave, adresave, vendit të punës, profesionit ose çfarëdo të dhënash të tjera, ose informacioni që do të mund të përdorej për të identifikuar palën e dëmtuar ose dëshmitarin”; “dëshminë pas një ekrani opak, nëpërmjet pajisjeve që ndryshojnë zërin, ose pyetje e njëkohshme në një vend tjetër që i komunikohet sallës së gjyqit nëpërmjet televizionit me qark të mbyllur, ose pyetje me kasetë video e dëshmitarit të palës së dëmtuar para seancës dëgjimore me avokatin mbrojtës të pranishëm,”; dhënia e një emri të rremë; mbyllja e seancave për publikun; duke e urdhëruar mbrojtjen të mos e zbulojë identitetin; dhe duke urdhëruar largimin e përkohshëm të të akuzuarit nga salla e gjyqit, në qoftë se dëshmitari “refuzon të dëshmojë në praninë e të akuzuarit ose po që se rrethanat i tregojnë Trupit Gjyqësor se dëshmitari nuk do të thotë të vërtetën në praninë e të akuzuarit”.

Në qoftë se masat janë të pamjaftueshme, atëherë “trupit gjyqësor mund të urdhërojë në rrethana të jashtëzakonshme që pala e dëmtuar ose dëshmitari do të mbetet anonim për të akuzuarin dhe avokatin mbrojtës. Duke dhënë këtë vendim, Trupi Gjyqësor do ta drejtojë seancën dëgjimore në një seancë me dyer të mbyllura që përfshin vetëm prokurorin publik, trupin gjyqësor kryesor, personelin e akuzës dhe dëshmitarin ose palën e dëmtuar”.¹⁹⁹

Amnesty International i njej këto masa të përgjithshme për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe e pranon se masa të tilla janë futur për shkak të brishtësisë së jashtëzakonshme të dëshmitarëve të trafikimit dhe rasteve të tjera serioze, veçanërisht në juridiksione si Kosova, ku rendi nuk është vendosur mirë. Megjithatë, organizata kërkon që, në zbatimin e tyre, dispozita të tilla nuk duhet të lejohet që

¹⁹⁷ Intervistë e Amnesty International me një prokuror ndërkombëtar, mars 2003.

¹⁹⁸ Seksioni 3.1.

¹⁹⁹ Seksioni 4.2. Dispozita të ngjashme janë bërë për mbrojtjen e dëshmitarëve sipas Seksionit 4.1.

të parajkykojnë të drejtën e të akuzuarit për një gjykim të drejtë, siç garantohet sipas Nenit 14 të ICCPR-së.²⁰⁰

Në rrethana të tilla, çështja për të marre parasysh masa të veçanta për mbrojtjen e dëshmitarit, duke përfshirë për shembull rivendosjen në një vend të tretë, mund të jete madje më bindëse.

Amnesty International është e preokupuar se grave të trafikuar nga jashtë rralë u është garantuar kjo mbrojtje. Vetëm me këmbënguljen e disa prokurorëve ndërkombëtarë janë përdorur këto masa. Për më tepër, NGO vendase i raportuan Amnesty International se ato nuk ishin në dijeni për ndonjë gjyq që përfshinte viktime të trafikuar nga brenda dhe prokurorë dhe gjyqtarë vendas në të cilin këto masa të jenë marrë. Organizata kundër trafikimit gjithashtu i raportuan Amnesty International se as gjyqtarët dhe as prokurorët nuk i kanë informuar rregullisht gratë e trafikuar për të drejtat e tyre për mbrojtje dhe masat në dispozicion, siç atyre u kërkohet të bëjnë sipas Seksionit 3.1 të Rregullores 2001/20.²⁰¹

Mbrojtja e dëshmitarit

Një prokuror ndërkombëtar në Kosovë i tha Amnesty International, *“Ju nuk mund ta imagjinoni shkallën e kërcënimit që ekziston, sepse ajo nuk ekziston në një vend Perëndimor”.*

Më qershor 2001 policia e UNMIK-ut themeloi Njësinë e Mbrojtjes së Dëshmitarit (WPU).²⁰² Megjithatë, shtrëngesat financiare e kanë kufizuar WPU-në vetëm për raste krimesh të rënda lufte dhe për raste politike të nivelit të lartë. Njësia ka aftësi të sigurojë mbrojtje për pesë dëshmitarë dhe familjet e tyre të afërta në çdo kohë.

WPU-ja është përfshirë vetëm në një rast trafikimi deri më shtator 2003, duke e pajisur dëshmitarin me një vend të sigurt për të jetuar dhe duke e shoqëruar atë në gjykatë. Në një tjetër rast me rrezikshmëri të lartë, WPU-ja u përgatit të siguronte mbrojtje për një grua që dëshironte të kthehej nga vendi i saj amtar për të dëshmuar, por ky rast nuk

²⁰⁰ Shih edhe Nenin 68.5 të Statutit të Romës “Kur dhënia i dëshmisë ose informacioni vijues në zbatim të këtij Statuti, mund të çojë në vënie në rrezik të madh të sigurisë së dëshmitarit ose atij, ose familjes së tij, Prokurori mund, për shkak të çdo procedure të kryer para fillimit të gjyqit, ta ndalojë këtë dëshmi ose informacion dhe në vend të kësaj të paraqitë një përmbledhje. Masa të tilla do të merren në mënyrë që të mos dëmtojnë ose të jenë të papajftueshme me të drejtat e të akuzuarit dhe me një gjyq të ndershëm e të paanshëm.”

²⁰¹ Intervistë e Amnesty International me Sevdie Ahmeti CPWC, shtator 2003. Dispozita të ngjashme janë bërë në Nenin 168-174 të Kapitullit XXI: Mbrojtja e Palëve të Dëmtuara dhe Dëshmitarëve, Kodi i Përkohshëm i Procedurave Penale të Kosovës, Rregullorja e UNMIK-ut 2003/26, 6 korrik 2003.

²⁰² Departamenti i të Drejtave të Njeriut dhe Rendit i OMIK-ut, *Kosovë Vështrim i Sistemit të Drejtësisë Penale (mars 2002 - prill 2003)* “Mbrojtja e Dëshmitarit në Sistemin e Drejtësisë Penale”, fq.12



shkoi në gjyq.²⁰³ Më shtator 2003 ishin bërë gjithashtu përgatitje në një rast tjetër.

Për shkak të paaftësisë së WPU për të strehuar numrin e dëshmitarëve të kërkuar nga prokurorët në raste që përfshijnë krime të tjera të rënda dhe papërshtatshmërisë së strehimit të viktimave të trafikimit bashkë me dëshmitarë të tjerë, më 2003 WPU-ja dhe TPIU-ja së bashku i përgatitën një kërkesë për financim PISG Ministrisë së Financës për një mjedis të veçantë për të strehuar vitimat e trafikimit të përgatitura për të dëshmuar. Duke parë rreziqet e atyre që dëshmojnë dhe pamjaftueshmërinë e masava aktuale, Amnesty International e mbështet këtë iniciativë.

Pak gra të trafikuar kanë dashur të dëshmojnë në procese sipas Rregullores së Trafikimit. Shumica e atyre që kanë dëshmuar kanë marrë pjesë në fazën hetimore dhe pak jane paraqitur në gjyq gjatë fazës së gjykimit. Raportohet se kercënime mund të ndodhin në çdo fazë midis hetimit policor dhe gjykimit të plotë ose pas procesit dhe gratë mund ta tërheqin pëlqimin e tyre për të marrë pjesë në çdo kohë.

Nevoja për mbrojtjen e dëshmitarit

Shkalla e ulët e dënimeve në rastet e trafikimit i është atribuar nga Departamenti i Drejtësisë i TPIU-së mungesës së viktimës-dëshmitarit gjatë proceseve gjyqësore. Ende pa mbrojtjen e mjaftueshme të dëshmitarit, shumë nga ata që janë përgatitur të marrin pjesë në gjyq u janë nënshtruar të tilla kërcënimeve para gjyqit sa ata ose e ndërruan deklaratën e tyre, ose vendosën të mos dëshmojnë.

Më 2001, për një periudhë rreth tri muaj, tre persona u arrestuan në dy raste gjatë hetimeve të policisë për përfshirjen e tyre të pandehur në trafikim. Ata u liruan në të dyja rastet mbi bazën e dëshmitëve të pamjaftueshme, pavarësisht nga deklaratat e dëshmisë nga disa gra të huaja të bëra hetuesve të policisë, se ato ishin trafikuar nga të dyshuar në Kosovë. Sipas OSCE-së, kur u pyeten “vetëm për nja ca minuta” nga një gjykatës hetimor dhe pa përkthimin e duhur, gratë thuhet se deklaruan që askush nuk i kishte detyruar ato për prostitucion dhe se ato kishin ardhur në Kosovë vullnetarisht. Pavarësisht nga deklaratat e mëparshme të bëra policisë nga gratë, raportohet se prokurori publik vendosi se çështja duhet të mbyllet për mungesë provash.²⁰⁴

²⁰³ TPIU-ja ia vesh këto dështime mungesës së bashkëpunimit nga autoritetet në shtetin dërgues, intervistë e AI me I.C., Nënkrjetar i TPIU-së, tetor 2003.

²⁰⁴ OMIK (OSCE Misioni në Kosovë), Departamenti i të Drejtave të Njeriut dhe Rendit, *Kosovë: Vështrim i Sistemit të Drejtësisë Penale, Tetor 2001*, fq. 54.

Më nëntor 2002, për shembull, një burrë shqiptar, J.T, u shpall i pafajshëm për kundravajtjen e trafikimit nga Gjykata e Qarkut e Prizrenit.²⁰⁵ Dy gra, J. dhe S., kishin paraqitur një kallëzim duke pretenduar se më janar 2002 J.T. i kishte detyruar të merreshin me prostitucion. Në atë kohë çështja shkoi në gjyq, S. e kishte “ndryshuar deklaratën e saj nga frika” dhe, ndonëse deklarata e J. u lexua, ajo nuk ishte e pranishme në gjyq. I akuzuarai u shpall i pafajshëm për akuzat lidhur me trafikimin.²⁰⁶

Ku nuk janë zbatuar masa mbrojtëse, gratë e trafikuar që dëshirojnë të dëshmojnë nuk kanë pasur rrugë tjetër përveçse të ndeshin të akuzuarin përballë në sallën e gjyqit OSCE-ja ka vënë re dështimin e gjyqësorit për të ndërmarrë hapa për të mbrojtur interesat e dëshmitarit në raste të tilla. Në një rast, gjykatësi hetimor urdhëroi që dy gra të trafikuar, të cilat ishin përdhunuar dhe rrahur nga i pandehuri, të ndesheshin veças me të pandehurin në gjyq. OSCE-ja raportoi se ballafaqimi “përfundoi në një ndeshje britmash që gjykatësi hetimor nuk ndërhyri ta ndalonte”²⁰⁷ NGO-të gjithashtu njoftuan se gratë e trafikuar ishin lënë të pambrojtura për të kaluar hetimin, çka thyen dispozitat e Seksionit 7 të Rregullores së Trafikimit, e cila e ndalon çuarjen e historisë së dëshmitarit në gjyq, përveçse pas një peticioni nga ana e mbrojtjes, kur një dëshmi e tillë mund të dëgjohet *in camera*.

Në një rast më 2001-2, katër të akuzuarit ishin ngarkuar me akuzën e marrëdhënieve seksuale me një vajzë me moshë nën 14 vjeç. Nuk u kërkuan masa për mbrojtjen e dëshmitarit dhe vajzës shqiptare kosovare iu desh ta ndeshte të akuzuarin përballë në gjyq, në një gjykim që zgjati për 11 ditë. Dy burra u dënuan, njëri *in absentia*, dhe dy të tjerë u liruan në apel. Kërcënimet e mëvonshme për vajzën e re dhe familjen e saj u bënë kaq të dendura, duke përfshirë përpjekjet për ta rrëmbyer atë prapë, sa që ajo nuk mund të dilte nga shtëpia e saj pa të atin.²⁰⁸

Shqetësme janë shprehur rreth praktikës së lirimit të një burri të dënuar për trafikim në pritje për rigjykim në apel. Më 6 qershor 2003, për shembull, R.J. u lirua në pritje për rigjykim në apel kundrejt një sentence prej tri vjet e gjysmë të dhënë nga Gjykata e Qarkut të Prishtinës për trafikimin e pesë grave ukrainase, që ishin detyruar për

²⁰⁵ Sipas Seksionit 2.2 (1) të Rregullores së Trafikimit.

²⁰⁶ Vendim i Gjykatës së Lartë të Kosovës, 29 prill 2003; Vendim P no. 243.2002, 29 nëntor 2002. J.T megjithatë, u dënua për mbajtje ilegale të armëve. Një apelim nga prokurori publik për rigjykim mbi bazën e “dëshmisë jokorrekte, situatës faktike të paplotë dhe vendimit të dhënë për sentencën” u gjykua se ishte i pabazuar nga Gjykata e Lartë më prill 2003.

²⁰⁷ OSCE raportoi se gjykatësit iu duk sikur pa një ndërveprim zbavitës, por asnjëra nga gratë nuk i ndryshoi deklaratat e veta, ndonëse që të dyja u dukën të traumatizuara nga eksperiencia, OMIK, *Vështrim i Sistemit të Drejtësisë Penale, 1 shtator 2000 – 28 shkurt 2001*, korrik 2001, fq. 58.

²⁰⁸ Akuza, fq nr. 522/2001; fq. nr. 418/2002.



prostitucion në klubin Madonna në Prishtinë, disa nga gratë dëshmuan kundër tij, por u kthyen më vonë në Ukrainë. Pas lirimimit të R.J., gratë nga sa thuhet morën kërcënime nëpërmjet një ortaku në Ukrainë se po vinte t'i vriste ato. Atyre u ishte dhënë mbrojtje nga policia dhe strehim në shtëpi të sigurta në Ukrainë. Më 19 shtator 2003, R.J. mbeti i lirë, meqenëse apeli nuk e kishte dëgjuar ende.²⁰⁹

Amnesty International e pranon se në proceset e mbajtura më 2003 u bënë përpjekje për të siguruar mbrojtjen e vikimave-dëshmitarëve, zakonisht më iniciativën e prokurorëve individualë. Në Gnjilane/Gjilan, për shembull, masa mbrojtëse, duke përfshirë kufizimet në raportim dhe anonimat, janë përdorur në trafikim dhe çështje të tjera delikate. Një prokuror ndërkombëtar informoi gjithashtu Amnesty International se sigurimi i dëshmisë nëpërmjet televizionit me qark të mbyllur (CCTV), qoftë brenda ndërtesës së gjykatës apo në vendin e origjinës së dëshmitarit, ishte parashikuar gjithashtu.²¹⁰

Këto dispozita u zbatuan në disa raste që përfshinin vajza të trafikuar nga brenda, si në Mitrovicë/Mitrovica më mars 2003, kur u mbajt një seancë dëgjimore e veçantë para se një gjykatës hetimor të dëgjonte provat e një fëmijë dëshmitar. Më shtator 2003, pesë fëmijë me moshë midis katër dhe tetë vjeç, që ishin gjetur në një shtëpi e menduar se ishte përdorur si bordello, dëshmuan në gjyq. Atyre iu mundësua siguri, mbrojtje dhe këshillim ligjor nën mbikëqyrjen e një psikologu dhe u shoqëruan gjithë kohës nga përgjegjësi i çështjes. Para se të dëshmonin në një dhomë të veçantë, ata iu prezantuan gjykatësit dhe përkthyesit, dhe kishin mundësi të bënin pushime ndërsa jepnin dëshminë e tyre. Megjithatë, siguria e fëmijëve u kompromentua rëndë qysh para procedurave hetimore, kur fotografitë e tyre dhe emrat, të cilët ishin të njohur për Departamentin e Drejtësisë, iu vunë në dispozicion Radio-Televizionit të Kosovës dhe u shfaqën në programin javor *Dossier e Krimit* (Crime File).²¹¹

Si NGO vendase dhe IOM-i kanë theksuar nevojën për t'i dhënë një prioritet më të madh respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njëriut të grave dhe fëmijëve që dëshmojnë në proceset gjyqësore. Ata që dëshmojnë jo vetëm që u ekspozohen rreziqeve të mëdha, por ata mund të vuajnë trauma personale duke rrëfyer eksperiencat e tyre. Në qoftë se gjykata i ndërpret proceset, kjo mund të jetë jashtëzakonisht stresuese, dhe në rrethana të tilla dëshmitarëve të mundshëm nuk u jepet mbrojtje.

²⁰⁹ Lajmet e MSNBC-së, "Gjykatat e Kosovës dështojnë me viktimat e trafikimit", 19 shtator 2003.

²¹⁰ Intervistë e AI me prokurorin ndërkombëtar, shtator 2003.

²¹¹ Intervistë e AI, shtator 2003.

E drejta për dëmshpërblim

"Personat e trafikuar, si viktimat të dhunimit të të drejtave të njeriut, kanë një të drejtë ndërkombëtare ligjore për zhdëmtim të mjaftueshëm dhe të përshtatshëm. Kjo e drejtë shpesh nuk është disponibël efektivisht për personat e trafikuar, pasi atyre dëndur u mungon informacioni për mundësitë dhe procedurat për të marrë zhdëmtim, duke përfshirë kompensimin, për trafikimin dhe shfrytëzimin përkatës. Më qëllim që të kapërcehet ky problem, asistencë legale dhe asistencë tjetër materiale duhet t'u jepet personave të trafikuar për t'i mundësuar ata të realizojnë të drejtat e tyre për zhdëmtime të mjaftueshme dhe të përshtatshme." Udhëzimi 9, UNHCHR Parime dhe Udhëzime.

Viktimat e shkeljes së të drejtave të njeriut kanë të drejtë për një zhdëmtim efektiv sipas Nenit 2 të ICCPR dhe Nenit 13 të ECHR, ndërsa Protokollin i Trafikimit në veçanti i detyron shtetet të marrin masa për personat e trafikuar, që të marrin kompensim për dëmet e pësuar, duke u kërkuar shteteve t'u sigurojnë personave të trafikuar informacion për procedurat përkatëse gjyqësore dhe administrative. Protokollin nuk e zgjidh çështjen nëse fondet duhet të sigurohen nga shteti apo nga konfiskimi i aseteve.²¹²

Në Kosovë, Seksioni 6 i Rregullores së Trafikimit kërkon themelimin e një fondi dëmshpërblimi, i autorizuar për të marrë fonde nga asetet e konfiskuara, të përdorura ose që rezultojnë nga krimet e ndjekura sipas Rregullores. Megjithatë, deri më sot, fonde të tilla nuk janë themeluar për shkak të dështimit për të autorizuar Direktivën Administrative. AD-ja parashikon një proces administrativ për të paguar kompensimin, ndonëse kjo nuk i pengon procedurat për dëmshpërblim në proceset penale ose civile.²¹³

Të gjitha viktimat e trafikimit duhet të kenë të drejtë për zhdëmtim dhe dëmshpërblim për shkeljet që kanë vuajtur, pavarësisht nëse ato pranojnë të dëshmojnë.²¹⁴ Sipas Kodit të Procedurës Penale, një palë e dëmtuar mund të kërkojë kompensim ose rikthimin e pronës para fundit të procesit penal.²¹⁵ Një vendim mbi këtë ankesë mund të merret në gjykimin final lidhur më të akuzuarin. Ka gjithashtu një proces civil paralel për ankesa të tilla.

²¹² Neni (6) Protokollin i Trafikimit; Konventa kundër Krimit të Organizuar Ndërshtetëror e UN-it ka dispozita të ngjashme në Nenin 25 (2).

²¹³ Projekti i Direktivës Administrative, shtator 2003.

²¹⁴ Konventa Evropiane për Kompensimin e Viktimave të Krimeve të Dhunshme, parashikon kompensim për lëndime serioze trupore ose dëmtime të shëndetit, madje dhe në rastet ku kundërvajtësi nuk mund të ndiqet ose ndëshkohet.

²¹⁵ Neni 103-1 i SFRY CPC.



Amnesty International nuk njih ndonjë rast në të cilin viktimat e trafikimit kanë përdorur mekanizmat në dispozicion për të kërkuar dëmshpërblime, duke përfshirë kompensimin. Kjo mund të ndodhë, pjesërisht, për shkak të mungesës së perfaqësimit ligjor për viktimat e trafikimit.



Kapitulli 6: 'Djemtë janë djem: më mirë edukoni vajzat tuaja'²¹⁶

Raportuesi Special mbi Dhunën kundër Grave foli më prill 2001 për një "rritje të gjerë në aktivitetin e trafikimit" në Bosnjë-Hercegovinë dhe Kosovë: "Është absolutisht thelbësore që gjithë forcat e UN-it të mbahen në të njëjtata standarde të ligjit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut siç janë shtetet-kombe....Po të bëjmë ndryshe,krijohet një klimë pandëshkueshmërie në të cilën shkeljet shumohen ...veçanërisht ku UN-i është duke drejtuar administrata të tilla si në Kosovë dhe Timorin Lindor ne e ndiejmë se është absolutisht thelbësore që disa lloje strukturash të jenë në terren për t'u marrë me këto lloj çështjesh."²¹⁷

Sekretari Përgjithshëm i UN-it e ka pranuar gjithashtu se ka "disa prova se prostitucioni rritet me ndërhyrjen ndërkombëtare" dhe se "personeli paqeruajtës mund ta ketë injoruar themelimin e bordellove dhe të jetë bashkëfajtor në trafikimin e grave dhe vajzave".²¹⁸ Ai ka vërejtur gjithashtu se "[mjaf]shpesh, shtetet kontribuuese s'arrijnë t'i ndjekin bashkëkombasit e tyre të akuzuar për shkelje të rënda kur janë në shërbim për [UN-in]".²¹⁹ Më 2003 Sekretari i Përgjithshëm botoi në vijim një Buletin i cili bën thirrje për masa të veçanta që i ndalojnë forcat dhe personelin e UN-it për të kryer akte të shfytëzimit seksual dhe të abuzimit seksual.²²¹

Amnesty International është jashtëzakonisht e preokupuar që administrata e UN-it në Kosovë ka lejuar efektivisht zhvillimin e një industrie të lulëzuar, që mbështetet në shfrytëzimin e grave të trafikuar.Ndonëse industria e seksit në Kosovë tani u shërben si burrave vendas dhe ndërkombëtarë,është e qartë se ajo fillimisht u rrit nga militarizimi pas konfliktit dhe nga prania e ushtarakëve dhe komunitetit civil ndërkombëtar të paguar mirë.

Organizata mendon gjithashtu se UNMIK-u - duke dështuar në ndjekjen e personelit ndërkombëtar të dyshuar për përfshirje në trafikim ose duke përdorur me dijeni shërbimet e grave të trafikuar – ka krijuar një klimë pandëshkueshmërie për abuzime dhe shkelje kundër grave të trafikuar.

²¹⁶ Zëdhënës shtypi norvegjez i KFOR-it ,në një takim në Prishtinë të organizuar nga NGO-të vendase ,UNIFEM -i dhe organizata të tjera ndërkombëtare më 1999, Intervistë e AI me Igballe Rugova.

²¹⁷ Fjalë në Komisionin e të Drejtave të Njeriut të UN-it, 9 prill 2001, "Paqeruajtësit e UN-it ushqejnë trafikimin e grave, Një ekspert i UN-it paralajmëron", AFP, 9 prill 2001.

²¹⁸ Paras. 267-272, Gratë,Paqja dhe Siguria, Studim i paraqitur nga Sekretari i Përgjithshëm në ndjekje të Rezolutës së Këshillit të Sigurimit 1325 (2000), UN, 2002

²¹⁹ Më datë 2003, UN DPKO nisi hetimin e saj.

²²¹ ST/SGB/2003/13,Buletin i Sekretarit të Përgjithshëm,Masa të veçanta për mbrojtjen nga shfrytëzimi seksual dhe abuzimi seksual.

Pavarësisht nga rritja e shpejtë e trafikimit në Kosovë,pak masa -nëse ka ndonjë masë- u morën për t'u përgjigjur kërkesave nga ushtarakët dhe personeli civil deri me janar 2001, pothuajse 18 muaj pas mbërritjes se komunitetit ndërkombëtar në Kosovë.²²⁰

Kërkesa

"Shumë burra dhe të rinj më përdhunuan mua,të rinj dhe pleq,vendas dhe ndërkombëtarë...ne ishim rreth 20 veta në atë shtëpi.Vetëm dy ishin nga Moldavia dhe gjithë pjesa tjetër shqiptarë."²²¹

"..... edhe në mot të ftohtë unë duhet të vishja rroba të holla... Unë isha e detyruar nga bosi t'u shërbeja ushtarëve ndërkombëtarë dhe policëve... Une nuk kam pasur kurrë shansin për t'u arratisur dhe për ta lënë atë jetë të mjerë,sepse unë mbikëqyresha çdo çast nga një grua...."²²²

Më 1999 deri më 2000 ndërkombëtarët llogariteshin që përfshinin 80 për qind të klientëve të grave të trafikuar.Sipas policisë së UNMIK-ut, ndonëse nga fundi i 2000 pjesëtarë të komunitetit ndërkombëtar-"kryesisht ushtarë të KFOR-it-"ende përbënin 40 për qind të klientelës,shumica e klientëve ishin burra vendas.Pavarësisht nga kjo,shumë gra të trafikuar,të intervistuar nga Shërbimi i Monitorimit të Sistemit Ligjor i OSCE-së, (LSMS) më 2000-1 deklaruan se policët ndërkombëtarë ishin midis "klientëve" të tyre të shpeshtë.²²³ Më 2002, kur komuniteti ndërkombëtar përbënte afro 30 për qind të klientëve, thuhet se ata krijuan afro 80 për qind të të ardhurave të industrisë.²²⁴

Sipas informacioneve nga TPIU-ja, nga NGO-të që punonin me gra të trafikuar dhe dëshmitë e vetë grave,policia e UNMIK-ut dhe personeli i KFOR-it vazhdonin të përdornin shërbimet e grave të trafikuar më 2003.

Më 2003 kallëzime mbi përdorimin e grave të trafikuar u afishuan në faqen Tabela e Mesazhit në internet të policisë së UNMIK-ut.Për shembull, në përgjigje të një mesazhi "Kërkohet Vesna", përgjigjja vijuese u afishua më 16 gusht 2003, "Unë e pashë atë për herë të fundit tek Miami Bar.Ajo ishte me një burrë shqiptar të madh nga i cili ajo duket se kishte frikë dhe se ajo duket se po bezdisej.Ajo po detyrohej të kërkonte për klientë në bar.Një oficer i

²²⁰ UNMIK Njoftim për shtyp 470, "UNMIK-u nxjerr jashtë ligjit trafikimin e njerëzve" 14 janar 2001; shih edhe Reuters, "Baret dhe klubet e seksit në Kosovë i ndalohen policisë së U.N.", 31 maj 2001.

²²¹ Vajzë shqiptare e trafikuar nga brenda, vjeç 17.

²²² Vajzë shqiptare e trafikuar nga brenda, vjeç 12.

²²³ Limanowska, Trafikimi i Qenieve Njerëzore në Evropën Juglindore, fq. 96; OSCE, Departamenti i të Drejtave të Njeriut dhe Rendit, Kosove:Vështrim i Sistemit të Drejtësisë Penale, tetor 2001, fq. 51.

²²⁴ Bazuar në vlerësimet e IOM-it dhe CPWC-së; një vajzë e trafikuar dëshmon se ushtarët e KFOR-it paguan 100 DM për një orë; burrat vendas duhet të paguajnë të njëjtën shumë për një natë.



UNMIK CIVPOL-it pagoi 150€ për dy orë me atë. Çdo njeri mund të informojë TPIU-në.”

Ndonëse përpjesëtimi i klientëve ndërkombëtarë raportohet se ka rënë qysh nga 2000, numri i lokaleve “të listës së gjërave të ndaluara” ka vazhduar të rritet.

Pavarësisht nga strategjitë e UNMIK-ut kundër trafikimit, pjesëtarët e komunitetit ndërkombëtar mbeten një pjesë e rëndësishme e tregut për gra të trafikuar. Ndonëse ndërkombëtarët nga sa thuhet tani përbëjnë 20 për qind të bazës së klientëve, Amnesty International vëren gjithashtu se komuniteti ndërkombëtar (gra e burra bashkë), ndoshta përbëjnë vetëm rreth dy për qind të popullsisë së Kosovës.

Lista “e gjërave të ndaluara”

Pas shpalljes së Rregullores së Trafikimit më janar 2001, një Kod Sjelljeje u shpërnda nga personeli i UNMIK-ut më 24 janar 2001. Ai paralajmëronte për pasoja të rënda personelin e UN-it të dyshuar se përdorte shërbimet e grave të trafikuar, duke përfshirë masë disiplinore, lirim dhe mundësinë e procesit penal i cili pasonte pezullimin e imunitetit.

“Kodi i Sjelljes i UN-it: Qëllimi i kësaj qarkoreje është të japë udhëzime për të siguruar që personeli të respektoje të drejtat e njeriut dhe të mos kontribuojë financiarisht për krimin e organizuar në Kosovë. Duhet shënuar se pasojat për personelin e UNMIK-ut që nuk e përfillin këtë informacion do të jenë të rrepta. Ky personel mund t'i nënshtrohet masës disiplinore, e cila mund të përfshijë lirim. Për më tepër, personeli mund t'i nënshtrohet procesit penal sipas ligjit të zbatuar, duke përfshirë Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/4. Pjesëtarët e personelit ndërkombëtar që gëzojnë imunitet nga arresti personal dhe paraburgimi sipas Konventës 1946 për Privilegjet dhe Imunitetet e Kombeve të Bashkuara njoftohen se imuniteti është në favor të Kombeve të Bashkuara dhe jo për ata personalisht, dhe se ky imunitet mund të pezullohet në rast se personeli ndiqet për krime të lidhura me prostitucionin, duke përfshirë përdorimin e shërbimeve seksuale të një viktime trafikimi.”

Lista e parë “e gjërave të ndaluara” u publikua në të njëjtën kohë me kodin e Sjelljes. Ajo përmendte më shumë se 150 bare nate, klube nate, dhe klube vallëzimi, motele, hotele, restorante dhe kafe-bare të dyshuara se janë përfshirë në prostitucion. Një liste e rishikuar u publikua më korrik 2002, duke përmendur 155 lokale, dhe lista raportohet se azhurnohet çdo muaj.

POLICIA E UNMIK-ut

Dëshmi se policia e UNMIK-ut ishte përfshirë në trafikim u raportuan së pari më 2000 dhe kanë vazhduar së paku

deri më 2003, kur një komandant i policë së UNMIK-ut e kthyen në shtëpi²²⁵ dhe u hap një proces më 9 qershor 2003, kur katër burra, duke përfshirë një polic ndërkombëtar, u arrestuan në Peja/Pec me dyshimin e përfshirjes në “një komplot skllavërie prostitucioni”.

Më korrik 2001 u raportua se policia e UNMIK-ut kishte nisur një hetim për kallëzime, raportuar së pari më 2000,²²⁶ se dy policë US dhe një police rumune femër kishin ndihmuar pronarin e një bordelloje në Mitrovicë në trafikim e grave. Hetimi nga Departamenti i Brendshëm Hetimor pasoi një raport të brendshëm nga kreu i njësisë së policisë rajonale, i cili rekomandoi një hetim të thellë dhe paralajmëroi se “është në pikëpyetje gjithë besueshmëria e Policisë së Kosovës e Misionit të Kombeve të Bashkuara”.²²⁷ Raporti pohonte se një oficer i UN kishte qenë duke marrë gra të trafikuar në kufirin midis Kosovës dhe Serbisë, pikërisht ndërsa ishte me uniformë dhe ndërsa ngiste një makinë të policisë së UNMIK-ut. Një polic i dytë US u padit se e kishte paralajmëruar pronarin që po kryhej një hetim i policisë dhe se kishte përhapur informacion mbi operacionet e mëparshme të trafikimit dhe prostitucionit. Oficeri rumun u akuzua për njoftimin e pronarit të bordellos rreth planeve të policisë për ta arrestuar atë. Kur policia shkoi të kontrollonte në klub, ai ishte mbyllur. Një bashkëkombas i tretë US i përmendur në raportin e brendshëm u dërgua në shtëpi për një “gabim profesional në gjykim”.

Në përmbledhjen e Shtypit më 13 gusht 2001 policia e UNMIK-ut deklaroi: “Hetimi tani ka përfunduar. Dy oficerë u gjet se kishin shkelur Kodin e Sjelljes. Ata u riadhesuan. Dy oficerë të tjerë morën letra me vërejtje të rëndë. Ndërsa për katër që kryen sjellje të keqe profesionale, të shkallëve të ndryshme, nuk u gjet provë për të mbështetur akuzat penale.”²²⁸

Procese kundër pjesëtarëve të Policisë së UNMIK-ut

Amnesty International e pranon se TPIU-ja së fundi ka treguar një gatishmëri më të madhe për të hetuar raportet e përfshirjes së personelit të UNMIK-ut në trafikim dhe për të kërkuar pezullimin e imunitetit nga akuza. Megjithatë, ndjekjet penale mbeten të rralla dhe ato pak raste që kanë kaluar në shkallë gjyqimi kanë qenë çuar pothuajse të

²²⁵ Departamenti i Shtetit US, Seksioni 5 (f), *Raportet Shtetërore për Praktikën e të Drejtave të Njeriut : Serbia dhe Mali i Zi*, 25 shkurt 2004.

²²⁶ “Ka një dyshim se policë ndërkombëtarë të UNMIK-ut mund të jenë përfshirë në trafikim”, shënime nga Takimi i 18 tetorit i Tryezës së Rrumbullakët për Trafikimin”, OSCE, Prishtinë, 22 tetor 2001, cituar tek Limanowska, *Trafikimi i Qenieve Njerëzore në Evropën Juglindore*, fq. 96.

²²⁷ “Policët e UN-it hetohen rreth trafikimit në Kosovë”, *Reuters*, 5 korrik 2001. Departamenti i Shtetit U.S. gjithashtu duket të jetë përfshirë në hetim.

²²⁸ Shih <http://www.unmikonline.org/press/2001/trans/tr130801.html>.



gjitha vetëm ku viktimat ishin më pak se 14 vjeç.²²⁹ Asnjë polic nuk është ndjekur sipas Seksionit 4 të Rregullores së Trafikimit deri në mars 2004.

Para vitit 2002, pak hetime kundër policëve ndërkombëtarë përfunduan me ndjekje, një shqetësim i theksuar nga OSCE-ja më tetor 2001.²³⁰ Në verë 2001 u emërua një prokuror publik ndërkombëtar për një çështje që përfshinte një polic të UNMIK-ut. Duke e konsideruar dëshminë e një viktime 13-vjeçare se nuk ishte e fortë dhe e qëndrueshme sa duhet, prokurori thuhet se as nuk arshivoi një kërkesë për një gjykatës hetimor, që të niste një hetim zyrtar, as nuk bëri ai kërkesë për pezullimin e imunitetit sipas Seksionit 6 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/47. Hetimi u mbyll dhe polici u riatdhesua. OSCE LSMS shprehu preokupim, duke pasur parasysh faktin se: "i dyshuari u kishte dhënë katër deklaratat kontradiktore policëve hetues; provat materiale, duke përfshirë pika gjaku dhe bishta cigaresh, u gjetën në shtëpinë bosh, që i dyshuari e pranoi se ai e kishte marrë me qira për atë natë të veçantë. Ai pranoi gjithashtu se kishte nisur një sjellje seksuale me viktimën, ndonëse për shkak të rrethanave [të papërcaktuara] ishte i paafte të vazhdonte me marrëdhënien seksuale."²³¹

Ngurrimi për të ngritur akuza kundër policisë ndërkombëtare sipas Rregullores së Trafikimit është parë gjithashtu në një arrest në Mitrovicë/ Mitrovica, ku një vajzë raportoi një oficer të UNMIK-ut për abuzim seksual. Si vajza, dhe i dyshuari, nga sa thuhet, përmendën një person të tretë i cili kishte gjetur një shtëpi, e çoi vajzën tek shtëpia dhe e bindi atë të takonte të dyshuarin. Vajza dëshmoi se ajo ishte marrë prej shtëpisë së saj me forcë dhe çuar tek shtëpia. "Personi i tretë" raportohet se as nuk ishte pyetur nga policia. Për pasojë, polici nuk u akuzua në lidhje me blerjen e shërbimeve të një vaje potencialisht të trafikuar.²³²

OSCE-ja gjithashtu dokumentoi një rast me 2001, në të cilin një grua turke njoftoi tek policia e UNMIK-ut në Rahovec/Orahovac se ajo ishte përdhunuar dhe ishte detyruar për prostitucion nga një shqiptar i Kosovës. Ajo thuhet që deklaroi se disa nga klientët e saj përfshinin edhe policë të UNMIK-ut të stacionuar në Rahovec/Orahovac, dhe pohoi se ajo mundet si të identifikojë burrat, ashtu dhe t'u tregojë hetuesve vendndodhjen e apartamenteve të tyre. Pavarësisht nga konflikti i vetëkuptueshëm i

²²⁹ Marrëdhënie seksuale dhe shturje çnjerëzore me një person i cili nuk ka mbushur moshën katërmëdhjetë vjeç, , Neni 106, Ligji Penal i Republikës së Serbisë, 1977.

²³⁰ OSCE, *Kosovë: Vështrim i Sistemit të Drejtësisë Penale*, tetor 2001, fq.52.

²³¹ OSCE, *Kosovë: Rishikim i Sistemit të Drejtësisë Penale*, tetor 2001, fq.52.

²³² Sipas Seksionit 4, Rregullorja 2001/4. OSCE, *Kosovë: Rishikim i Sistemit të Drejtësisë Penale*, tetor 2001, fq.52.

interesit, policia e UNMIK-ut në Rahovec/Orahovac u ngarkua me hetimet. Ajo përcaktoi se viktimës i mungonte besueshmëria dhe çështja u mbyll.²³³

Më 9 qershor 2003 katër burra, duke përfshirë një polic ndërkombëtar nga Pakistani, u arrestuan në Pec/Peja me dyshimin për përfshirje në "një komplot për skllavëri prostitucioni", dhe më 13 qershor akuzat u konfirmuan nga një gjykatës hetimor. U pezullua imuniteti dhe oficeri i UNMIK-ut u akuzua për "Sjellje e ulët, Përdhunim dhe marrëdhënie seksuale me një të mitur nën moshën 14 vjeç, Shkaktim Lëndimesh dhe Trajtim i Pakujdesshëm i të Miturve".²³⁴ Procesi hetimor u hap më shtator 2003 në Prishtinë, por nuk ishte përfunduar deri në fund të marsit 2004.

KFOR-i

Përdorimi i grave të trafikuar nga KFOR-i dhe përfshirja në trafikim

*"Ushtarët gjermanë... Ata ishin kërcënuar nga shefat e tyre. Se ai do t'i zërë ata në ndonjë bordello dhe do t'u hapë [shkaktojë] telashe. Ata nuk lejoheshin të shkonin me prostituta gjatë shërbimit të tyre... Gjermanët erdhën gjithë nëntorin dhe dhjetorin, madje edhe pasi komandanti i tyre u ndaloi këtë. Ata thanë se do të kenë shumë telashe. Ata i thanë tutorit se, po që se dikush do jetë duke ardhur, ai duhet t'u japë alarmin [paralajmërojë] ata... Pas ca kohe tutori punësoi një rojë."*²³⁵

Amnesty International është e preokupuar se KFOR-i dhe personeli tjetër civil ndërkombëtar me pushime nga Kosova, i cili viziton Maqedoninë për "pushim dhe çlodhje", përveç personelit të KFOR-it gjerman të stacionuar atje, mund gjithashtu të jetë duke përdorur shërbimet e grave të trafikuar. Në një dokumentar të shfaqur në një televizion gjerman më dhjetor 2002, një pjesëtar i KFOR-it gjerman, i cili ishte stacionuar në Maqedoni, siguroi prova të besueshme se pjesëtarët e KFOR-it gjerman ishin duke përdorur shërbimet e grave të trafikuar- duke përfshirë dhe fëmijë.²³⁶ Ky informacion u vërtetua nga një zëdhënës shtypi për KFOR-in gjerman dhe një oficer i lartë i KFOR-it i intervistuar gjatë programit. Prova të mëtejshme u paraqitën nga gra të reja që kishin punuar nëpër bordello në Maqedoni, të përdorura nga trupat gjermane të KFOR-it.

²³³ *po aty*. I njëjti raport përshkruan edhe dy raste të tjera, në të cilat akuzat u rrëzuan në mënyrë të ngjashme.

²³⁴ "Të dyshuar akuzohen për krime seksuale" UNMIK-U Njoftim për shtyp i policisë, 13 June 2003; "Polic i UN në Kosovë arrestohet rreth një rasti seksi me fëmijë", AFP, 13 qershor 2003.

²³⁵ Grua bullgare e trafikuar në Maqedoni, e intervistuar më 2001, Arkiva Inge Bell.

²³⁶ *ARD Weltspeigel*, Drejtor, Inge Bell, transmetuar 17 December 2000.



Ndonëse nuk ka “listë të gjërave të ndaluara” në Maqedoni, pjesëtarët e KFOR-it të stacionuar në Maqedoni janë të ndaluar të lënë bazën e tyre, përveç për punë zyrtare. Dëshmi të dhëna nga një ushtar gjerman i KFOR-it të bëjnë të mendosh që strategjitë për të shmangur zbulimin janë të mirëzhvilluara:

“Ne dolëm jashtë kazermave si zakonisht në jeep-in tonë, ashtu si zakonisht me lejen e shoferit, kështu që asnjëri nuk mund të dyshonte për ne...ne erdhëm vërdallë dhe pritëm deri më 11 të natës, dhe pastaj shkuam tek bordelloja sa më shpejt që mundëm. I telefonuam pronarit të bordellos se ne po vijmë...pronari hapi portën, kështu që ne mund të shkonim drejt e në garazh.”²³⁷

Prova të përdorimit të grave të trafikuar nga KFOR-i në Kosovë vijnë nga dëshmitë e grave të trafikuar, nga raporte dhe nga sa kanë parë ushtarë të KFOR-it nëpër bare të njohura se janë përfshirë në trafikim, dhe nga një numër i vogël rastesh në të cilët janë njoftuar publikisht procedura disiplinore kundër pjesëtarëve të KFOR-it. Më 2001, për shembull, tre Komando të Marinës Mbretërore të UK njoftohet se u dërguan në shtëpi, pasi u zbuluan më 1 Dhjetor 2000 në një bar ku vallëzohej në prehër; ata u akuzuan më pas për dehje dhe lënien e bazës së tyre pa leje. Një vit më parë një lejtant kolonel i ushtrisë angleze thuhet se u dërgua në shtëpi, pasi u zbulua në një bordello në Prishtinë.²³⁸ Më 2003, pesë anëtarë të KFOR-it francez u dërguan në shtëpi pas akuzave se ishin përfshirë në trafikim në Mitrovicë/Mitrovica.

“Problemi është sa asnjëri nuk i merr parasysh nevojat e bordellove në kontigjentin gjerman [të KFOR-it]. Amerikanët dhe francezët, dhe të tjerët, sidoqoftë, kanë bordellot e ushtrisë së tyre. Unë nuk po përpiqem të them se prostitutat kanë për të ardhur nga Amerika ose Franca, por bordelloja mund të merret me qira për njëfarë periudhe kohore dhe të qëndrojë nën kontrollin e njësisë.”²³⁹

Provat për përfshirjen e trupave të KFOR-it në trafikimin e grave në Kosovë është dokumentuar qysh nga fillimi i 2000. Akuzat të përsëritura janë bërë kundër pjesëtarëve të kontigjentit të KFOR-it rus, qoftë si përdorues të grave të trafikuar, ashtu dhe në trafikimin e grave-qoftë drejtpërdrejt ose me ndihmën e trafikantëve serbë. Qysh nga 2000 trupat ruse të KFOR-it flitet se u përfshinë në sjelljen e grave moldave dhe ukrainase- nga sa thuhet, të fshehuara me uniforma të ushtrisë ruse-për në bazën ruse të Fushë Kosovës/Kosovo Polje. Një NGO hungareze që punon më gratë e trafikuar ”raportoi se KFOR- rus ishte

përfshirë në sjelljen e grave për punë seksuale... Ato[gratë e trafikuar]besonin se klientët e tyre ishin ushtarë të KFOR-it, personel i NGO-ve, personel i OSCE-së dhe mjaft lokale. KFOR-i duhet të hiqte shenjat e tyre dhe distinktivët, dhe amerikanët duhet të thoshin se ata ishin ‘ruse’.”²⁴⁰

Më janar 2002, pesë serbë të Kosovës nga Fushë Kosova/ Kosovo Polje u akuzuan se detyruan katër gra serbe dhe moldave ”për të ushtruar prostitucion, duke ua shitur ato klientëve të ndryshëm dhe, veçanërisht, ushtarëve rusë të KFOR-it, duke i dërguar ato në Manastirin e Diviqit në Skënderaj për të kryer marrëdhënie seksuale.”²⁴¹ Më 2003, Amnesty International mori gjatë dëshmi nga një pjesëtar i KFOR-it francez të stacionuar në Mitrovicë se më 2002 “disa kolegë ishin zbatimur me gra të trafikuar ” nga kolegë oficerë në KFOR-in rus në bazën e Fushë Kosovës/ Kosovo Polje.²⁴² Kontigjenti rus u largua nga Kosova në fillim të 2003; Amnesty International nuk ka dijeni për akuza ose masa disiplinore kundër trupave ruse.

Organizata është gjithashtu në dijeni të dëshmimeve që gratë ishin trafikuar posaçërisht për përdorim nga KFOR-i, siç tregohet në proceset më 2001, kur një serb nga Kosova u akuzua me krimin e trafikimit se e kishte rregulluar për një viktimitë serbe nga Kosova që të takonte ushtarët ”në një fushim të KFOR-it jashtë Kamenicës”.²⁴³

Më shtator 2003, TPIU-ja informoi Amnesty International se afro 10 ushtarë francezë të KFOR-it dyshoheshin më mënyrë të ngjashme për përfshirje, ”por ne nuk mund t’i prekim ata”.²⁴⁴ Amnesty International ka marrë gjithashtu dëshmi të besueshme për bordello brenda batalione të kombeve të KFOR-it, duke përfshirë tek Camp Monteith në Gnjilane/Gjilan dhe Camp Bondsteel pranë Ferizaj/Uroševac, ku personeli US i KFOR-it është ndaluar të largohet nga bazat e tyre.²⁴⁵

Përgjegjshmëria

“Duhet vendosur një mekanizëm me fuqi për të hetuar kallëzimet e shkeljeve të të drejtave të njeriut nga personeli paqeruajtës. Trupat e shteteve kontribuuese në operacionet paqeruajtëse duhet të kryejnë me shpejtësi hetime të pavarura dhe të paanshme për raportimet e

²⁴⁰ NGO Salamon Alapitvany, e cituar në S’ka vend të sigurt, fq. 77.

²⁴¹ Ata u akuzuan sipas Nenit 251, në vend të Rregullores 2001/4.

Vendim i një Çështjeje Apeli, AP 252/2001, datuar 19 mars 2003, që la në fuqi vendimin P10/2001, datuar 26 prill 2001, Gjykata e Qarkut Prishtinë.

²⁴² E-mail i marrë nga një oficer francez i KFOR-it, 2003.

²⁴³ Ai u akuzua sipas Rregullores 2001/4 nga Gjykata Bashkiake e Kamenicës më gusht 2001, OSCE, Departamenti i të Drejtave të Njeriut dhe Rendit, *Kosovë: Vështrim i Sistemit të Drejtësisë Penale*, tetor 2001 fq.58.

²⁴⁴ Intervistë e AI me Irina Cocos, TPIU, shtator 2003.

²⁴⁵ Sipas informacionit të marrë më tetor 2003, US KFOR-i thuhet se ishte duke marrë masa për ta zgjidhur këtë.

²³⁷ Intervistë më një ushtar gjerman të KFOR-it, Arkiva Inge Bell.

²³⁸ “Një kolonel ’i kapur në bordello”, The Times, 6 qershor 2000;

“Marinarë të Marinës Mbretërore dërgohen në shtëpi nga Kosova pas dehjes në një strip-club”, AFP, 11 janar 2001.

²³⁹ Intervistë më një ushtar gjerman të KFOR-it, Arkiva Inge Bell.



*shkeljeve të drejtave të njeriut dhe ligjit humanitar nga bashkëkombasit e tyre, dhe të çojnë para drejtësisë ata që janë përgjegjës. Ata që dyshohen për shkelje të tilla duhet të pezullohen nga detyra në pritje të rezultatit të hetimeve.*²⁴⁶

Policia e UNMIK-ut, personeli tjetër i UNMIK-ut, personeli i KFOR-it dhe kontraktorët, dhe personeli i disa organizatave të tjera²⁴⁷ gëzojnë një imunitet të përgjithshëm nga ndjekja penale, përveçse kur pezullohet shprehimisht nga Sekretari i Përgjithshëm i UN-it, ose në rastin e KFOR-it, nga komandanti i tyre kombëtar.²⁴⁸

Policia e UNMIK-ut

Sipas TPIU-së, u kryen hetime nga Policia e Çështjeve të Brendshme e UNMIK-ut për kallëzimet kundër dhjetë personeli të UN-it, duke përfshirë policinë e UNMIK-ut më 2002; deri më shtator 2003 ishin filluar hetime kundër dy policëve të UNMIK-ut, si dhe dy oficerëve të KPS-së. TPIU-ja informoi Amnesty International se në shumicën e këtyre rasteve nuk ishte kërkuar ose dhënë pezullim më qëllim ndjekjeje. Megjithatë, pezullime u kërkuar dhe u dhanë në një rast më 2002 dhe një tjetër më 2003, duke mundësuar kryerjen e ndjekjes së dy oficerëve.²⁴⁹

Policia e UNMIK-ut deklaroi se çdo person që gjendet në çdo ndërtesë të "listës së gjërave të ndaluara" do t'i nënshtrohet masës disiplinore. Policia e UNMIK-ut ka deklaruar gjithashtu se, në rast se një oficer kapet në ndonjë nga kafenetë ose baret të "listës së gjërave të ndaluara", ai dërgohet menjëherë në atdhe. Megjithatë, sipas informacionit të marrë nga Amnesty International, në të vërtetë, Departamenti i Politikës së Çështjeve të Brendshme i Policisë së UNMIK-ut përcaktoi se hetuesit duhet më parë të përcaktojnë nëse një i dyshuar ka qenë duke përdorur shërbimet e një prostitute (nëse ka qenë e trafikuar apo jo). Në qoftë se kjo mund të përcaktohet, pastaj duhet marrë një deklaratë nga gruaja përkatëse. Megjithatë, "Çështjet e Brendshme

²⁴⁶ Rekomandimet e Amnesty International për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në ndërtimin e paqes pas konfliktit dhe rindërtimin në Kosovë. AI Index: EUR 70/91/99, qershor 1999.

²⁴⁷ Për shembull, IOM: Intervistë e AI me Pasquale Lupoli, më vonë - Shef i Misionit të IOM-it në Kosovë, shtator 2003.

²⁴⁸ Si personeli i UNMIK-ut dhe i KFOR-it mbulohen nga Rregullorja e UNMIK-ut 2000/47 Mbi Statusin, Privilegjet dhe Imunitetet e KFOR-it dhe UNMIK-ut dhe personelit të tyre në Kosovë, 18 gusht 2000. Neni V, Seksioni 20, deklaroi: "Sekretari i Përgjithshëm [i Kombeve të Bashkuara] do të ketë të drejtën dhe detyrën të pezullojë imunitetin e çdo nëpunësi në çdo rast ku, sipas opinionit të tij, imuniteti do të pengonte ecurinë e drejtësisë dhe mund të pezullohet pa paragjykim të interesave të Kombeve të Bashkuara. Në mungesë të Sekretarit të Përgjithshëm, Këshilli i Sigurimit do të ketë të drejtë të pezullojë imunitetin..."

²⁴⁹ Një rast ishte në vazhdim më shtator 2003: pavarësisht nga pezullimi, i dyshuari ishte liruar nga paraburgimi hetimor nga një gjykatës ndërkombëtar; TPIU-ja pastaj apeloj kundër lirimit, Intervistë e AI me Jennifer McMullen, Kryetar i TPIU-së, shtator 2003.

këshillon që një "ajo tha" (sic) nuk do të jetë e mjaftueshme për të marrë masë kundër oficerit; as edhe identifikimi i oficerit nga mjete të identifikimit fotografik nuk konsiderohen të mjaftueshme për të justifikuar një masë. Hetuesit i kërkohet të kryejnë një "intervistë të thellë me palën femër për të siguruar hollësi lidhur me aspektet personale të oficerit".²⁵⁰

Sipas TPIU-së, "mjaft hetime të suksesshme u kryen gjatë 2003 dhe mjaft personel i identifikuar u lirua nga detyra, u akuzua penalisht, u ndëshkua sipas kodeve të sjelljes së vendit të vet ose u riatdhesua në vendin e tij amtar".²⁵¹

Deri në fund të 2002, afro policë të 57 UNMIK-ut ishin liruar ose riatdhesuar, dhjetë nga të cilët - sipas Derek Chappell i policisë së UNMIK-ut - u riatdhesuan në lidhje me trafikimin; në fund të 2003, u citua e njëjta shifër.²⁵²

Ndonëse policia e UNMIK-ut pranoi se ata ishin informuar në secilin nga këto raste dhe se oficerët do të ndëshkoheshin ose do të ndiqeshin në vendet e tyre amtare, ata ishin të paafte të konfirmonin nëse ndonjë nga oficerët e riatdhesuar ishte ndëshkuar në fakt ose akuzuar për ndonjë krim penal.²⁵³ Derek Chappell shprehu gjithashtu shqetësim se policët US nuk do të jenë subjekt për procedura disiplinore, pasi ata nuk ishin të përgjegjshëm ndaj qeverisë amerikane, por sepse ishin rekrutuar nga agjenci private, *Dyncorp*.²⁵⁴

NATO-ja dhe KFOR-i

Nga janari 2002 deri më 2003, midis trupave 22 dhe 27 të KFOR-it u dyshua për krime të lidhura më trafikimin dhe iu raportua nga TPIU-ja Marshallit të Provost dhe Oficerit Komandues. TPIU-ja ishte e paafte të siguronte informacion të mëtejshëm nëse ndonjë proces disiplinor ishte ndërmarrë kundër këtyre individëve.

As ndonjë personel i KFOR-it, i dyshuar për trafikim ose për përdorimin e shërbimeve të grave ose vajzave të

²⁵⁰ "Politika e Çështjeve të Brendshme", TPIU Procedura Standarde e Operimit, e padatur, por vënë në dispozicion të AI më tetor 2003.

²⁵¹ TPIU Raporti i Përkohshëm, 2003; Raporti vjetor, 2002.

²⁵² Të paktën një oficer tjetër i policisë së UNMIK-ut u riatdhesua më 2003, shih më sipër.

²⁵³ "Ne nuk kemi informacion se çfarë mund të bejnë vendet e tyre amtare në aspektin e akuzave të brendshme ose penale. Shumë agjenci policore e konsiderojnë shkeljen e Kodit të Sjelljes nga punonjësit e tyre kur shërbejnë në Kosovë si një shkelje të Kodit të Sjelljes në atdheun e tyre - dhe në këtë rast ata do t'u nënshtrohen masave disiplinore të brendshme pasi kthehen në atdhe. Kjo ndryshon nga vendi në vend dhe natyrisht ne nuk kemi mundësi t'i ushtrojmë akuzat në një vend të huaj," email AI nga Derek Chappell, mars 2004.

²⁵⁴ Intervistë e AI me Derek Chappell, tetor 2003. Për akuzat lidhur më përfshirjen e policisë ndërkombëtare, përfshirë personelin e *Dyncorp*, në trafikimin në Bosnjë-Hercegovinë, shih Human Rights Watch, *Shpresa të tradhtuara: Trafikimi i Grave dhe Vajzave në Bosnjën dhe Hercegovinën Postkonfliktuale për Prostitucion të Detyruar*, HRW Index No. D1409, nëntor 26, 2002. Për procedim disiplinor kundër një kontraktori më 2003, shih fq. 32, ft. 136.



trafikuar, nuk është proceduar në Kosovë qoftë përpara, ashtu dhe pas shpalljes së Rregullores së Trafikimit. Amnesty International në mënyrë të ngjashme nuk ka mundur të gjejë ndonjë provë për ndonjë proces penal kundër pjesëtarëve të KFOR-it në vendet e tyre amtare.

Prania ushtarake në Kosovë e udhëhequr nga NATO, pavarësisht se është themeluar nga një rezolutë e UN-it, nuk ka aderuar ende në standardet e zbatuara gjatë misionëve të Departamentit Paqeruajtës (DPKO) të UN-it.²⁵⁵ Në asnjë nga përgjigjet e tyre ndaj Amnesty International as KFOR-i, NATO-ja apo ndonjë zëdhënës ushtarak individual nuk iu referua Kodit të Sjelljes të UN-it.

Më shtator 2002, tek një takim në Selinë e NATO-s në Bruksel, Amnesty International ngriti me NATO-n çështjen e përfshirjes së përfolur të KFOR-it në trafikimin dhe në përdorimin e grave të trafikuar. Robert Serry, Drejtor i Task Forcës së NAT O-s për Ballkanin, deklaroi se nuk ishte e mundur të mohohet që trupat përdorin prostituta, por se ishte e padrejtë të zgjidhet NATO-ja për t'u kritikuar, pasi ata nuk ishin përgjegjësit e vetëm për problemin. Duke shtuar se ai ishte "deri diku krenar për trupat e NATO-s", ai theksoi se: "Në Maqedoni [trupat] nuk lejoheshin jashtë kazermave dhe atje kishte rregulla të rrepta për këtë". Tek i njëjti takim, koloneli Larson i Danimarkës, përgjegjës për bashkëpunimin civil dhe ushtarak (CIMIC), e pranoi se NATO-ja ishte në dijeni të problemit dhe se çështja e ushtarëve dhe prostitutave ishte "e vështirë të përfundonte. Ushtarët [janë] nën stres, larg prej familjeve [të tyre] në atdhe, dhe nuk mund të mbyllen në kazerma për muaj e muaj". Koloneli Larson nënvizoi se NATO-ja vetë ishte e paaftë të zgjidhte çështjen, pasi sjellja e trupave dhe çdo masë pasuese disiplinore ishte një çështje për autoritetet përkatëse kombëtare në secilin nga vendet kontribuese me trupa në vendet ku dërgohet KFOR-i.²⁵⁶

Më shtator 2003 Amnesty International ia theksoi preokupimet e saj KFOR-it dhe kërkoi një takim. Në përgjigje, KFOR-i e pajisi Organizatën me atë që u përshkrua si një deklaratë "zyrtare":

"1. KFOR- dënon plotësisht trafikimin e grave dhe seksit, sipas mandatit të siguruar nga Rezoluta e UN SC 1244/99, për të përforcuar dhe mbështetur luftën kundër aktivitetëve të tilla në bashkëpunim të ngushtë me agjencitë lokale të zbatimit të ligjit. 2. COMKFOR-i [Komandanti i

²⁵⁵ Një Memorandum Marrëveshjeje midis OHCHR dhe DPKO, i datuar 22 nëntor 2002, i kërkon E12 që "SRSG-ja ose Kryetari i Operacioneve Paqeruajtëse do të sigurojë që gjithë personeli i operacionit-ushtarak apo civil qoftë-të jenë në dijeni, dhe t'u përmbahen, të drejtave ndërkombëtare të njeriut dhe standardeve të ligjeve humanitare. SRSG-ja do të botojë udhëzime për këtë qëllim".

²⁵⁶ Miting i NATO-s në Bruksel, 13 shtator 2002.

KFOR-it] ka urdhëruar që të gjitha Forcat e KFOR-it të vihen në dijeni për Rregulloren 2001/4 të UNMIK-ut mbi 'Ndalimin e trafikimit të personave në Kosovë' dhe për faktin se akte të tilla janë të ndaluara edhe sipas mjaft instrumenteve të së Drejtës Publike Ndërkombëtare. 3.

COMKFOR-i u kërkon komandantëve në varësi të Trupave të Kombeve Kontribuese të publikojnë politikat kombëtare që caktojnë rregullat kundër përdorimit të prostitutave për shërbime seksuale dhe të sigurojë që këto rregullore të jenë të zbatueshme nëpërmjet sanksioneve disiplinore kombëtare. 4. Përdorimi i prostitutave është kundër urdhrave në fuqi të KFOR-it dhe çdo ushtar që i thyen këto urdhra i nënshtrohet masës disiplinore nga vetë kombi i tij."²⁵⁷

Organizata vëren se asnjë referim nuk bëhet për ndjekje penale të mundshme që ndërmerren kundër personelit të KFOR-it.

Më tetor 2003 Amnesty International përsëri kërkoi një takim me KFOR-it për të diskutuar këtë përgjigje dhe pyetje që dalin prej saj, duke përfshirë informacion për çështjet në të cilat ishin zbatuar sanksione disiplinore. KFOR-i refuzoi të takohet, ose bëri ndonjë koment të mëtejshëm.

Disa vende që dërgojnë trupa për KFOR-in kanë zbatuar masa disiplinore ose u kanë dhënë forcave të tyre trajnim efektiv për standardet e të drejtave të njeriut para dislokimit.²⁵⁸ Megjithatë, vende të tjera dërguese kanë dështuar në marrjen e ndonjë mase kundër pjesëtarëve të forcave të tyre, të akuzuar për përfshirje në trafikim ose përdorim të grave të trafikuar.²⁵⁹ Amnesty International është e preokupuar ndaj mungesës së ndonjë politike të njëjtë brenda NATO-s dhe ndaj mungesës së një politike të centralizuar, ose organeve hetimore për të siguruar përgjegjshmërinë e gjithë forcave kombëtare të dislokuara në forcat paqeruajtëse, duke përfshirë dhe KFOR-in.²⁶⁰

Organizata vëren se së fundi nga NATO-ja janë marrë masa për të zhvilluar një politikë për luftimin e trafikimit të grave dhe fëmijëve, "e cila do të zbatohet për gjithë personelin që merr pjesë në operacionet e drejtuara nga NATO-ja", dhe që mes të tjerash do të zgjidhë aspekte të operacioneve, trajnimit, edukimit dhe ndërgjegjësimit. Megjithatë, organizata vëren se Rezoluta

²⁵⁷ E-mail, i datuar 17 shtator 2003, për Amnesty International nga Chris Thompson, Wg Cdr Royal Air Force, Zëdhënësi shtypi i KFOR-it

²⁵⁸ Shih më sipër për shembuj mase disiplinore kundër personelit UK, fq.55.

²⁵⁹ Intervistë e AI me Kryetarin e TPIU-së, shtator 2003; Intervistë e AI me zëdhënësin e Policisë së UNMIK-ut, tetor 2003.

²⁶⁰ Amnesty International, Mungesë e dukshme e përgjegjshmërisë së forcave ndërkombëtare paqeruajtëse në Kosovë dhe Bosnjë-Hercegovinë.", AI Index: EUR 05/001/2004. prill 2004.



323 e NATO-s për Trafikimin e Qenieve Njerëzore dështoi në zgjidhjen e çështjeve mbi kërkesën dhe përgjegjshmërinë.²⁶¹

“Derek Chappell, zëdhënësi i shtypit i UN-it në Kosovë, e mohoi se paqeruajtësit kanë qenë një faktor në lulëzimin e bordellove dhe grave të trafikuar. Ai tha se intervistat me rreth 1,800 gra vitin e kaluar treguan se 70 deri 80 për qind e klientëve të bordellove ishin vendas. Po për 20 deri 30 për qind që mbetet? ‘Ka një numër të madh punëtorësh të huaj këtu me NGO të ndryshme’.”²⁶²

Udhëzimet e UN-it

Udhëzimi 10 i Parimet e Rekomanduara dhe Udhëzimet e UNHCHR-së përcakton *Detyrimin e Paqeruajtësve, policisë civile dhe personelit diplomatik e humanitar*. Ai i pranon “shqetësimet e veçanta” të ngritura nga përfshirja e këtij personeli në trafikim. Udhëzimi 10.3 u bën thirrje këtyre misionëve që të sigurojnë: “që personeli i punësuar në kontekstin e paqeruajtjes, ndërtimit të paqes, mbrojtjes civile, misionëve diplomatike dhe humanitare të mos angazhohen në trafikim dhe shfrytëzim që lidhet me të ose me përdorim të shërbimeve të personave në lidhje me të cilët ka baza të pranueshme për të dyshuar se ata mund të jenë trafikuar. [nënvizim i shtuar] Ky detyrim mbulon gjithashtu komplicitetin në trafikim nëpërmjet korrupsionit ose ortakërisë me çdo person ose grup personash që mundet me arsye të dyshohen për marrje me trafikim dhe shfrytëzimin përkatës.”

Udhëzimi 10.7 deklaron se: “Organizatave ndërqeveritare dhe joqeveritare duhet, në rastet e duhura, të zbatojnë sanksione disiplinore ndaj pjesëtarëve të personelit të gjetur të përfshirë në trafikim dhe shfrytëzimin përkatës përveç kësaj dhe pavarësisht nga çdo sanksion penal ose sanksion tjetër i vendosur mbi të nga Shteti përkatës. Privilegjet dhe imunitetet e bashkangjitura statusit të një nëpunësi nuk duhet të kërkojnë me qëllim që të mbrojnë atë person nga sanksionet për krime të rënda të tilla si trafikimi dhe shkeljet përkatëse. Amnesty International gjykon se ky udhëzim është i dobët. Ai kërkon vetëm hetim disiplinor, në vend të një hetimi penal dhe zbatohet vetëm kur një person është i dyshuar për përfshirje në trafikim, por jo kur ai është i dyshuar që më dijeni përdor shërbimet e grave ose vajzave. Madje edhe kur personeli është i dyshuar për përfshirje në trafikim, udhëzimet ia lënë vendosjen e sanksioneve penale “shtetit përkatës”, sesa procedimit sipas ligjit të zbatuar në gjykatat e vendit pritës.

²⁶¹ Shih, për shembull,

<http://www.nato.int/docu/speech/2003/s031215e.htm> dhe Rezolutën 323 të NATO-s mbi Trafikimin e Qenieve Njerëzore.

²⁶² “Ana e errët e paqeruajtjes”, *The Independent*, 10 korrik 2003.

Amnesty International mendon se UNMIK-u dhe SRSG-të pasuese s’kanë mundur t’u përmbahen udhëzimeve të vet UN-it për trafikimin dhe se kanë dështuar në zgjidhjen e përshtatshme të kërkesës nga paqeruajtësit ndërkombëtarë dhe personeli civil për shërbimet e grave të trafikuar.

Më mars 2004, duke e pranuar se “Paqeruajtësit kanë nisur të shihen si pjesë e problemit në trafikim sesa zgjidhja”, DPKO-ja publikoi një dokument politike, i cili, në përputhje me qëndrimin për këtë shfrytëzim të “Toleranca Zero” të Sekretarit të Përgjithshëm, synon të “vendosë një sistem që të monitorojë, parandalojë, zvogëlojë, hetojë dhe të ndëshkojë

